

KOHA

për

Pratë



PËRGATITUR NGA



Qendra Kosovare për Studime Gjinore
Kosovar Gender Studies Center

Deputete pa kuotë

Fitim Gashi

Gratë shënuan arritje të madhe në zgjedhjet parlamentare të 9 shkurtit 2025, duke e tejkaluar kuotën ligjore prej 30 për qind për përfaqësim gjinor në Kuvend. Sipas rezultateve preliminare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, gati dy të tretat e deputetëve të rinj janë gra që siguruan mandate me vota, pa u mbështetur në kuotën ligjore. Kjo ndodhi pavarësisht se përfaqësimi i grave në listat e partive vazhdoi të jetë i kufizuar duke reflektuar mungesë të barazisë gjinore. Shumica e partive politike nuk shkuan përtej kriterit ligjor që përcakton kuotën minimale prej 30 për qind të përfshirjes së grave në listat zgjedhore.

Nga partitë kryesore shqiptare, 33 gra siguruan ulësë në Kuvend përmes votës së drejtpërdrejtë, ndërsa vetëm pesë u mbështetën në kuotën ligjore. Në komunitetin serb, tri gra arritën të bëhen ligjvënëse me vota të mjaftueshme.

Gratë më të votuara

Gratë më të votuara në këto zgjedhje dolën prej radhëve të Lëvizjes Vetëvendosje, që u bënë deputete nga numri i votave të siguruara, e jo mbështetur në kuotë. Albulena Haxhiu, kandidatja e Lëvizjes Vetëvendosje, aktualisht Ministre e Drejtësisë, është gruaja më e votuar me mbi 100 mijë vota.

Pas saj renditet Donika Gërvalla-Schwarz me mbi 90 mijë vota dhe MIMOZA Kusari-Lila me 70 mijë vota. Shqipe Mehmeti-Selimi dhe Saranda Bogujevci gjithashtu siguruan një mbështetje të madhe me mbi 40 mijë vota.

Në Partinë Demokratike të Kosovës, që ishte e dyta në zgjedhjet e 9 shkurtit, Vlora Çitaku u radhit e para ndër gratë më të votuara, duke marrë mbi 38 mijë vota. Sala Jashari dhe Ganimete Musliu vijnë pas saj me 34 mijë dhe 28 mijë vota respektivisht, ndërsa Blerta Deliu-Kodra dhe Ariana Musliu-Shoshi e përmbyllin top pesëshen e PDK-së me rreth 20 mijë vota secila.

Nga radhët e Lidhjes Demokratike të Kosovës, Doarsa Kica-Xhelili u rendit si gruaja më e votuar e këtij subjekti me mbi 51 mijë vota, duke u pozicionuar menjëherë pas kryetarit të partisë. Hykmete Bajrami mori po ashtu afro 50 mijë vota, ndërsa listën prej pesë kandidatëve më të votuara e mbyllin Jehona Lushaku-Sadriu, Marigona Geci dhe Serbeze Muçaj.

Në koalicionin AAK-Nisma, Time Kadriaj është gruaja më e votuar me 14 mijë e 601 vota, e pasuar nga Arbëreshë Krasniqi me mbi 11 mijë vota dhe Xhevahire Izmaqi me 10 mijë vota.

Drejtoresha Ekzekutive në Organizatën “Demokraci për Zhvillim” (D4D), Rezarata Delibashzade-Krasniqi, thotë se këto rezultate dëshmojnë përparim për gratë.

“Edhe pse vetëm 20 % e grave kandidatë kanë pasur rol aktiv në fushatat zgjedhore, rezultatet e zgjedhjeve tregojnë një avancim të dukshëm në përfaqësimin gjinor, pasi shumica e grave janë zgjedhur pa pasur nevojë për kuotën gjinore. Kjo dëshmon se qytetarët po tregojnë vetëdije më të lartë për një Kuvend më gjithëpërfshirës dhe të barabartë”.

Ndërsa Leonida Molliqaj, Drejtore Ekzekutive dhe kryeredaktore në Qendrën për Informim, Kritikë dhe Aksion “QIKA”, thotë se kuota vijon të jetë përcaktuese për hapësirën që u jepet grave në politikë.

“Edhe pjesëmarrja e grave në zgjedhjet e 9 shkurtit është diktuar nga kuota minimale ligjore prej 30%, një masë që, ndonëse e nevojshme, nuk garanton përfaqësim të vërtetë dhe të barabartë. Në vend që të shihet si një arritje, duhet të problematizohet fakti që, edhe pas dekada përpjekjesh për barazi gjinore, partitë politike ende nuk kanë marrë iniciativa të

vërteta për të rritur përfshirjen e grave përtej minimumit të detyruar me ligj. Kjo tregon mungesën e një vullneti të mirëfilltë për të çrrënjosur diskriminimin sistematik ndaj grave në politikë”.

Ajo shton se sistemi elektoral në Kosovë nuk krijon kushte të favorshme për gratë që të fitojnë mandate në mënyrë të barabartë me burrat.

“Kjo sepse kultura politike është e mbizotëruar nga nepotizmi, klientelizmi dhe rrjetet e fuqisë patriarkale. Përfaqësimi i grave në Kuvend nuk do të shihet si progres derisa të kemi gra në numër të barabartë me burrat dhe, më e rëndësishmja, derisa gratë në politikë të mos jenë të detyruara të përshkatan me standardet patriarkale për të mbijetuar në atë hapësirë”.

Ndërsa Mexhide Demolli nga Lëvizja “FOL” vlerëson se në zgjedhjet e 9 shkurtit në listat zgjedhore të partive politike në Kosovë pak mbi 30 për qind ishin gra, për shkak të kuotës gjinore prej 30 për qind, siç e kërkon Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme, ndonëse Ligji për Barazi Gjinore parasheh pjesëmarrje 50 për qind.

“Vetëm dy gra kanë qenë prijëse të listave. Pabarazia gjinore në fushatën parazgjedhore ka filluar që nga fakti se në listat e partive politike nuk pamë një barazi gjinore, pra nuk e respektuan Ligjin për Barazi Gjinore duke barazuar numrin e kandidatëve gra dhe burra në listat zgjedhore”.

“Përfaqësimi i grave në Kuvend mbetet ende në nivel të ulët për faktin se partitë aktuale opozitare ende kanë nevojë për kuotën gjinore që gratë të jenë pjesë e Kuvendit. Bazuar në të dhënat aktuale vetëm partia që prin në këto zgjedhje, Lëvizja Vetëvendosje, ka 20 gra deputete, apo më pak se gjysmën e deputetëve”.

Kufizimi i hapësirës

Organizatrat që vëzhguan procesin e fundit zgjedhor konstatuan se përfaqësimi i grave në zgjedhjet parlamentare vazhdoi të jetë i kufizuar, duke reflektuar një mungesë të barazisë gjinore. Sipas Koalicionit të organizatave joqeveritare Demokracia në Veprim (DNV), përkundër kërkesave ligjore që përcaktojnë një kuotë minimale prej 30 për qind për përfshirjen e grave në listat zgjedhore, shumica e partive politike nuk kanë shkuar përtej këtij minimumi ligjor. Nga 1.280 kandidatët e certifikuar, vetëm 412, apo 32 për qind, ishin gra, duke dëshmuar se gratë ende nuk kanë qasje të barabartë në vendimmarrje politike. Pak para zgjedhjeve, Gjykata Kushtetuese vendosi se Neni 28 i Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme është në përputhje me Kushtetutën, duke konstatuar se kuotat gjinore prej 30 për qind janë të ligjshme dhe nuk bien në kundërshtim me të drejtat zgjedhore. Megjithatë, përfaqësimi më i lartë i synuar nga Ligji për Barazi Gjinore prej 50 për qind edhe kësaj radhe nuk ishte një detyrim për partitë. Në këto zgjedhje, krahasuar me ato të para katër viteve, përqindja e grave në listat e partive kryesore ishte ndryshe. Lëvizja Vetëvendosje kishte 37 për qind gra në listën e saj, ndërsa Partia Demokratike e Kosovës dhe Lidhja Demokratike e Kosovës kishin secila nga 34 për qind. Koalicioni AAK-Nisma përfshiu 32 për qind gra në listën e tij.

Përtej përfaqësimit numerik në lista, gratë vazhduan të përballen me barriera të mëdha gjatë fushatës.

Sipas DNV-së, pjesëmarrja e tyre në tubimet elektorale dhe në promovimin e ideve ishte e kufizuar; “duke reflektuar një mjedis ku gratë nuk gëzojnë qasje të barabartë për të komunikuar me votuesit”. Vetëm 44 gra ishin folëse në tubimet publike të partive, nga më shumë se 160 folës gjithsej. Në shumicën e rasteve, pjesëmarrja e grave në aktivitetet zgjedhore mbeti simbolike, me më pak se 10 për qind të pjesëmarrësve në



shumë prej këtyre ngjarjeve. Në hapësirat mediatike, situata ishte po aq problematike, konstatoi DNV.

Në 376 debate televizive të monitoruara, vetëm 22 për qind e pjesëmarrësve ishin gra.

“Edhe në kronikat zgjedhore përfaqësimi ishte tejte i ulët, me vetëm 14 për qind të kronikave që përfshinin kandidatë gra. Koha e ofruar për gratë në mediat audiovizive ishte gjithashtu e pabarabartë, me vetëm 46 minuta hapësirë televizive për kandidatet, që përbënte rreth 12 për qind të kohës së përgjithshme të mbuluar për të gjithë kandidatët. Mungesa e mbështetjes së subjekteve politike për gratë në fushatë ndikoi drejtpërdrejt në mundësitë e tyre për të konkurruar në mënyrë të barabartë”.

“Gjatë fushatës zgjedhore gratë kanë pasur hapësirë të kufizuar për t'i shpalosur idetë e tyre. Nga 27 subjekte politike që kanë garuar, vetëm dy prej tyre kanë pasur gra si prijëse të listave. Gjithashtu edhe numri i kandidatëve gra në listat pjesëmarrëse ka vazhduar të mbetet i ulët, ku asnjë nga subjektet politike nuk ka arritur të ketë më shumë se 37 për qind gra (përfaqësimi më i lartë në këto zgjedhje). Në këtë aspekt nuk qëndron më mirë as hapësira televizive që u jepet grave në fushatë. Nga 1298 kronika ku janë transmetuar aktivitetet e kandidatëve për deputetë (gra dhe burra), në vetëm 207 prej tyre janë paraqitur gratë kandidatë (16 për qind). Gjithashtu edhe koha televizive për kandidatet gra ka qenë shumë më e paktë sesa për kandidatët burra. Nga 547 minuta, vetëm 71 minuta (13 për qind) kanë qenë për kandidatët gra. Edhe në debatet televizive pjesëmarrja e kandidatëve gra ishte shumë më e ulët se ajo e burrave. 79 për qind e kandidatëve në debate kanë qenë burra dhe vetëm 21 për qind gra”, ka shpjeguar Mexhide Demolli.

Gjuha e urrejtjes

Raportet konstatojnë se gratë kandidatë u përballën me një numër të lartë sulmesh të drejtpërdrejta në hapësirat online, një priirje që tregon sfidat e vazhdueshme në sigurimin e mjedisit të barabartë për të gjithë pjesëmarrësit në procesin zgjedhor.

Demokraci për Zhvillim (D4D), si anëtare e Demokraci në Veprim, gjatë monitorimit të rrjeteve

sociale të kandidatëve për deputetë ka identifikuar 878 raste të gjuhës së urrejtjes gjatë katër javëve të fushatës zgjedhore.

Sipas Delibashzade-Krasniqit, nga këto raste, 378 (44 për qind) kishin në shënjestër gratë.

“Gjatë analizës u vunë re debate me gjuhë mizogjene, qoftë qëllimisht apo jo, si dhe shprehje që nuk kishin fare lidhje me politikën. Kjo gjuhë e urrejtjes është rezultat i ndasive politike të cilat shpesh nxisin komente negative. Gjuha denigruese përdoret si mjet për të dekurajuar dhe frikësuar individët apo grupet e caktuara, me qëllim pengimin e pjesëmarrjes së tyre në poste dhe procese vendimmarrëse. Ky fenomen tregon nevojën urgjente për ndërhyrje institucionale dhe shoqërore në luftën kundër gjuhës së urrejtjes, duke promovuar një mjedis politik më të drejtë dhe gjithëpërfshirës për gratë”.

Ajo shton se përhapja e gjuhës së urrejtjes, veçanërisht në rrjetet sociale, përbën një kërcënim serioz për pjesëmarrjen e grave në politikë.

“Edhe pse në zgjedhjet e fundit gratë arritën të fitonin vota pa pasur nevojë për kuota, ekziston rreziku që ky përfaqësim të ulet në të ardhmen, pikërisht për shkak të sulmeve dhe dezinformimit që i pengojnë ato të marrin pjesë aktivisht në politikë. Përmeshja formale e kuotave gjinore nuk mjafton. Partitë duhet t'i mbështesin gratë përmes trajnimeve dhe përgatitjeve konkrete, në mënyrë që ato të kenë një zë më të fuqishëm në skenën politike. Shoqëria tashmë është më e vetëdijshme për ndikimin negativ të lajmeve të rreme dhe manipulimit online, por duhet të bëhen hapa të mëtejshëm për të parandaluar shpërndarjen e tyre”.

Kjo është një betejë e qytetarëve aktivë kundër një fenomeni të rrezikshëm, vlerëson Delibashzade-Krasniqi.

“Është e domosdoshme që të gjithë qytetarët të jenë më të përgjegjshëm dhe t'i raportojnë rastet e urrejtjes dhe kërcënimeve. Institucionet si Prokuroria dhe Policia e Kosovës tashmë kanë marrë masa në disa raste duke dënuar individë për gjuhën e urrejtjes dhe kërcënimet e tyre. Prandaj, përgjegjësia për ta luftuar këtë fenomen nuk qëndron vetëm te autoritetet, por tek e gjithë shoqëria.

Vetëm përmes angazhimit të përbashkët mund të krijojmë një mjedis politik më të drejtë dhe gjithëpërfshirës për gratë”.

Barazia gjinore s'është prioritet në programet e partive

Programet e partive politike në Kosovë dëshmojnë se barazia gjinore nuk është prioritet dhe ajo përmendet në mënyrë sipërfaqësore.

Programi zgjedhor i Lëvizjes Vetëvendosje, i prezantuar në 62 faqe, përfshiu një kapitull të dedikuar grave, ku u premtuan masa konkrete për mbështetjen e tyre në studime, biznes dhe kujdesin ndaj fëmijëve. Një nga pikat e programit ishte nisja e “Superpunës për Gratë” brenda gjashtë muajve të parë të qeverisjes.

Kjo nënkupton pagën minimale për gjashtë muajt e parë për gratë që dëshirojnë të rikthehen në tregun e punës.

Programi i Lidhjes Demokratike të Kosovës, i cili përbëhej nga 254 faqe, vendosi theksin tek mbështetja e familjes, të rinjve dhe grave. LDK-ja beson se familja është një institucion kyç për shoqërinë dhe angazhohet për barazi të plotë gjinore brenda saj. Kjo parti premtoi barazi efektive mes burrave dhe grave, duke u mundësuar grave qasje më të madhe në jetën publike dhe vendimmarrje.

Një element i veçantë i programit të LDK-së ishte “diplomacia feministe”: “Barazia gjinore do të jetë në qendër të politikës së jashtme të Kosovës, duke synuar promovimin e të drejtave të grave në nivel global”.

Partia Demokratike e Kosovës tek pjesa e shkurtër për gratë u zotua për mbrojtjen e të drejtave trashëgimore të tyre.

Koalicioni AAK-Nisma paraqiti një program prej 108 faqesh, ku një nga pikat ishte mbështetja financiare për gratë e papunësuara që kanë tre fëmijë e më shumë, duke garantuar pagën minimale për to deri në dhjetë vjet. Po ashtu, ky koalicion premtoi promovimin e barazisë gjinore dhe përmirësimin e mundësive profesionale për gratë.

Leonida Molliqaj thotë se premtimet e partive politike për barazinë gjinore ishin kryesisht sipërfaqësore.

“Në vend të politikave të guximshme për ndryshime strukturore që do t'i sfidonin pabarazitë e rrënjosura në tregun e punës dhe në familje, premtimet për pagesa për lindje të fëmijëve veçse forcojnë stereotipat se gratë janë që të shihen vetëm brenda rolit të tyre si nëna. Për më tepër, partitë nuk dhanë ndonjë strategji konkrete për adresimin e dhunës me bazë gjinore, apo për fuqizimin e grave në politikëbërje”.

Sa i përket hapësirës që mund t'u jepet grave në qeverinë e ardhshme, Molliqaj thotë se nëse historia na ka mësuar diçka kjo është se pjesëmarrja e grave në institucione nuk garanton domosdoshmërisht politikë feministe, për aq kohë sa ato mbeten të marginalizuara dhe pa ndikim të vërtetë në vendimmarrje. “Në fund të ditës, pa një ndryshim radikal në mënyrën se si bëhet politika në Kosovë, me gratë jo vetëm si pjesëmarrëse, por si agjente kryesore të transformimit social, përfaqësimi i tyre do të mbetet vetëm një iluzion i barazisë”.

Kurse Mexhide Demolli e potencon aspektin vleror të kuotës.

“Duke qenë se mungesa e mbështetjes institucionale ende e vështirëson pjesëmarrjen e grave në mënyrë të barabartë, kuota për gratë mbetet një mekanizëm i nevojshëm për të siguruar përfaqësim të drejtë dhe barazi gjinore në politikë. Kuota është një zgjidhje e përkohshme që duhet të shoqërohet me reforma në partitë politike, ndryshime kulturore dhe mbështetje institucionale për të garantuar pjesëmarrje të barabartë”.

Sipas saj, vetëm kur të arrihet një ekuilibër i qëndrueshëm dhe një mjedis politik gjithëpërfshirës, duhet të shqyrtohet heqja e kuotës, por aktualisht ajo është thelbësore për të rritur përfaqësimin dhe fuqizimin e grave në vendimmarrje.

Fuqia ekonomike e përfshirjes së më shumë grave në tregun e punës



Aivo Orav

Në Ditën Ndërkombëtare të Gruas ne njohim përparimin e bërë ndër vite për avancimin e të drejtave të grave, duke reflektuar gjithashtu për atë që duhet të bëhet akoma. Pengesat për ta arritur barazinë midis grave dhe burrave vazhdojnë në të gjithë botën. Kosova nuk bën përjashtim.

Gratë në Kosovë përballen me sfida të shumta: qasje të kufizuara në pronë dhe burime, përgjegjësi joproporcionale për kujdesin ndaj fëmijëve dhe familjes, ekspozim më i madh ndaj ngacmimeve, diskriminim në rekrutim dhe pritje të bazuara në stereotipa. Këta faktorë kontribuojnë në pjesëmarrjen jashtëzakonisht të pabarabartë të grave në tregun e punës në Kosovë, me vetëm rreth 20% të punësuar.

Përveç kësaj, gratë janë të mbipërfaqësuar në ekonominë joformale, shpesh në punë me pagë më të ulët. Numri i grave sipërmarrëse është i paktë dhe gratë vazhdojnë të jenë të nënpërfaqësuar në pozitat vendim-marrëse, si në sektorin publik ashtu edhe në atë privat.

Kjo nuk është vetëm shqetësuese, por paraqet edhe pengesë për zhvillimin e përgjithshëm ekonomik të Kosovës. Duke rrezikuar të dukem tepër ambicioz, do t'i inkurajoja të gjithë në Kosovë që të shënojnë Ditën Ndërkombëtare të Gruas 2025 duke u fokusuar në atë se si përfshirja më e madhe e grave në tregun e punës mund të kontribuojë në zhvillimin dhe përparimin ekonomik të Kosovës.

Plani i Rritjes dhe mundësitë që ofron

Që nga ardhja ime disa muaj më parë, shumë nga diskutimet e mia me autoritetet, shoqërinë civile dhe partnerët janë fokusuar në nevojën për ta avancuar funksionimin e ekonomisë së tregut, politikat e punësimit dhe kushtet e punës. Plani i Rritjes për Ballkanin Perëndimor, me më shumë se 880 milionë euro të destinuara për Kosovën, synon të nxisë zhvillimin e përgjithshëm ekonomik. Ai gjithashtu përfshin dispozita të qarta për avancimin e barazisë gjinore dhe fuzizimin e grave dhe vajzave.

Është e rëndësishme që Kosova ta shfrytëzojë plotësisht Planin e Rritjes për të arritur barazinë ekonomike, pasi zhvillimi dhe përparimi gjithëpërfshirës do të jetë i vështirë pa të. Një kërkesë themelore për këtë është integrimi i barazisë gjinore në politikat ekonomike të Kosovës.

Arritja e barazisë ekonomike

Pyetja është: si të arrihet barazia ekonomike? Rruga drejt barazisë ekonomike për gratë në Kosovë kërkon përfshirjen e tyre të plotë në tregun e punës, duke u mundësuar atyre që të kontribuojnë plotësisht. Normat shoqërore shpesh i vendosin gratë në rolet e përkujdesit, duke kufizuar zhvillimin e tyre profesional dhe qasjen më të gjerë në fuqinë punëtore. Diskriminimi lidhur me amësinë mbetet i përhapur, pasi gratë vazhdojnë të mbajnë përgjegjësinë kryesore për fëmijët dhe për të moshuarit.

Mungesa e shërbimeve dhe objekteve për përkujdesjen e fëmijëve në Kosovë, veçanërisht për fëmijët nën tre vjeç, krijon pengesa për punësimin dhe qëndrueshmërinë e karrierës së grave. Për më tepër, ndarja horizontale në arsim dhe trajnim profesional i drejton gratë drejt profesioneve me pagesë të ulët, ndërsa vetëm një përqindje e vogël ndjek fusha STEM,

që ofrojnë mundësi më të mira profesionale. E rëndësishme është se një numër i konsiderueshëm i grave janë të angazhuara në punë joformale, të cilave u mungon mbrojtja sociale dhe siguria në punë. Ky informalitet shpesh nuk njihet në statistikat zyrtare të punës, duke errësuar më tej masën e vërtetë të kontributeve ekonomike të grave.

Cila është rruga tutje?

Kosova ka bërë përparim të rëndësishëm në legjislacionin për barazi gjinore me procesin e integritimit në BE duke përshpejtuar reformat. Ligji për Barazi Gjinore dhe Ligji për Mbrojtjen nga Diskriminimi kanë hedhur themelin për barazinë e grave. Megjithatë, arritja e fuqizimit ekonomik të grave kërkon një qasje sistemike që lehtëson qasjen e grave në punë në të gjitha nivelet, i mbështet ato në vendin e punës dhe i riformëson strukturat shoqërore. Janë thelbësore mjediset e sigurta të punës, politikat miqësore ndaj familjes, mekanizmat e forcurar për të monitoruar dhe zbatuar ligjet dhe politikat, si dhe adresimi efektiv i shkeljeve.

Shumë nga këto sfida mund të gjejnë përgjigje përmes përafrimit me legjislacionin dhe politikat e BE-së, veçanërisht me Direktivën e Balancës së Punës dhe Jetës. Direktiva promovon barazinë gjinore duke inkurajuar një ndarje më të ndjeshme të përgjegjësiave të kujdesit midis burrave dhe grave. Direktiva përfshin gjithashtu dispozita për lejen e atësisë, lejen prindërore dhe aranzhimet fleksibile të punës për prindërit dhe kujdestarët. Në vend të kësaj, Ligji aktual i Punës në Kosovë nuk i plotëson standardet e nevojshme për ta inkurajuar përfshirjen e grave në vendin e punës dhe duhet të përplotësohet në përputhje me Direktivën për të lehtësuar një shpërndarje më të barabartë të përgjegjësiave familjare.

Përveç kësaj, Kosova duhet t'i zbatojë masat e rekrutimit, si në administratën publike ashtu edhe në ndërmarrjet private, për të promovuar punësimin e grave, veçanërisht në rolet udhëheqëse. Në përputhje me agjendën Gratë, Paqja dhe Siguria, gratë duhet të përfshihen në mënyrë aktive në vendimmarrje në të gjitha nivelet, në qeverisje dhe udhëheqje.

Besoj se Qeveria e re e Kosovës do t'i japë prioritet miratimit të Ligjit të ri të Punës në përputhje me Direktivën e Balancës Punë-Jetë. Ajo duhet gjithashtu të forcojë punën, përgjegjësitë dhe burimet e Inspek-

toratit të Punës, në mënyrë që të mund të merret me ekonominë joformale dhe të garantojë respektimin e të drejtave të punëtoreve gra. Për më tepër, duke inkorporuar fuqizimin ekonomik të grave në Programin e ri të Kosovës për Barazi Gjinore dhe në Planin e Ri Kombëtar të Veprimit për Gratë, Paqen dhe Sigurinë, Kosova do të pozicionohet më mirë për të arritur barazi të plotë ekonomike.

Roli i BE-së në promovimin e barazisë gjinore

BE-ja tashmë po e ndihmon Kosovën me sfida që sjell zbatimi i direktivave dhe politikave të BE-së. Për shembull, ndërtimi i çerdheve të fëmijëve do të ofrojë mbështetjen e nevojshme për kujdesin ndaj fëmijëve, duke u mundësuar grave të konkurrojnë në një fushë loje të barabartë.

Përmes granteve për gratë ndërmarrëse dhe fermere nga të gjitha komunitetet e Kosovës, shumë prej tyre i kanë filluar dhe mirëmbajtur me sukses bizneset e tyre. Vajzat e reja po fitojnë aftësi në TI përmes programeve të trajnimit të financuara nga BE-ja. Organizatat e shoqërisë civile për të drejtat e grave po i përdorin grantet e BE-së për të zhvilluar të dhëna të sakta të tregut të punës dhe për të ofruar rekomandime drejt përmirësimit të barazisë.

BE-ja gjithashtu mbështet dhe monitoron politikat që synojnë t'i japin fund dhunës dhe diskriminimit ndaj grave në përgjithësi, veçanërisht në vendin e punës, ndërsa inkurajon politikat që ofrojnë fuqizim ekonomik të grave. Në fund, gjë që është shumë e rëndësishme, BE-ja po e mbështet administratën qendrore dhe komunale të Kosovës për të integruar barazinë gjinore në të gjitha politikat, ligjet dhe buxhetet.

Gratë janë këtu dhe të gatshme të jenë pjesëmarrëse. Kosova duhet t'u mundësojë dhe t'i mbështesë ato të arrijnë potencialin e tyre të plotë. Është vërtetuar faktikisht se përfshirja e grave në tregun e punës dhe mbështetja e strukturave rreth tyre u mundëson të jenë produktive. Kjo, nga ana tjetër, kontribuon në zhvillimin e përgjithshëm ekonomik.

BE-ja është aleate në këtë përpjekje dhe do të vazhdojë ta mbështesë Kosovën.

Autori është Ambasador i Bashkimit Evropian në Kosovë.



Luljeta Demolli

Tronditjet globale, luftërat shumëdimensionale, krizat sistemore, pasiguritë politike, ekonomike dhe sociale. Të gjitha së bashku janë duke e krijuar një mjedis pengues për avancimin e të drejtave të grave.

Është shndërruar në trend botëror përballja me sfida të vazhdueshme që i rrezikojnë të drejtat dhe liritë tona. Më e rënda është kur mbahen zgjedhje të reja (vjet u mbajtën në së paku 64 shtete, me pjesëmarrjen e gjysmës së njerëzimit) ndërsa rezultatet janë dëshpëruese në aspektin emancipues.

Fitoret, ose avancimet, e autoritarëve populistë dhe ekstremistëve disiplinues i kanë intensifikuar sulmet ndaj arritjeve të deritanishme të grave dhe barazisë gjinore në përgjithësi, duke iniciuar ndryshime në ligje, institucione dhe diskurse publike. Këto agjenda ngjallin frikë dhe pasiguri tek gratë, sepse e cenojnë autonominë, ndonjëherë edhe lirinë.

Shfaqjet e ndryshme kundër të drejtave të grave, të cilat u panë edhe në Kosovë gjatë fushatës për zgjedhjet e 9 shkurtit, nuk ishin befasi për aktivistët feministe. Ato paraqitën reflektim lokal të tendencave globale, prandaj i prisnim. Posaçërisht për shkak të retorikës inflamatore politike që dominoi në Kuvend përballë të drejtave të grave dhe komunitetit LGBTIQ+.

Gjatë këtij mandati në institucionin më të lartë shpesh u shprehën qëndrime që nuk pasqyronin aspak mbështetje për barazinë gjinore. Injorimi i grevës së guximshme të punëtoreve teknike për paga dinjitoze ishte shembull kuptimplotë i amoralitetit.

Deputetët e kësaj legjislature do të mbahen në mend për diskursin e tyre pengues mbi edukimin seksual, që tregoi mungesë njohurish, respekti dhe vetëdijeje për tema të ndjeshme. Qasjen e njëjtë e përdorën edhe për populizëm gjatë fushatës.

Përtej kësaj, deputetët nuk respektuan as Kushtetutën e Kosovës kur ishte në pyetje Kodi Civil. Propaganda përmes foltores së Kuvendit kundër çifteve dhe grave që dëshin

Veçanërisht tash

rojnë të kenë fëmijë me metodën IVF ishte absolutisht e papranueshme dhe mbrapakthyes.

Mosdiskutimi i Ligjit të Punës për çështjet e pushimit të lehonisë dhe pushimit prindëror ishte një dështim tjetër i pafalshëm. Me këtë qasje negative partitë hynë në fushatë për zgjedhjet nacionale, ku gratë përgjithësisht u anashkaluan si në programe, ashtu edhe në përfaqësim.

Gjatë fushatës, vendimmarrësit e partive politike vazhduan të patronizonin, me theksimin e rolit të grave kryesisht si nëna dhe anashkalimin e kontributit të tyre në fusha të tjera të shoqërisë. Në përpjekjet për ta ruajtur dominimin mbi gratë dhe për të penguar avancimin e tyre në shoqëri, një parti premtoi 500 euro, një tjetër 5000. Kishte edhe premtime për paga dhe shtesa për lehona - jo si mbështetje avancuese për gratë, por si një mekanizëm për t'i reduktuar dhe mbajtur ato në rolin e nënës dhe të kujdestareve, pa adresuar çështje më të gjera si barazia në vendin e punës, qasja në arsim dhe shëndetësi, si dhe pjesëmarrja aktive në politikëbërje.

Menjëherë pas zgjedhjeve, me një analizë të thjeshtë arrihet në përfundim që votimi ka pasqyruar strukturalisht diskursin e Kuvendit. Reagimi ndaj progresit të barazisë gjinore ishte i dukshëm, duke rritur polarizimin dhe përdorimin e saj si argument kundërshtues politik. Kryqëzimi i vazhdueshëm i komunitetit LGBTIQ+ ishte gjithashtu pjesë substanciale e këtij përkeqësimi.

Paragjykimet gjinore të shpërfaqura gjatë fjalimeve të katër viteve në Kuvend, por edhe në fushatë dhe në debatet mediale, kanë ndikuar në formësimin e antigjinore, duke e bërë seksizmin faktor të rëndësishëm në zgjedhje - pavarësisht nga gjinia e kandidatëve. Ky seksizëm do të mund të përdoret si mjet politik edhe në të ardhmen, me po të njëjtin qëllim - maksimalizimin e votës.

Stili i tillë tregon qartë se, përtej çështjes së vullnetit, partitë politike në Kosovë nuk kanë ide si t'i trajtojnë ndryshimet e domosdoshme graduale të normave gjinore dhe sociokulturore. Rezistenca ndaj tyre, të drejtave të grave specifikuat, ndërlihet me synimin për t'ruajtur konceptualizimet aktuale mbi-zotëruese të kulturës politike të votuesve kosovarë, të cilat u shkojnë në favor.

Çfarë ka ndodhur në legjislaturën e kaluar dhe çfarë pritet të ndodh edhe në këtë legjislaturë, pavarësisht se cili front do të jetë në pushtet, paraqet sfida madhore për aktivistët feministe.


Është bërë shumë komplekse të identifikojmë qartësisht me kë dhe si duhet të bashkëpunojmë, ndërsa ndaj kujt dhe si të luftojmë. Ndryshimet e menjëhershme, ndonjëherë të paparamendueshme, i kanë zbehur kufijtë ekzistues, duke i rrezikuar aleancat, planet, projektet dhe qëndrueshmëritë.

Prandaj është thellësisht e domosdoshme t'i amplifikojmë të gjithë zërat e disponueshëm, të njohur ose të margjinalizuar, për t'u angazhuar në bashkëveprime kuptimplote me qëllim të ruajtjes së arritjeve dhe punëve drejt avancimeve.

Shoqëria civile është qendra orientuese e aksionit për vlerat e barazisë gjinore. Pavarësisht nga rrymimet e tashme për t'ia zvogëluar ndikimin, fokusi kreativ duhet të jetë në organizatat e grave dhe të rinjve.

Mobilizimi, bashkëpunimi dhe rezistenca janë jetike. Për botën tonë.

Autorja është Drejtore Ekzekutive e Qendrës Kosovare për Studime Gjinore.



Gratë në profesione të reja: Trend lufte apo ndryshim strategjik?



Iryna Drobovych

Ndërsa Ukraina po e përkujton përvjetorin e tretë të luftës së gjerë që Rusia ka nisur më 24 shkurt 2022, prirja që gratë të futen në profesionet tradicionalisht mashkullore bëhet një realitet i ri. Brenda këtyre viteve u shfaqën nisma të rëndësishme për t'i mbështetur gratë që janë të prira për t'u aftësuar dhe për të rifilluar rrugëtimin e tyre profesional në fusha që nuk i kanë konsideruar më parë. Ndër projektet më interesante janë She Drives, që përmirëson aftësitë e grave në transportin e udhëtarëve, si dhe trajnimin pilot për gratë si shofere kamioni - Iron Women, i cili synoi t'i trajtojë gratë për të drejtuar ngarkuesit me rrota dhe ekskavatorët, si dhe gratë në një minierë thëngjilli të prezantuar dhe promovuar nga kompania e energjisë DTEK.

Këto projekte mbështeten nga Qeveria e Ukrainës, përfshirë nëpërmjet aktiviteve të Ministrisë së Ekonomisë dhe Ministrisë për Zhvillimin e Komuniteteve dhe Territoreve, nga sektori privat që po përballen me sfidat e mungesës së fuqisë punëtore, si dhe nga partnerët ndërkombëtarë, përfshirë UN Women Ukraine. Për më tepër, zgjidhjet për këtë çështje diskutohen dhe zhvillohen gjithashtu përmes aktiviteve të Skills Alliance, një koalicion botëror i krijuar me nismën e Qeverisë së Ukrainës dhe Qeverisë së Gjermanisë, në Konferencën e

Rimëkëmbjes së Ukrainës 2024, në Berlin. Anëtarët e kësaj Aleance janë zotuar të rikualifikojnë mbi 190.000 ukrainas për ta luftuar papunësinë strukturore në Ukrainë, përfshirë atë të grave.

Në të gjitha këto procese, pyetja kryesore është nëse rikualifikimi i grave dhe përfshirja e tyre në profesionet tradicionale mashkullore është përgjigje vetëm ndaj sfidave të luftës. Apo me gjithë atë përpjekje ne shohim vërtet ndryshimin strategjik që na sjell drejt barazisë më të mirë në tregun e punës dhe më gjerë.

Luftimi i diskriminimit ndaj grave në marrëdhëniet e punës ka filluar para luftës së madhe në Ukrainë. Prandaj, në vitin 2017, u ndryshua legjislacioni sovjetik ende në zbatim në atë kohë dhe rreth 450 profesione të braktisura për gratë u anuluan, p.sh., salduese me gaz, muratore, operatore ekskavatori, zhytëse, gërmuese. Megjithatë, ligji ende i ndalonte gratë të punonin në kushte të dëmshme dhe të rrezikshme, p.sh., nën tokë në miniera, por në mesin e vitit 2022 Parlamenti e hoqi këtë ndalim për shkak të mungesës së punëtorëve.

Fuqizimi ekonomik i grave si pjesë e politikës kombëtare të punës është gjithashtu prioritet i Qeverisë. Në vitin 2023, u miratua Strategjia Kombëtare për Mbylljen e Hendekut Gjinor në Paga, me qëllim të zvogëlimit të hendekut gjinor të pagave nga 18.6% në 13.6% deri në vitin 2030. Aktivitetet kryesore në këtë drejtim përfshijnë ndryshimet në legjislacionin e punës për legalizimin e punës në shtëpi ose në distancë, mbështetjen e bizneseve të grave me grante, përfshirë veteranët dhe bashkëshortet e veteranëve, programe trajnimi dhe rikualifikimi. Kjo do të ishte një përpjekje e rëndësishme për përmirësimin e mjedisit për gratë në të gjitha profesionet.



Sondazhet e fundit konfirmojnë se të paktën 68% e ukrainasve të anketuar besojnë se gratë dhe burrat kanë mundësi të barabarta për të mbajtur poste drejtuese në punë, ndërsa 31% e të anketuarve nuk e kanë këtë mendim. Është interesante se 63% janë të sigurt që edhe gratë, edhe burrat, marrin të njëjtën pagë, ndërsa 34% nuk pajtohen. Kjo shpërfaq rëndësinë e fushatave informuese që do të rrisnin ndërgjegjësimin e shoqërisë ukrainase për situatën në tregun e punës, përfshirë luftimin e stereotipeve gjinorë për tregun e punës. Si ai i quajtur “Of Course, You Can!” (“Patjetër, ti mundesh!”) që zbatohet nga Ministria e Ekonomisë e

Ukrainës, me mbështetjen e UN Women Ukraine dhe Qeverisë së Suedisë. Mes shumë opinionistëve, fushata është mbështetur nga Zonja e Parë e Ukrainës, Olena Zelenska, e cila i ka nxitur gratë ukrainase të mos kenë frikë të ndërtojnë rrugëtimin e tyre profesional në rrugën dhe fushat që i konsiderojnë më të mirat për to, por të ecin përpara në këtë rrugë të fuqizuara dhe me besim.

Ndryshimi strategjik në sigurimin e barazisë gjinore në fuqinë punëtore është përsheptuar përfundimisht nga sfidat e luftës së gjerë në Ukrainë. Megjithatë, ndryshimi legjislativ i mëparshëm dhe vendimet në favor të këtij

ndryshimi strukturor, si në nivel kombëtar ashtu edhe me mbështetjen e partnerëve ndërkombëtarë mbeten më të rëndësishmet në këtë rrugë. Zbatimi i kësaj politike korrespondon gjithashtu me qasjet e organizatave joqeveritare dhe NVM-ve që synojnë t'i trajtojnë nevojat e grave në komunitet të cilat i shtrojnë bazat e suksesit në këtë rrugë para dhe menjëherë pasi që Ukraina ta fitojë këtë luftë.

Autorja është aktiviste ukrainase për të drejtat e njeriut dhe eksperte për politika gjinore, bashkëthemeluese dhe drejtore e përgjithshme e fondacionit “The Day After”.

Mundësitë e limituara të grave



Vlora Tuzi Nushi

Miliona gra në mbarë botën përballen me barrën e punës së papaguar të kujdesit, e cila, pavarësisht vlerës së saj thelbësore për shoqërinë dhe ekonominë, mbetet e padukshme dhe e nënvlerësuar. Puna e palodhur dhe e papaguar vazhdon të mos numërohet në asnjë bilanc ekonomik.

Sipas UN Women, gratë shpenzojnë mesatarisht tri herë më shumë kohë sesa burrat në punë të paguara të kujdesit, për shembull, duke u kujdesur për fëmijët dhe të moshuarit, apo duke i kryer punët e shtëpisë. Të dhëna më të detajuara tregojnë se gratë dhe vajzat kryejnë më shumë se tri të katërtat e punës së papaguar të kujdesit, duke shpenzuar mesatarisht 4 orë e 25 minuta në ditë, krahasuar me 1 orë e 23 minuta për burrat. Në Kosovë, gratë shpenzojnë 44%, apo 2.7 orë në ditë, më shumë se burrat në punë të paguar.

Puna e papaguar e kujdesit është e nënvlerësuar dhe tërësisht e lidhur

me normat gjinore. Ajo e kufizon kohën, zgjedhjet dhe mundësitë e grave për arsim, punë të denjë të paguar dhe pjesëmarrje politike. Situata vetëm rëndohet për gratë dhe vajzat në familjet me të ardhura të ulëta dhe në zonat rurale, gratë mi-grante dhe grupet e marginalizuara.

Gratë në moshë pune, që e kanë përgjegjësitë e kujdesit mbi supe, janë më të prira se burrat që t'i nënshirohen hendekut gjinor të pagave dhe hendekut të kualitetit të punës, ndërsa janë për shtatë herë më të prira se burrat që të jenë jashtë tregut të punës. Se puna e kujdesit i pengon gratë të kyçen në tregun e punës, qëndron edhe për Kosovën. Puna kërkimore ndër vite e ka pohuar këtë tezë.

Përkundër faktit se gratë tashmë përfaqësojnë mbi 50% të të diplomuarve në arsimin e lartë, ky progres nuk ka pasur një ndikim të drejtpërdrejtë në pjesëmarrjen e barabartë të grave në tregun e punës. Një arsye kryesore për këtë është se shumë gra përballen me barriera të ndryshme sociale dhe kulturore, si dhe me ndarje të padrejta të punës brenda familjes. Ato shpesh detyrohen të ndërmarrin punë të paguara për kujdesin e fëmijëve, të moshuarve, dhe shtëpisë, që kufizon mundësitë e tyre për punë me pagë.

Në Kosovë, situata është edhe më e theksuar, ku gratë ballafaqohen me një shkallë të ulët të punësimit e cila është pasojë e faktorëve si

ndarja tradicionale e roleve gjinore dhe mungesa e mundësive të barabarta për avancim profesional. Përkundër diplomimit të lartë, shumë gra mbeten të papuna, ose në pozita të paqëndrueshme dhe me paga më të ulëta krahasuar me burrat njëjtë të diplomuar. Kjo ka ndikim të drejtpërdrejtë në pavarësinë e tyre ekonomike dhe avancimin në karrierë, duke e thelluar hendekun gjinor në shoqëri dhe ekonomi.

UN Women ka bërë thirrje për njohjen, zvogëlimin dhe rishpërndarjen e punës së papaguar të kujdesit. Disa nga angazhimet kryesore për ta trajtuar këtë çështje përmes politikave publike dhe projekteve konkrete përfshijnë fushatat globale për vetëdijësim, përkrahjen për politika publike të drejta, investimet në infrastrukturë të kujdesit dhe përkrahjen për gratë sipërmarrëse.

Përmes platformave si “Equal Pay” dhe “Care Economy”, UN Women synon të rrisë vetëdijen mbi vlerën ekonomike të punës së papaguar dhe të promovojë ndarjen e barabartë të kësaj barre mes grave dhe burrave. Gjithashtu, organizata ka ndihmuar që të krijohen politika që mbështesin kujdesin e përbashkët, duke promovuar pushimin e atësisë dhe shërbime publike më të qasshme për kujdesin ndaj fëmijëve.

Përmes programeve të saj, UN Women po nxit investime në kop-shte publike, shërbime sociale dhe

mbështetje për punonjëset e kujdesit, duke lehtësuar ngarkesën e grave që kujdesen për familjet e tyre. Në disa vende, UN Women ka ndihmuar gratë që të fillojnë biznese fleksibile që u mundësojnë qasje në tregun e punës pa u detyruar të sakrifikojnë rolin e tyre si kujdestare familjare.

Për më tepër, ka hartuar edhe një paketë udhëzimesh e cila ofron zgjidhje të qarta për adresimin e pabarazisë gjinore dhe promovimin e saj përmes perspektivës së punës së kujdesit. Këto udhëzime theksojnë nevojën për një shpërndarje të barabartë të përgjegjësiwe të kujdesit, njohjen e vlerës së punës së kujdesit dhe mbështetjen për punë të dinjitetshme për punonjësit e kujdesit. Ky toolkit përdor kornizën 3R - Recognition, Reduction, Redistribution (Njohje, Reduktim, Rishpërndarje), duke përfshirë edhe shpërblimin dhe përfaqësimin e punës së kujdesit të paguar.

Investimi në sisteme gjithëpërfshirëse të kujdesit dhe dizajnimi i politikave mbështetëse për fuqizimin ekonomik të grave do të duhej të bëheshin me qëllim të rishpërndarjes dhe reduktimit të punës së kujdesit. UN Women punon vazhdimisht në dizajnimin e mekanizmave të tillë që ua rikthejnë kohën e tyre grave, krijojnë vende pune të dinjitetshme dhe mbështesin krijimin e vendeve të reja dhe të qëndrueshme të punës.

Ndryshimi është i domosdoshëm dhe nëse ndodh vjen për përfitime

të të gjithëve. Për t'u ndryshuar kjo status-quo nevojiten politika ekonomike dhe sociale që përfshijnë punën e kujdesit si një kontribut themelor për mirëqenien ekonomike.

UN Women e ka në vizion të transformimit social dhe ekonomik edhe adresimin e barrierave sistematike të pabarazisë gjinore. Në vitin 2023 e ka lansuar strategjinë “Gender Equality Accelerator”, që e ofron edhe platformën për të punuar në iniciativën Transform-Care dhe për të ndërtuar sisteme që e ndryshojnë lojën.

Në vitin 2015, 193 vende të botës e adoptuan Agjendën për Zhvillim të Qëndrueshëm 2030. Jemi vetëm 5 vjet larg kufirit dhe qëllimeve që ia kemi vënë vetes. Pesë vjet tingëllojnë pak, por janë mjaftueshëm për t'i intensifikuar përpjekjet për adresimin e sfidave globale.

Transformimi i ekonomisë së kujdesit, që ndërlihet me disa elemente të pabarazisë gjinore, është hapi kryesor drejt një bote ku mundësitë, nëse jo tërësisht të barabarta, janë të paktën më të barabarta.

Duke reflektuar në këtë 8 Mars, le të angazhohemi të gjithë për ta shndërruar barazinë gjinore në realitet, duke njohur dhe zvogëluar barrën e punës së papaguar të kujdesit.

Autorja është shefe e Zyrës së UN Women në Kosovë.

Rruga e vështirë drejt barazisë

Tamara Smidling

Kur bëhet fjalë për respektimin e të drejtave të punës dhe atyre sociale, Serbia ndan fatin e të gjitha vendeve të ngjashme të gjysmë-periferisë kapitaliste, kryesisht të varura nga kapitali i investimeve të huaja dhe objekt i të gjitha pasojave shkatërrimtare të asaj që një vëzhgues dhe analist i ku-jdesshëm e quajti “aheng neoliberal global”. Rregulli themelor i asaj “lojë” është se miliona e miliona njerëz krijojnë mbivlerë përmes punës së tyre të përditshme, e cila më pas shijohet dhe disponohet nga një grup jashtëzakonisht i vogël dhe disproporcionalisht i fuqishëm njerëzish. Sipas raportit të fundit në dispozicion të Konfederatës Ndërkombëtare të Sindikatave (ITUC), Serbia është në vendin e katërt (nga pesë kategoritë) të vendeve, që është, shkurt, kategoria e vendeve në të cilat ka shkelje sistematike të të drejtave të punëtorëve, me kufizime të shpeshta ligjore dhe rrënim të pozitës së tyre.

Problemet kryesore me të cilat përballen punëtorët në Serbi përgjithësisht mund të klasifikohen në disa kategori: nga zgjidhjet e pafavorshme ligjore dhe situatat kur pagat thjesht nuk përputhen me kostot reale, deri në praktikat problematike në vetë vendin e punës, si puna e papaguar jashtë orarit, duke e vështirësuar ose pamundësuar organizimin e sindikatave, kushtet e këqija të sigurisë, puna pa kontratë pune, mospagesa e kontributeve, pagat e vonuara, etj. Raporte dhe dokumente të ndryshme flasin në mënyrë elokuede për të gjitha të përmendurat më lartë, përfshirë "Raportin mbi statusin e të drejtave të punës në Republikën e Serbisë për vitin 2023".

Ligji aktual i Punës daton nga viti 2014 dhe përmban zgjidhje të shumta të vjetruara dhe të padrejta që nuk janë në përputhje me interesat më të mira të punëtorëve, por më së shpeshti funksionojnë në favor të punëdhënësve. Nga ana tjetër, edhe pse paga minimale është rritur në dy vitet e fundit, inflacioni dhe rritja e kostos së përgjithshme të jetesës në masë të

madhe i kanë tejkaluar të ardhurat. Një e dhënë interesante dhe treguese e Entit të Statistikave të Republikës së Serbisë është se nga të gjitha qytetet e Serbisë, vetëm në Beograd paga mesatare i kalon shpenzimet e shportës mesatare të konsumatorit.

Periodha deri në 8 Mars, si dhe përgatitjet për festimin e tij, për një pjesë të publikut në Serbi do të thotë të realizohet një lloj bilanci çdo vit kur bëhet fjalë për pozitën e grave në tregun e punës dhe të drejtat e tyre të punës në një kuptim më të gjerë. Çështjet sociale janë padyshim një nga pikat më të spikatura nevralgjike të shoqërisë bashkëkohore serbe, dhe në varësi me kë bisedoni, siç pritet, do të merrni vlerësime të ndryshme të situatës dhe problemeve urgjente.

Shumë hulumtime, analiza dhe indekse relevante që hedhin dritë mbi situatën nga këndvështrime të ndryshme, megjithatë, pajtohen për një gjë - pozita e punëtorëve në Serbi, pavarësisht nga gjinia, aktualisht është e ngarkuar me probleme të shumta, ndërsa gratë janë në pozitë edhe më të vështirë për një sërë arsyesh. Nëse bëhet krahasimi, ato janë në një pozitë të varur kur bëhet fjalë për: shkallën e punësimit, shumën e pagave dhe përfitimet që marrin për punën e tyre, mundësitë e punësimit, veçanërisht për gratë mbi 45 vjeç, diskriminimin në vendin e punës, etj. Kur i shtojmë kësaj perspektivën se sektorët në të cilët gratë janë më të shumtat zakonisht janë ata me pagat më të ulëta mesatare, arrijmë në një pamje që tregon qartë nevojën e madhe për të punuar në shumë dhe në mënyrë intensive në këto probleme, prandaj është e nevojshme të krijohen koalicionet dhe organizatat të gjera që do të kanalizojnë e udhëhiqin luftën për të drejtat e punës.

(Pa)punësimi i grave në Serbi: Të dhënat e disponueshme nga Shërbimi Kombëtar i Punësimit për vitet e fundit tregojnë se përqindja e grave në numrin e përgjithshëm të personave të papunë është rreth 56%, normë që ndryshon në varësi nga rajoni. Këtu duhet pasur parasysh se statistikat zyrtare për numrin e të papunësuarve

(që përfshijnë vetëm personat që nuk kanë punë dhe janë aktivisht në kërkim të saj) mund të devijojnë nga situata reale në terren, d.m.th., të ndryshës subjektive të papunësisë. Kjo kategori e dytë, e cila nuk njihet nga statistikat zyrtare, përfshin anëtarët e familjes që ndihmojnë pa pagesë, të papunët afatgjatë, ose ata që nuk janë në gjendje të kërkojnë një punë të re. Është e arsyeshme të supozohet, bazuar në gjithçka që dimë, se shumica e këtyre kategorive janë gra, puna e papaguar e të cilave ruan dhe mundëson riprodhimin social, kështu që pjesa e tyre në numrin e të papunëve është ndoshta edhe më e madhe. Numri më i madh i grave të papunësuar është në grupmoshën mbi 45 vjeç dhe shumica e tyre janë gra nga zonat rurale, të cilat më së shpeshti nuk kanë asnjë resurs apo mbështetje për gjetjen e punësimit.

Paga më të ulëta për të njëjtën punë: Hendeku i pagave midis grave dhe burrave ende ekziston, megjithëse është zvogëluar në krahasim me situatën e disa viteve më parë. Sipas të dhënave të disponueshme, ky hendek arriti në 8.8% në vitin 2024, që është më pak se në shumë vende të BE-së, por është edhe një arsye për të punuar drejt eliminimit të plotë të tij. Megjithatë, këtu më shqetësuesi është fakti se hendeku i pagave është në rritje midis kategorive të popullsisë me kualifikime më të ulëta arsimore. Me fjalë të tjera, gratë me nivelin më të ulët të arsimimit sigurojnë që tashmë janë ndër grupet sociale më të cenueshme, ndaj është shumë shqetësuese të shihet se këto gra fitojnë mesatarisht 21.2% më pak se burrat me të njëjtin nivel arsimor.

Diskriminimi në tregun e punës: Diskriminimi me bazë gjinore në sferën e punës, punësimit dhe marrëdhënieve të punës, është ende i pranishëm në Serbi në nivele dhe forma të ndryshme. Në paraqitjet e saj të shumta në media, Komisionerja për Mbrotjtjen e Barazisë, Brankica Janković, dëshmoi se këtë lloj diskriminimi e vuajnë dhe raportojnë kryesisht gratë. Diskriminimi gjinor në fushën e punës në shumicën e rasteve lidhet me pamundësinë për të avancuar, shkëljet e



të drejtave në lidhje me përdorimin e lejes së lehonisë, ose shtatzënisë, si dhe ngacmimet seksuale. Sipas një studimi nga viti 2022, pothuajse 40% e grave të anketuara kishin pranuar përdorimin e një forme të diskriminimit gjinor në vendin e punës.

Edhe kjo pasqyrë kalimtare dhe sipërfaqësore e tendencave kryesore flet për kompleksitetin dhe seriozitetin e problemit të të drejtave të punës së grave dhe burrave në Serbi. Të gjitha problemet të renditura mund t'i shtohen edhe shumë shembuj tjerë edhe më drastikë, të cilët jo vetëm kërcënojnë të drejtën e gruas për punë të dinjitetshme, por shpeshherë shfuqizojnë vetë supozimet e një jete me dinjitet, të cilën duhet ta kenë të gjithë. Pa marrë parasysh gjininë, përkatësinë etnike, fenë apo ndonjë përkatësi tjetër. Siç u tha në fillim të tekstit, shumë nga këto probleme janë fatkeqësisht

pjesë e rendit global ekonomik dhe social, zhvillimi i fundit i të cilit tregon për kolapsin e mëtejshëm të shtetit social dhe përkeqësimin e pozitës së të gjithë punëtorëve në botë. Prandaj sot është më e rëndësishme se kurrë të organizohemi dhe të mbështesim njëri/a-tjetrin/ën, të mësojmë nga shembujt e organizimit të suksesshëm të punës dhe sindikatave nga pjesë të tjera të botës, të ndërtojmë koalicionet të gjera dhe të dëshmojmë se solidariteti dhe lufta për një të nesërme më të mirë nuk janë vetëm shkronja të thjeshta në letër.

Për politikën e barazisë, për politikën e drejtësisë sociale, për politikën e paqes! Paçim një 8 Mars të lumtur dhe luftarak!

Autorja është është Zyrtare e Programit në Fondacionin Kvinna till Kvinna.

Zhvillimi i qëndrueshëm përmes barazisë gjinore



Saxhide Mustafa

Tregu i punës në Kosovë karakterizohet nga pabarazi të theksuara gjinore, të cilat ndikojnë ndjeshëm në përfshirjen dhe mundësitë e barabarta për të gjithë. Kosova renditet në vendin më të ultë në rajon dhe Evropë për pjesëmarrjen e grave në tregun e punës. Shkalla e kësaj pjesëmarrjeje në vitin 2023, sipas të dhënave të Agjencisë të Statistikave të Kosovës, ishte nën 20%. Kjo shifër alarmante, me lëvizje shumë të vogla prej më shumë se dy dekadave pas luftës, e thellon shqetësimin për një hendek gjinor në pjesëmarrje të grave, i cili është rreth 30% më i ulët krahasuar me pjesëmarrjen e burrave.

Dallimet gjinore në tregun e punës në Kosovë përfaqësojnë një sfidë sociale dhe ekonomike. Ndër faktorët kryesorë që kontribuon në shkallën e ulët të pjesëmarrjes së grave në tregun e punës është përgjegjësia familjare, veçanërisht kujdesi për fëmijët dhe të moshuarit. Kjo reflekton ndarjen disproporcionale të përgjegjësiwe familjare në shoqërinë tonë, duke i theksuar rolet tradicionale gjinore. Për më tepër, perceptimi për mundësi të kufizuara punësimi dekurajon shumë gra nga kërkimi i një pune, duke rritur shkallët e zhgënjimit ndër to.

Pavarësisht se niveli i edukimit të vajzave dhe grave në Kosovë nuk është shqetësim aktual, mospërputhja e programeve arsimore me tregun e punës e thellon më tej hendekun mes kërkesës dhe ofertës në tregun e punës, duke çuar në rritjen e përfshirjes së grave në profesione që paguhen më pak, dhe ku dominojnë gratë. Kjo ndikon në pabarazinë gjinore në paga, e cila vlerësohet të jetë në disfavor të grave rreth 14% bazuar në pagat mujore dhe rreth 6% kur llogaritet mbi pagën për orë.

Edhe pse popullsia e Kosovës renditet si një nga më të rejtat në Evropë, me një moshë mesatare 30.5 vjeçare, me potencial të ngritjes së pjesëmarrjes në tregun e punës, sfidat e lartpërmendura shfaqin pengesa të vazhdueshme në qasjen e grave. Një sfidë e madhe po ashtu vërehet tek gratë e moshës së mesme, duke pasur parasysh vjetërsimin e aftësive (pavarësisht edhe nëse kanë nivel të lartë akademik) për të gjetur një vend pune të përshtatshëm. Kësaj kategorie i mungon përvoja e punës dhe përshtatja me zhvillimet e reja teknologjike.

Tendencat demografike të Kosovës, pas regjistrimit të popullsisë në vitin 2024, shpërfaqin plakjen dhe migrimin, që dalin të jenë sfida afatgjata për rritjen ekonomike dhe mirëqenien sociale. Avantazhi i një popullsie të re, siç e ka Kosova, pritët të zbehet përderisa migrimi rritet dhe normat e lindshmërisë bien, duke ndikuar në mënyrë negative në rritjen ekonomike dhe duke rritur presionin mbi burimet publike dhe private në dekadën e ardhshme. Të dhënat statistikore tregojnë një rënie të ndjeshme në numrin e grave të grupmoshës 20-39 vjeç për 18.8 përqind-

je. Ndërkohë, grup moshë 40-54 ka shënuar një rritje për 10.4 përqindje dhe grup moshë 55-64 ka pësuar rritjen më të lartë për 47 përqindje. Këto ndryshime pasqyrojnë një tendencë të plakjes së popullsisë dhe tkurrjes së grupmoshës që zakonisht përfaqëson fuqinë punëtore më aktive, përderisa grupmoshat më të reja shfaqin shkallë më të larta migrimi.

Pavarësisht përpjekjeve të Kosovës për të krijuar një kornizë ligjore që promovon barazinë gjinore dhe për të zhvilluar dokumente politike për të integruar barazinë gjinore në iniciativat qeveritare, në realitet kjo ende mbetet për të dëshiruar. Rritja e pjesëmarrjes së grave në fuqinë punëtore mund të shërbejë si një kundërmasë ndaj këtyre sfidave demografike dhe të nxisë një rritje të konsiderueshme ekonomike. Nëse Kosova do ta përputhte shkallën e saj të pjesëmarrjes së grave në fuqinë punëtore me mesataren e Ballkanit Perëndimor prej 45%, rreth 180.000 gra shtesë do të mund t'i bashkoheshin fuqisë punëtore. Duke përdorur modelin Equity Gain të FMN-së (2025), raporti vlerëson se mbyllja e hendekut gjinor në punësim mund të çojë në një rritje të BPV-së deri në 22.9%.

Kjo kërkon intervenim në nxitjen e politikave të guximshme publike. Organizatat e shoqërisë civile dhe odat ekonomike vlerësojnë se, për më shumë se një dekadë, Ligji i Punës Nr. 03-L-2012, respektivisht dispozitat e lejes të lehonisë, kanë ndikuar në këtë disproporcion në mes grave dhe burrave në tregun e punës. Vënia e barës për pagesën e lejes të lehonisë sektorit privat (6 muaj, 70% të pagës) dhe mosrespektimi i ligjit nga sektori privat janë konsideruar si forma më

diskriminuese për gratë në moshën reprodutive në tregun e punës. Nisur nga kjo, ekziston një hendek i madh midis legjislacionit dhe zbatimit, në mungesë të mekanizmit të fuqishëm për monitorimin e implementimit të ligjeve, siç është inspektorati i punës. Në mungesë të vullnetit për iniciimin e ligjit për sigurime shoqërore, siç është praktika në vendet e rajonit, kjo çështje mbetet peng i politikës për t'u adresuar.

Raporti i Bankës Botërore “Gratë, Biznesi dhe Ligji”, për vitin 2024, ka identifikuar se në Kosovë ka një mospërputhje të madhe midis opinionit të ekspertëve dhe kornizave ligjore, duke sugjeruar se, megjithëse ligjet ekzistojnë, ato nuk zbatohen në mënyrë efektive. Amendamentimi i Ligjit të Punës mbetet një nga kërkesat më të zëshme nga shoqëria civile dhe sektori privat. Ky ligj ka mbetur në sirtarët e qeverisë që nga viti 2018. Kanë kaluar tashmë 7 vite në zvarritjen e tij për amendamentim, e kjo parashtron nevojën për një ligj të ri në periudhën paspandemike, që përfshin në vete intervenime të mëdha në fusha si: siguria dhe shëndeti në punë, orari i punës, balancimi punë-jetë, pushimet, orari fleksibil, etj.

Buxhetimi i përgjegjshëm gjinor gjithashtu mbetet një nga kërkesat kryesore të Forumit Ekonomik të Grave. Edhe pse buxhetimi i ndjeshëm gjinor është bërë i detyrueshëm që nga viti 2015, zbatimi mbetet i dobët. Vonesat në ngritje të kapaciteteve brenda nivelit qendror dhe lokal kanë ndikuar që deri më tani, pra plot një dekadë, kjo çështje të mos e marrë formën e dëshiruar për forcimin e praktikave që mund të sigurojnë shpërndarjen efektive të

burimeve për promovim të barazisë gjinore.

Pra, nevojiten politika të strukturuara mirë për nxitjen dhe punësimin e grave, përmirësimin e kushteve të punës dhe krijimin e një ambienti më të favorshëm për barazinë gjinore dhe stabilitetin ekonomik.

Krijimi i mundësive për kujdes të fëmijëve që është i përballueshëm për familjet dhe reformimi i politikave të lejeve prindërore, mendoj se mund të zvogëlojnë barrën mbi gratë, duke hapur rrugë për nxitjen e punësimit të grave.

Zgjerimi i portfolios të edukimit dhe trajnimeve lidhur me kërkesat e tregut të punës dhe përafrimi i Agjencisë për Punësim të Kosovës me sektorin privat, qoftë nëpërmjet programeve të qeverisë apo edhe formave tjera nga donatorët, ndihmon në krijimin e kuadrove njerëzore për të cilat ekonomia ka nevojë, duke rritur shkallën e punësimit. Këtu bashkëngjitet edhe rritja në ofrimin e mundësive praktike tek studentët, me qëllim profilizimin e tyre në kuadër të nevojave të tregut të punës.

Adresimi i këtyre dallimeve kërkon një qasje të shumanshme që kombinon zbatimin e ligjit, stimuj ekonomikë dhe ndryshime kulturore. Me mbylljen e hendekut gjinor në punësim dhe paga, Kosova mund të përfitojë nga rritje e rëndësishme ekonomike, duke mundësuar një shoqëri më gjithëpërfshirëse dhe të barabartë, që kontribuon në zhvillimin ekonomik të qëndrueshëm dhe përparimin social.

Autorja është bashkëpunëtorë e lartë në Institutin Riinvest dhe koordinatore e Forumit Ekonomik të Grave.

Premtimet për shtesat e fëmijëve, shmangie e politikës prej sfidave të grave

Rexhep Maloku

“Albini, me shtesat e grave, na e bëri të vështirë t’ia merrim votat e grave”, ishte shqetësimi i përmbledhur i njërit prej zyrtarëve të lartë të fushatës së PDK-së në Ferizaj për zgjedhjet e fundit për Kuvendin e Kosovës.

Nëpërmjet kësaj fjalie, ai, njëherësh zyrtar i lartë politik i komunës, po i trajtonte gratë si të ishin robotë që po komandoreshin prej kryeministrit për shkak të mbështetjes simbolike financiare, por që në të vërtetë për-muajshëm u ndahet fëmijëve e jo në-nave.

Vetë Kryeministri Kurti e nxiti ping-pongun e shtesave kur gjatë verës së kaluar, bashkë me Ministrin Hekuran Murati, paraqitën skemën e re shtesave për fëmijë. Një rritje simbolike pas më shumë se tri vitesh në qeverisje. Nga 10 euro në muaj sa ndaheshin për një fëmijë, shuma u dyfishua në 20 euro, ndërkaq për nënat me tre fëmijë e më shumë u ngrit në 30 euro në muaj për secilin fëmijë.


“Për më se 20 vjet asnjë qeveri nuk e kishte marrë mundin të bënte diçka për nënat dhe fëmijët. U desh që të vinte një qeveri si kjo e jona, progresiste, demokratike e që ka në qendër mirëqenien e secilit qytetar, e më në fund edhe nënat dhe fëmijët të ndjejnë dorën e mirë të shtetit”, do të deklaronte Kurti në konferencën e 18 korrikut 2024, më shumë se shtatë muaj para zgjedhjeve të rregullta parlamentare.

Për opozitën, ky vendim më shumë lidhje me fushatën e parakohshme zgjedhore, sesa që konsiderohej si ngritje e planifikuar.

Ama, shoqëria civile, njohësit e çështjeve gjinore dhe të dhënat vazhdimisht tregojnë se gratë janë lënë anash nga institucionet politike, të udhëhequra kryesisht nga burrat kur vjen puna te hartimi i politikave dhe programeve që do të nxisin punësimin e tyre të qëndrueshëm, duke ua mundësuar realizimin e ëndrrave, zhvillimin e potencialit për të mirën e familjes dhe shoqërisë dhe zbutur koston financiare për skemat edhe ashtu të zbehta të mbështetjes financiare. E të gjitha partitë tashmë kanë pasur hise pushteti.

Sherri i forcës së zakonit

Të dhënat e anketës së fuqisë punëtore të Agjencisë së Statistikave të Kosovës kanë treguar se gjatë viteve 2020-2022 vetëm sa është rritur dallimi ndërmjet shkallës së punësimit të burrave dhe grave në Kosovë. Gjatë kësaj kohe, 6.6 për qind burra më shumë kanë hyrë në tregun e punës krahasuar me rritjen prej 4.3 për qind të numrit të grave. Dallimi vërehet në të gjitha moshat, por



spikat grupmosha nga 35 deri 44 vjeç, periudhë kur gratë merren kryesisht me rritjen e fëmijëve, duke hequr dorë prej punës dhe realizimit të ambicieve të tyre profesionale për të mirën individuale, familjare dhe shoqërore.

Një hulumtim i thellë i vitit 2022, i autorëve nga pesë vendet e Ballkanit me titull: “(Pa)fuqia ekonomike e grave në tregun e Ballkanit Perëndimor”, i cili identifikonte sfidat e secilit shtet në punësimin e grave, e rendiste Kosovën si “lidere” të diskriminimit të grave në punësim.

Vetëm 17 për qind e grave me mundësi pune janë të punësuar në Kosovë, ndërsa të dhënat tregojnë që janë të nënpaguara në krahasim me burrat. Kjo gjendje vlerësohet se ka ardhur si pasojë e vetëdijes dhe kulturës shoqërore, por edhe aspekteve investive e sociale.

Dhe sfidat me të cilat vazhdojnë të përballen gratë në Kosovë vazhdojnë të kundrohen kryesisht prej prizmit të përgjegjësisë së tyre ndaj fëmijëve. Kështu u dëshmuar edhe gjatë fushatës së zgjedhjeve të 9 shkurtit 2025, kur partitë shtyheshin se kush guxon të premtojë shtesa më të larta për fëmijët, duke i vendosur në rend të dytë sakrificat e grave, që për shkak të forcës së zakonave shoqërore për familjen dhe mungesës së mbështetjes shtetërore, detyrohen të heqin dorë prej ëndrrave të tyre si qytetare të barabarta të shoqërisë.

VV premtom “SuperPunë për Gratë”

Gjatë periudhës zyrtare të fushatës, Kryeministri Kurti do ta shpallte 2025-ën “Vit të gruas”, duke premtuar masa të reja për mbështetjen e grave nëse qeveria do të ishte sërish në duar të tij. Në një videopostim, Ministria e Drejtësisë, Albulena Haxhiu, kishte deklaruar në fushatë se gjatë katër

vjetëve të mandatit, Qeveria ka marrë shumë veprime, si programi “SuperPuna” që ka ndikuar drejtpërdrejt në jetën e grave të Kosovës. Kurti u zotua në natën e 9 shkurtit se edhe qeveria e ardhshme do të udhëhiqej prej Lëvizjes Vetëvendosje, si fituese e zgjedhjeve parlamentare. Ai pati pohuar se synonte që paga minimale të rritej në 500 euro, me qëllim që të fuqizohej edhe mbështetja financiare për gratë. Kjo pagë nuk do të tatohej fare: “Programi SuperPuna për Gratë” do të garantojë pagën minimale për gjashtë muaj për secilën grua që dëshiron të rikthehet në tregun e punës”.

Aktualisht, shumica e grave pensioniste në Kosovë marrin vetëm pension social, pasi nuk ishin pjesë e fuqisë legale të punës. Kurti ka premtuar mbështetje edhe për gjyshet që kujdesin për nipat dhe mbesat. “Gjyshërit kujdestarë do të përfitojnë nga një skemë subvencionimi. Ata do t’i marrin 100 euro shtesë mbi pensionin e tyre”.

Por, ai nuk ka raportuar ndonjëherë se çfarë u bë me premtimet e qeverisjes së kaluar për të mbështetur banimin e përballueshëm për katër mijë familje të çifteve të reja, grave kryefamiljare dhe shërbyeseve civile.

PDK-ja, shtesa për fëmijë e subvencione biznesi

Edhe kandidati i PDK-së për kryeministër, Bedri Hamza, njëherësh Kryetar i Mitrovicës së Jugut, gjatë fushatës më shumë ka folur për shtesat për fëmijët sesa për krijimin e programeve të veçanta për përkrahje grave që detyrohen të merren me punë shtëpie dhe të kujdesen për fëmijët dhe pleqtë njëherësh.

Dihet mirëfilli se nëpër qytetet e Kosovës është fort i kufizuar numri i çerdheve publike. Edhe në raste kur

ndërtohen objekte të reja dhe janë të gatshme, sikurse ndodh në Ferizaj, niveli qendror nuk ua lejon komunave ta rrisin numrin e personelit edukativ që çerdhet të menaxhohen nga komunat për shkaqe buxhetore.

Por, Hamza i PDK-së, i cili ka gjasa ta marrë drejtimin e qeverisë nëse partia e tij ia del të sigurojë ndonjë ujdi koalicioni, ka thënë vazhdimisht se nëse do ta ketë timonin e ekzekutivit pas zgjedhjeve do të ofrojë nga 100 euro në muaj subvencion për çdo fëmijë të çifteve të reja për të mbuluar një hise të shpenzimeve për çerdhet publike.

Megjithatë, pos numrit jashtëzakonisht të ulët të çerdheve publike, shumica e prindërve nuk aplikojnë fare në to, pasi kryesisht pranohen fëmijët e zyrtarëve politikë dhe të faretësisë të tyre, ose të punëtorëve të administratës publike që i shfrytëzojnë lidhjet me administratën lokale.

“Për gratë, 30 për qind subvencione për të gjitha ato që dëshirojnë ta zgjerojnë biznesin. Për ato që duan të hapin biznes për herë të parë, përkrahje me grante, para pa kthim. Do t’i prezantojnë idetë e tyre, vizionin e tyre, kurse financimin fillestar do ta garantojë shteti”, ka thënë Hamza, ekonomist me profesion.

LDK-ja me Ministri të Mirëqenies dhe Familjes

LDK-ja krenohet se me nisjen e zbatimit të mësimi tërëditor në shkollat fillore të Prishtinës ka krijuar lehtësira për gatë e punësuar. Në programin “Rruga e re”, LDK-ja ka premtuar themelimin e Ministrisë së Mirëqenies dhe Familjes.

“Kjo ministri do të shërbejë si pikë qendrore për të gjitha politikat, nismat dhe programet me në qendër familjet dhe mirëqenien e përgjithshme

shoqërore”, thuhej në programin e fushatës së LDK-së.

Me Ligjin aktual të Familjes, kujdesi për fëmijët bie së pari mbi shpatullat e prindërve, të cilët detyrohen – edhe sipas ligjit, të kujdesen edhe për pleqtë për shkak të mungesës së kapaciteteve shtetërore për t’iu ofruar përkrahje qytetarëve që kanë kontribuar gjatë gjithë jetës me taksa dhe kontribute pensionale gjatë kohës sa ishin aktivë në tregun e punës.

“Mirëpritja e një anëtar të ri në familje është një rast i jashtëzakonisht gëzimi, por vjen edhe me një numër sfidash. Duke njohur një mori kostosh fillestare me të cilat përballen prindërit, nga pelenat dhe pajisjet për fëmijë te kujdesi shëndetësor dhe ushqimi, ‘Skema e Mbështetjes Thelbësore për të Porsalindurin’ është krijuar për të lehtësuar këto barrat”, shkruan në “Rrugën e Re” të LDK-së, por nuk specifikohet shuma e shtesës për fëmijën e parë. Krejt skema llogaritet se do të kapë vlerën e rreth 30 milionë eurove.

“Viti i parë i jetës së një fëmije nuk është vetëm themelor për rritjen e tij fizike dhe njohëse, por është edhe periudhë përshtatjeje dhe lidhjeje për të gjithë familjen. Presionet financiare nuk duhet t’i lënë në hije këto momente të çmuara”.

Njëherësh në “Paketën financiare për fëmijën e tretë”, LDK-ja ka premtuar 500 euro për çdo fëmijë të tretë. Këtë mbështetje, partia e tretë pas zgjedhjeve, e vlerëson si fuqizim për vlerat familjare dhe shoqërore, sidomos për familjet që aspirojnë të rriten.

“Supershtesat” e AAK-së

Edhe Ramush Haradinaj, Kryetar i AAK-së, që garoi në zgjedhje në koalicion me Nismën Socialdemokrate, ka premtuar mbështetje për gratë, por që gjithashtu fokusohet në shtesat për fëmijë.


“Me programin tonë, gratë do të kenë mbështetje konkrete: 1.500 euro për fëmijën e parë, 2.500 për të dytin dhe 3.500 për të tretin, pagë minimale 500 euro për nënat me më shumë fëmijë, garanci shtetërore për bizneset e udhëhequra nga gratë. Arsimi profesional do të harmonizohet me tregun e punës, duke hapur perspektiva të reja për vajzat dhe gratë”, kishte premtuar Haradinaj më 9 janar në takim me gratë e Gjilanit.

Megjithatë, me ligjet aktuale, paga minimale në Kosovë është përcaktuar 350 euro dhe për jetësimin e këtij premtimi – nëse AAK-ja bëhet pjesë e pushtetit – do të duhen ndryshime ligjore.

Në Ferizaj, zyrtari i lartë i pushtetit lokal thotë se partia e tij duhet të punojë më fort që t’ua mbush mendjen sa më shumë grave.

“Gratë e kanë bërë dallimin”, thotë pezmatueshëm ndaj rezultatit zgjedhor:

Gratë në media – prezenca që s’është



Xhemajl Rexha

Të paktën katër net rresht gjatë javës, duke ndërruar kanalet televizive mes orës 20:00 dhe 22:00, skena është e njëjtë: gjashtë burra të ndarë në dy pjesë të ndryshme të studios që bërtasin njëri ndaj tjetrit, ndërsa një moderator – gjithashtu burrë – përpigjet të mbajë “rendin” e debatit. Temat? Çështje nga më komplekset, nga sovraniteti e mbrojtja e kufijve,

deri te siguria dhe marrëdhëniet ndërkombëtare – të gjitha të trajtuara sikur janë ekskluzivisht fusha të rezervuara për burrat.

Nga nëntë debatet televizive që zhvillohen në mbrëmje në mediat kryesore të Kosovës, vetëm njëri udhëhiqet vazhdimisht nga një grua, ndërsa një tjetër herë pas here. Gratë, që përbëjnë gjysmën e popullsisë së vendit, vazhdojnë të mungojnë në diskutimet kyçe të temave politike e sociale. Pavarësisht se kjo është e qartë për të gjithë – madje edhe pranohet – ndryshime të prekshme për të siguruar një përfaqësim të drejtë ende nuk po ndodhin.

Kur pyeten për arsyt, redaktorët dhe drejtuesit e emisioneve e kanë një përgjigje të gatshme: “Gratë refuzojnë të vijnë në emisione”. Dhe në shumë raste, me të drejtë! Nëse for-

matet mbeten të njëjta, me debate që shpesh shndërrohen në arenë përplasjesh verbale dhe ambiente të ngarkuara me agresivitet, atëherë refuzimi i grave për të qenë pjesë e kësaj klime toksike është plotësisht i kuptueshëm.

Në diskutime të shumta publike, gazetaret, analistët dhe politikanët kanë shpjeguar pse nuk pranojnë të jenë pjesë e këtyre debateve. Përveç trajtimit patronizues dhe ndërhyrjeve të vazhdueshme nga bashkëbiseduesit burra, ato shpesh përballen me sulme të ashpër në mediat sociale. Çdo fjalë e tyre analizohet me lupë dhe komentohet me një dozë të lartë paragjykimi gjinor. Ndryshe nga kolegët e tyre burra, të cilët mund të shfaqin agresivitet dhe ta kalojnë pa shumë pasoja, gratë përballen me komente denigruese, fy-

erje dhe kërcënime online.

Televizionet dhe platformat mediatike shpesh ankohen për mungesë burimesh njerëzore për t’i moderuar hapësirat e tyre online, por kjo nuk justifikon faktin që ato nuk ndërmarrin as hapat më minimalë për të siguruar një ambient më të sigurt për gratë në debatet publike. Fshirja e komenteve që nxisin urretje gjinore, ndalimi i gjuhës së dhunshme dhe moderimi aktiv i komenteve në platformat e tyre, duhet të jenë prioritetet minimale për secilin medium që pretendon të promovojë një diskutim publik të shëndetshëm dhe gjithëpërfshirës.

Për më tepër, nëse disa emisione përpigjet të kenë të paktën një mysafire grua në javë (krahas pesë burrave), disa të tjera e kanë braktisur edhe këtë përpjekje simbolike, duke zhvilluar debate për javë të tëra

pa praninë e asnjë gruaje. Zero.

Megjithatë, gratë politike në Kosovës kanë treguar ndër vite se janë të gatshme të përballen me pyetje të vështira dhe të diskutojnë për çështje komplekse. Ato kanë dalë përballë publikut dhe janë përgjigjur për temat më delikate, madje edhe në raste kur kolegët e tyre burra janë shmangur nga debati. Pavarësisht pengesave, gratë në politikë, gazetarit dhe shoqëri civile kanë dëshmuar se kanë aftësitë dhe guximin për të kontribuar në debatet publike – por ato nuk duhet të jenë të detyruara të përballen me një mjedis të pabarabartë dhe armiqësor për ta bërë këtë.

Autor i emisionit "Interaktiv Talks" dhe kryetar i Asociacionit të Gazetarëve të Kosovës.

Kur mbushet një sallë bosh



Elizabeth Gowing

Ishte ditë e ftohtë nëntori, në vitin 2023. Po mërdhija në sallën e sportit të Akademisë së Kosovës për Siguri Publike, në Vushtrri. Bashkë me kolegët nga Zyra e Kryeministrit dhe stafin e Akademisë e rregullonim sallën për një eksperiment.

Eksperimenti ishte konceptuar një vit përpara, kur e kishim shqyrtuar informatën për kadetët në gjeneratën e fundit të Policisë së Kosovës. Gjatë parakalimit të kadetëve të rinj shihnim fytyrat e grave dhe burrave që kishin arritur të kalonin nëpër sfidat e procesit të rekrutimit dhe që tash po fillonin të shërbenin në shtetin e tyre. Diçka mungonte mes gjithë atyre fytyrave krenare... Midis të gjithë kadetëve vetëm një ishte nga komuniteti rom. Një burrë. Prej komunitetit ashkali dhe atij egjiptian - asnjë burrë dhe asnjë grua.

Salla e madhe brenda Akademisë, ku isha me kolegët, dukej si metaforë – një vend që duhej të ishte plot energji, por ku, aktualisht, mungonin pjesëmarrësit.

Unë kam punuar me komunitetet rome, ashkali dhe egjiptiane për më shumë se 14 vjet. Fillimisht si vullnetare në organizatën joqeveritare The Ideas Partnership, ku isha bashkëthemeluese, pastaj si konsulente në projekte ndërkombëtare të Save the Children, UNICEF-it, Caritas-it, etj., ndërsa gjatë tre vjetëve të fundit si Këshilltare e Kryeministrit Albin Kurti për Çështje të Komuniteteve. Përgjatë këtyre viteve jam takuar me shumë studente, të diplomuara, ndërmarrëse, gra dhe vajza të tjera të fuqishme të komuniteteve, për të cilat e di se i kanë aftësitë që do të çmo-

heshin brenda Policisë së Kosovës. Mungesa e tyre më pengon shumë.

Gjatë vitit 2023, shumë akterë u angazhuan për të inkurajuar rekrutime të suksesshme për komunitetet brenda policisë. Rekrutimi i radhës shënoi përmirësim – prej një burri rom, numri i kadetëve nga komunitetet rome, ashkali dhe egjiptiane u rrit në gjithsej 9. Tri prej tyre gra. Por, prapë nuk ishim të kënaqur.

Kështu që, në bashkëpunim me stafin e Akademisë, OSBE-në dhe agjencitë e përfaqësuara aty, me Këshilltarin ashkali të Kryeministrit, Artan Asllanin, si dhe me kolegë nga Zyra për Çështje të Komuniteteve dhe Zyra për Qeverisje të Mirë, e organizuam këtë event në sallën e Akademisë, që të rinjtë e komuniteteve të dëgjonin mbi mundësitë për të krijuar karriera, si dhe të inkurajoheshin të aplikonin në rekrutimin e ardhshëm. Sa do të vijnë në këtë “Ditë të Hapur”? Nuk e dimë. A do të frymëzohen edhe vajzat, edhe djemtë? Mbetet për t’u parë. Sa do të ndikojë në aplikime? Është eksperiment.

Autobusi i parë mbërrin nga Ferizaj. Një autobus nga Mitrovica, një tjetër nga Fushë Kosova dhe Obiliqi. Pak nga pak, salla mbushet.

Arrin edhe Kryeministri Albin Kurti, bashkë me ministrat Sveçla dhe Rashiq. Ata afrohen te grupet e adoleshentëve dhe fillojnë të bashkëbisedojnë. Bëhen dhjetëra selfie. Unë e vërej një vajzë serioze duke biseduar me një police prej komunitetit që ka ardhur ta ndajë përvojën e saj. Në anën tjetër të sallës, një vajzë tjetër ka marrë një fletë-palosje dhe po e lexon...

Në raundin e radhës të rekrutimit për Policinë e Kosovës, numri i kadetëve romë, ashkali dhe egjiptianë ariti në 29. Tetë prej tyre - gra. Nga takimi i asaj dite – nëntë.

Përvoja në atë sallë – bashkë me shumë iniciativat në ndërmarrja nga institucione dhe partnerë të ndryshëm, ka dëshmuar që është e mundurshme të ndryshohet punësimi i grave të komuniteteve rome, ashkali dhe egjiptiane. Kërkohen ndërhyrje të

ndryshme – disa të vogla dhe afatshkurta, siç ishte “Dita e Hapur”, të tjerat investime më të mëdha dhe afatgjata. Qeveria po investon në qendrat mësimore – në vitin 2024 me një rritje prej 25%, deri një çerek milion euro. Këto qendra janë të nevojshme duke marrë parasysh që, për shembull, në komunitetin rom vetëm 6% e vajzave të moshës 7 deri 14 vjeçare i kanë shkathtësitë bazë matematikore, përkundër 12% të djemve (dhe 42% të fëmijëve në tërë Kosovën).

Gjithashtu e dimë që qindra të mitur humbin mundësitë për arsimim, pastaj edhe për punësim, shkaku i fenomenit të martesës së hershme (sipas UNICEF-it bashkë me Agjencinë e Statistikave të Kosovës, 31% të grave rome, ashkali dhe egjiptiane martohen nën moshën 18 vjeçare). Për luftimin e kësaj dukurie kemi formuar Grupin Punues Ndërinstitucional, që kryesohet prej meje, i cili bashkon përfaqësues të institucioneve qendrore dhe lokale, tok me partnerët ndërkombëtarë, shoqërinë civile dhe anëtarët e komuniteteve.

Edhe nëse vajzat e komuniteteve arsimohen mirë në arsimin obligativ dhe nuk martohen herët, sfida për vazhdimin e arsimit në shkolla të mesme shpesh ka të bëjë me faktorin ekonomik. Për këtë, Qeveria e Kosovës ka ndarë bursa – në dy vitet e fundit gjithsej 884 – dhe prej tyre 51% u janë dedikuar vajzave. Për studentët romë, ashkali dhe egjiptianë në universitetet publike gjatë kësaj periudhe janë ndarë 95 bursa – 59% për vajza.

Vajzat rome, ashkali dhe egjiptiane e tregojnë veten të gatshme t’i shfrytëzojnë mundësitë e ofruara. Pra, ku mbeten sfidat kryesore? Patjetër që vajzat dhe gratë rome, ashkali dhe egjiptiane përballen me të njëjtat sfida si gratë tjera në Kosovë. Për shembull, vlerësohet që gratë në Kosovë çdo ditë kalojnë 6.2 orë në punë përkujdesjeje pa pagesë.

Por, siç thotë Drejtoresha Ekzekutive e OJQ-së Balkan Sunflowers Kosova, Ferdane Asllani, që punon me komunitetet, ekziston një sfida



shitesë ndërsektoriale që i dyfishon vështirësitë e vajzave dhe grave nga komunitetet. Edhe tash, kur ka vende të lira pune në ekonominë e Kosovës dhe ka kuadro prej komuniteteve rome, ashkali dhe egjiptiane që kanë vijuar shkollë dhe kanë diplomuar nga fakultetet. Ku qëndron problemi?

“Me një fjalë: diskriminimi” – deklaroi ajo. “Ose nuk pranohen, ose pranohen në pozita më të ulëta. Jo nëpër zyra, por në ndonjë depo. Dhe nëse janë gra, punëdhënësit hezitojnë t’iu japin punë nëpër magazina, pra nuk i punësojnë hiç”. Ferdanja tregon rastin e një stomatologeje të diplomuar ashkali, që nuk mund të gjejë punë në profesionin e saj.

“Çka punon ajo momentalisht?”, e pyes.

“Ajo po e mëson gjuhën gjermane për t’u larguar nga Kosova”, më thotë Ferdanja me keqardhje.

Do të jetë një humbje e madhe për shoqërinë kosovare nëse – përkundër të gjitha investimeve dhe mbështetjeve për individë me talente, punëdhënësit kosovarë prapëseprapë preferojnë të punësojnë burra nga Bangladeshi, sesa gra të kualifikuara rome, ashkali ose egjiptiane nga Kosova.

Luftimi i diskriminimit, i theksuar edhe nga Ferdanja, kërkon përpjekje të mëdha dhe qasje mendjehapur nga shumë akterë. Megjithatë, tash që e rikujtoj sallën e Akademisë në Vushtrri, si ishte mbushur me vajza dhe gra të talentuara të komuniteteve, kam shpresë – por, edhe bindje – për mundësinë e njëjtë që edhe zyrat e kompanive, edhe Ministrinë – madje edhe klinikat stomatologjike – të mbushen në të njëjtën mënyrë.

Autorja është Këshilltare e Kryeministrit Albin Kurti

Fuqizimi i të mbijetuarave: Rimëkëmbja përmes integritetit në tregun e punës



Feride Rushiti

Sot, në Ditën Ndërkombëtare të Gruas, është momenti për të reflektuar mbi rrugën e gjatë dhe të vështirë që vajzat dhe gratë në mbarë botën kanë ndjekur për t’u afirmuar e për të arritur mundësi të reja në fusha të ndryshme të jetës dhe punës. Ky udhëtim, plot pengesa, është gjithmonë mbushur me forcë dhe përkushtim, megjithatë duhet të kujtojmë se ende ka shumë për të arritur dhe çdo hap drejt barazisë sjell një hap më afër një bote ku çdo grua dhe vajzë ka mundësinë ta zhvillojë plotësisht potencialin e saj.

Kjo ditë gjithashtu është një mundësi për të prekur një nga problemet më të thella që shoqëritë e prekura nga lufta, sidomos në Kosovë, kanë ende për të adresuar – pasojat e dhunës seksuale gjatë konfliktit të viteve ‘90 dhe sfidat që mbi-jetuarit përballojnë çdo ditë. Vajzat dhe gratë që kanë përjetuar trauma të pafundme luftojnë vazhdimisht për t’u riintegruar në shoqëri, duke u përballur me ndjenja turpi dhe stigmatizimit që i bëjnë të ndihen të padëgjua dhe shpesh të harruara.

“Shumë faleminderit që e kemi një derë kësaj të madhe siç është KRCT, për t’i qarë hallet dhe dertet bashkë”

Në Kosovë, ku dhuna seksuale gjatë luftës ka lënë plagë të thella dhe të përhershme, këto fjalë nga gratë dhe vajzat që i kemi mbështe-

tur përmbledhin thelbin e punës sonë. Ky është një moment për të kujtuar, për të nderuar dhe, mbi të gjitha, për të vepruar.

Si themeluese dhe drejtore e Qendrës Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës (QKRMT), duke dëgjuar qindra histori të pafolura të luftës, ndiej një përgjegjësi të thellë për të sjellë në vëmendje realitetin e grave dhe vajzave që kanë përjetuar këtë dhunë dhe për të theksuar rolin jetik që organizata jonë luan në mbështetjen, rehabilitimin dhe fuqizimin e tyre.

Pasojat e dhunës seksuale të luftës nuk janë vetëm personale - ato e kanë formësuar shoqërinë tonë, duke e thelluar stigmën dhe diskriminimin. Gratë dhe vajzat që përjetuan këtë dhunë shpesh janë përballur jo vetëm me traumën fizike dhe psikologjike, por edhe me përjashtimin shoqëror, me pengesa në zhvillimin personal dhe profesional, madje edhe me dhunë të vazhdueshme brenda familjes.

Për më shumë se një çerek shekulli, QKRMT ka qenë zëri dhe mbështetja e tyre - duke sfiduar normat shoqërore patriarkale, duke siguruar njohje ligjore dhe duke ofruar ndihmë të drejtpërdrejtë përmes shërbimeve psikologjike, shëndetësore dhe ligjore. Për gratë dhe vajzat që shpesh ndihen të vetmuara dhe të harruara, ne jemi ai ambienti i sigurt që u jep shpresë dhe forcë për të rindërtuar jetën.

Përmes këshillimeve psikologjike dhe grupeve mbështetëse ne ndihmojmë të mbijetuarat t’i përballojnë pasojat emocionale dhe mendore të dhunës. Programet tona ofrojnë gjithashtu mbështetje ligjore dhe hapësira për të kërkuar drejtësi e reparacione. Misioni ynë është të rikthejmë besimin dhe dinjitetin e tyre, duke i bërë pjesë të një shoqërie që jo vetëm i pranon, por i vlerëson dhe i fuqizon.

Ndryshimi nuk ndodh vetëm duke i treguar historitë e tyre, por duke vepruar për të siguruar që këto histori të mos përsëriten kurrë më.

Shumë nga gratë dhe vajzat, pasi kanë përfunduar ciklin e rehabilitimit, ndihen të fuqizuara për të kontribuar aktivisht në shoqëri, por një nga pengesat kryesore është stigmatizimi që përjetojnë në shoqëri dhe deri në tregun e punës. Ky problem i vazhdueshëm shpesh i pengon në angazhimin profesional dhe në ndërtimin e një të ardhme të qëndrueshme financiare. Shpesh ato ndihen të turpëruara dhe të frikësura nga reagimet negative të mjedisit rrethues, gjë që krijon një cikël izolues dhe pasiguri në kërkimin e mundësive për punësim.

Për të siguruar që gratë dhe vajzat e mbijetuara nga dhuna seksuale të kenë mundësi të barabarta në tregun e punës, është thelbësore të krijohen mundësi të qëndrueshme arsimimi dhe trajnimi. Në QKRMT ne angazhohemi për t’u ofruar këtyre

grave mjetet dhe aftësitë e nevojshme që jo vetëm të konkurrojnë në tregun e punës, por edhe të rindërtojnë jetën e tyre me dinjitet dhe pavarësi.

Së fundmi, QKRMT ka ndikuar në fuqizimin ekonomik të të mbijetuarve, pasi dhjetëra gra dhe vajza të mbijetuara kanë përfutur mbështetje konkrete për ndërmarrjet e tyre të vogla. Kemi siguruar mjetet e nevojshme për zhvillimin e bizneseve në fusha të ndryshme, si pasticeria, bujqësia, blegtoria dhe rrobaqepësia. Përmes këtyre iniciativave synojmë të fuqizojmë gratë dhe vajzat jo vetëm ekonomikisht, por edhe të ndërtojmë një themel më të fortë për pavarësinë e tyre afatgjatë.

Përmes këtyre iniciativave kemi kuptuar sa i rëndësishëm është krijimi i një mjedisi mbështetës, ku gratë dhe vajzat mund të zhvillojnë plotësisht potencialin e tyre. “Tani ndihem e pavarur, sepse i kam mjetet e mia dhe puna më është lehtësuar”, thonë shpesh të mbijetuarat kur i takojmë, duke pasqyruar ndikimin e prekshëm të këtij angazhimi. Ky është thelbi i ndryshimit: të tregojmë se e kaluara nuk përcakton të ardhmen dhe të ndërtojmë një realitet ku siguria, mbështetja dhe respekti janë themelore.

Kur gratë dhe vajzat fuqizohen, ato jo vetëm që rimëkëmben, por edhe kontribuojnë në një shoqëri më të drejtë dhe gjithëpërfshirëse.

Çdo hap drejt rehabilitimit dhe integritetit është një fitore. Prandaj,

edhe këtë vit, në Ditën Ndërkombëtare të Gruas, dua ta dërgoj një mesazh të fuqishëm për të gjitha gratë dhe vajzat: besoni në potencialin tuaj për ndryshim! Kjo është një ditë për të festuar forcën, qëndrueshmërinë dhe guximin që gratë dhe vajzat kanë treguar në çdo fushë të jetës, duke përballuar sfida të papërkrahshme dhe duke ndërtuar një shoqëri më të drejtë dhe të barabartë.

Gjatë viteve kam qenë dëshmitare e forcës së jashtëzakonshme të grave dhe vajzave të mbijetuara të dhunës seksuale nga Lufta e Kosovës. Pavarësisht traumës së thellë dhe pengesave të panumërta, ato vazhdojnë të luftojnë për të rindërtuar jetën dhe për të kërkuar drejtësinë që u takon.

Punësimi është çelësi për rikuperim dhe integritet. Prandaj, i ftoj institucionet dhe bizneset private të krijojnë mundësi reale për mbijetuarat, duke i ndihmuar të rikthejnë jo vetëm pavarësinë financiare, por edhe ndjenjën e qëllimit dhe normalitetit. Një vend pune nuk është vetëm një burim të ardhurash – është një hap drejt kapërcimit të izolimit dhe stigmatizimit, një mundësi për zhvillim, shërim dhe përfshirje sociale.

Autorja është Drejtoresha Ekzekutive e Qendrës Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës (QKRMT).

Edukimi seksual në shkolla: Nevojë urgjente

Anita Nikaj

Gjithçka që di për trupin tim, për marrëdhëniet seksuale, për mbrojtjen dhe për shëndetin riprodhues, e kam mësuar vetë nga interneti, nga shoqet, nga përvoja dhe ndonjëherë, edhe nga gabimet. Kjo si pasojë e asaj që edukata seksuale asnjëherë nuk është ligjëruar në shkollat tona, përveç një kapitulli në biologji të klasës së pestë, i cili gjithmonë është kaluar, pasi që mësimdhënësit nuk kanë qenë të trajnuar për ta ligjëruar, por edhe pse ata e kanë konsideruar si të panevojshme.

Edukata seksuale në Kosovë ka qenë një temë diskutimi dhe debati të vazhdueshëm, veçanërisht në lidhje me përfshirjen e saj në kurrikulën shkollore. Pavarësisht miratimit të kurrikulës së re në vitin 2017, edukata seksuale nuk po arrin të gjejë vend në shkolla as në vitin 2025. Edukimi seksual nuk ka të bëjë domosdoshmërisht vetëm me riprodhimin. Edukimi seksual përfshin një varg gjërash si: pëlqimi, marrëdhënia e shëndetshme (qoftë fizike a platonike), mbrojtja ndaj sëmundjeve seksualisht të transmetueshme, mbrojtja ndaj shtatzënisë së padëshiruar, identiteti gjinor, orientimi seksual, e mbi të gjitha edukimi për të drejtën trupore.

Çka ndodhi në vitin 2024?

Në nëntor të vitit 2024, doracakët për edukimin seksual dhe shëndetin riprodhues për mësimdhënësit u bënë objekt i diskutimeve publike. Kjo ndodhi kur u tentua që në vitin e ri akademik kurrikula e propozuar e vitit 2017 të fillonte të implementohej. Për fatin e keq, kjo ishte kohë fushate, ku individë dhe grupe të caktuara filluan ta përdornin këtë doracak. Në një anë kemi një masë të pafajshme, të pastër, të viktimizuar, por prapë të lartësuar, dhe në anën tjetër janë elitat e korruptuara, manipuluese dhe

satelite të agjendave të huaja. Edukimi seksual në shkolla është si një buton rreziku që gjithmonë mobilizon masën për të keq, ndërsa vazhdimisht ngjall debate mes edukatës fetare apo edukatës seksuale në shkolla. Këtë e elaboron më së miri ish-deputeti i Lëvizjes Vetëvendosje, Eman Rrahmani, në Kuvendin e Kosovës. “Në atë kurrikulë mësohen se si mësimdhënësit t’iu tregojnë fëmijëve nga klasa e parë deri në klasën e 12-të se si i kryejnë marrëdhëniet e tyre në shtëpitë e tyre...”.

Në kontekstin politik dhe medial, edukata seksuale shpesh shndërrohet në një armë për t’u përdorur nga aktetë të ndryshëm, të cilët tentojnë që ta paraqesin si një kërcënim ndaj “vlerave tradicionale”. Aktetë populistë, shpesh të lidhur me ideologji konservatore, keqinterpretojnë përmbytjen e saj, duke e paraqitur si një tentativë për “indoktrinim”, ose “shkatërrim të familjes tradicionale”. Përmes dezinformimit dhe frikësimit, ata synojnë t’i minojnë përpjekjet për arsimim gjithëpërfshirës dhe shkencor mbi seksualitetin, duke e reduktuar atë në një debat moral dhe ideologjik.

Një strategji e zakonshme në këtë kontekst është krijimi i panikut moral përmes narrativave se edukata seksuale “promovon seksualizimin e fëmijëve”, ose “inkurajon devijime”. Këto diskurse jo vetëm që nuk kanë mbështetje shkencore, por gjithashtu krijojnë një terren të favorshëm për kufizimin e të drejtave të grave, personave LGBTQ+ dhe grupeve tjera të marginalizuara.

Ky është vetë një shembull i vogël se si u keqpërdor debati sa i përket edukatës seksuale në shkolla. Nuk ishte qëllimi që të diskutohej në mënyrë të mirëfilltë, mirëpo të gjendej “kurbani” i kësaj nisme. Se pse fëmijët tanë duhet të mësojnë për edukatën seksuale.

Qe pse edukata seksuale duhet të

fillojë që të ligjërohet sa më parë në shkollat tona.

Përmes edukimit seksual, duke përfshirë diskutime mbi barazinë gjinore, respektin dhe vendimmarrjen e ndërsjellë, edukimi seksual sfidon narrativat e dëmshme që forcojnë privilegjin e burrave dhe nënshtrimin e grave, duke promovuar marrëdhënie më të shëndetshme dhe më të barabarta.

Duke e përfshirë edukimin seksual në shkolla, normalizohet diskutimi mbi autonominë trupore dhe respektin ndaj vetes dhe tjetrit. Edukimi seksual është i lidhur ngushtë edhe me të drejtat riprodhuese. Të mohuarit e individëve prej njohurive mbi kontracepsionin, planifikimin familjar dhe shërbimet e shëndetit riprodhues, ndikon në mënyrë disproporcionale tek gratë, duke e kufizuar kontrollin e tyre mbi të ardhmen. Na mundëson kontroll të lindjeve, qasje më të sigurt në abort dhe shërbime të shëndetit riprodhues. Kur gratë pajisen me këto njohuri, ato mund të marrin vendime të informuara nëse dhe kur duan të kenë fëmijë, duke përmirësuar mundësitë e tyre ekonomike dhe shoqërore.

Na mëson se pëlqimi është shumë i rëndësishëm në çdo raport që kemi më palën tjetër. Edukimi i hershëm vendos kufij të qartë dhe forcon idenë se çdo aktivitet seksual duhet të jetë i pranuar nga të dyja palët. Ne shohim çdo ditë se vajzat e reja janë më të cenueshme ndaj abuzimit dhe detyrimit.

Asnjë nga informacionet e mangëta të cilat i kemi marrë në kapitullin e riprodhimit në biologji nuk ofron perspektivë gjithëpërfshirëse, duke i lënë të rinjtë LGBTQ+ pa njohuritë e nevojshme për t’i naviguar marrëdhëniet dhe për të mbrojtur shëndetin e tyre.

Edukimi seksual gjithëpërfshirës duhet të përmbajë diskutime mbi

orientimet seksuale, identitetet gjinore dhe marrëdhëniet LGBTQ+. Kur të rinjtë i shohin identitetet e tyre të reflektuara në edukimin e tyre, ata kanë më shumë gjasa të zhvillojnë një mirëkuptim të shëndetshëm për veten dhe të ndihen të pranuar në shoqëri.

Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSH) e përcakton edukimin seksual gjithëpërfshirës si një proces të bazuar në kurrikulë që u ofron të rinjve njohuri mbi seksualitetin në një mënyrë të përshtatshme për moshën, të rëndësishme për kulturën dhe të bazuar në fakte shkencore.

Njohja e fakteve dhe ato që plasohen vazhdimisht në mediat tona janë dy gjëra të ndryshme. Kurbani i gjithë kësaj u bë ministria e arsimit, e cila me ose pa dëshirën e saj u detyrua që ta largonte nga shkollat këtë doracak, në mënyrë që të “rishikohej” edhe një herë, ani pse që nga viti 2021 ishte lajmëruar se këta doracakë së shpejti do të fillonin të implementoheshin në shkollat tona. Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit njoftoi se kishte nxjerrë vendim për rishikimin e doracakëve “Edukimi seksual dhe shëndeti riprodhues”, të miratuar në vitin 2020.

Në anën tjetër, tërë gjurulldia nuk kaloi pa përfshirjen e të gjitha partive politike, të cilat e panë këtë si një mundësi të artë për të marrë një grusht votash në ato hapësira të cilat nuk mund të depërtonin. Këtu priu Lidhja Demokratike e Kosovës, pasi përmes Drejtorisë së Arsimit në Prishtinë njoftoi se këta doracakë nuk do të përdoreshin në komunat që udhëhiqeshin nga kjo parti, pasi kishte si qëllim “degjenerimin e familjeve”.

“Sot kam marrë vendim për ndalimin e përdorimit të Doracakëve ‘Edukimi Seksual dhe Shëndeti Riprodhues’ 1-5, 6-9 dhe 10-12, në shkollat e Prishtinës. I bëjmë thirrje të gjitha komunave të marrin hapa dhe të ndalojnë përdorimin e këtyre materialeve në shkollat e tyre. Është e pa-

precedentë, se si ky pushtet po keq-trajton familjen kosovare. Është skandalozë se si Ministria në pushtet, në krye të të vetmit institucion përgjegjës për tekstet mësimore, ka aprovuar dhe ka promovuar material me përmbajtje perverse. Këto tekste në vend se të plasnin njohuri e diskutim bazik për edukimin seksual, kanë paraparë aktivitete në praktikë - prekje me fëmijë nën moshën adekuate. Kjo përmbajtje është jo vetëm e dëmshme, por edhe abuzuese me fëmijët” - kishte deklaruar Jehona Lushaku – Sadriu në nëntor të vitit 2024.

Edukata seksuale nuk e ka si qëllim “degjenerimin e familjeve”, përkundrazi ka si qëllim gjithëpërfshirjen, ku një familje mund të përbëhet nga një nënë dhe baba, një nënë dhe një nënë, një baba dhe një baba, vetëm një nënë, apo edhe vetëm një baba. Familja nuk duhet domosdoshmërisht të përbëhet nga një grua dhe një burrë, se pastaj i kontribuojmë shtypjes, mbylljes e izolimit të familjeve të cilat nuk u përshtaten normave të cilat një shumicë i ka vendosur. Tekefundit, kush jemi ne të tregojmë se si duhet të rritet një fëmijë, në bashkësi apo vetëm?

Ashtu siç ka deklaruar Judith Butler, seksualiteti dhe identiteti gjinor janë të ndërlidhura dhe nuk mund të kuptohen pa i marrë parasysh shoqëritë dhe sistemet e shtypjes. Duke argumentuar se edukata seksuale duhet të shkojë përtej kategorive tradicionale dhe t’i pranojë identitetet e ndryshme.

Tërë këto diskutime rreth edukatës seksuale në Kosovë reflektojnë domosdoshmërinë për balancim ndërmjet traditave kulturore dhe nevojës për informim të duhur të të rinjve. Pavarësisht sfidave, përpjekjet për integrimin e edukatës seksuale në sistemin arsimor vazhdojnë, me synimin për të siguruar një edukim gjithëpërfshirës dhe të shëndetshëm për brezat e ardhshëm.

Një shoqëri në heshtje, një epidemi e patrajtuar

ndaj grave u raportuan në Kosovë. Në vetëm një ditë të muajit shkurt të këtij viti, në titujt e lajmeve u raportuan disa ngjarje të rënda me fokus të dhuna ndaj grave. Një burrë u arrestua pasi i kishte kufizuar lëvizjen e bashkëshortes së tij në vendin e punës, një burrë tjetër u arrestua pasi kishte abuzuar një vajzë, dhe në të njëjtën ditë në Gjiilan u organizua një protestë për rastin e një gruaje që dyshohej se ishte dhunuar dhe trafikuar. Këto nuk janë ngjarje dhe raste të izoluar, këto janë simptoma të një problemi shoqëror që kërkon më së paku një reagim shtetëror të koordinuar dhe të qëndrueshëm në parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna.

Në bisedat shoqërore për zgjedhjet e fundit në Kosovë, veçanërisht gratë shprehnin dëshirën për të votuar për gratë candidate, duke besuar se një parlament më i balancuar gjinor do të ndihmonte në avancimin ose adresimin e duhur për të luftuar dhunën sistematike ndaj grave në Kosovë. Ky besim, megjithëse i kuptueshëm, është njëkohësisht problematik. Ai vendos përgjegjësinë e ndryshimit mbi supet e grave, duke e kthyer dhunën ndaj grave në një “çështje të grave”, ku “disa burra të mirë” mund të ofronin ndihmën e tyre sporadike. Dhuna e grave në Kosovë është një problem shoqëror që kërkon një reagim të përgjithshëm dhe angazhim të përbashkët. Gjatë vitit 2024, brenda një jave, dy bashkëshortë vranë gratë e tyre. Njëri nga këto raste ndodhi në hapësirat e Qendrës për Punë Sociale, një vend që supozohej të ishte një strehë e sigurt. Këto akte femicidi tronditën opinionin publik dhe pasuan deklarata të ashpra, fjalime të mbushura me zemërim. Institucionet kërkuan ndëshkimin maksimal për dhunuesit, ndërsa disa të tjerë flisnin për “nevojën për t’i edukuar vajzat”, duke e kthyer barrën e shpëtimit ose mbrojtjes tek viktimat. Gratë.

Kjo qasje nuk është aspak e re, si argument përsëritet sa herë që një vajzë apo grua dhunohet ose vritet, vetëm sa për të forcuar stereotipat patriarkalë që rrënjosen thellë në shoqërinë tonë. Në atë periudhë reagimi i institucioneve ishte i dukshëm, por jo i mjaftueshëm. Ministria e Drejtësisë organizoi një takim emergjent me institucionet e zbatimit të ligjit për të siguruar që këto raste të merrnin dënimin e duhur. Sigurisht, ndëshkimi penal është i domosdoshëm. Megjithatë, trajtimi i femicidit vetëm përmes ndëshkimeve penale rrezikon ta redukojë një problematikë të thellë shoqërore në një në çështje të ndëshkimeve individuale. Një qasje e tillë është jo vetëm e pamjaftueshme, por edhe e rrezikshme, sepse nënkupton që shoqëria dhe institucionet tona kanë dështuar t’i kuptojnë rrënjët e problemit.

Vetëm ndëshkimi i dhunuesve është i pamjaftueshëm si mjet i vetëm, ose primar. Ky lloj mekanizmi nuk mund ta mbrojë një grua të rrahur brenda mureve të shtëpisë së saj, nuk mund të fshijë frikën e një vajze që ecën vetëm natën, e as të ndryshojë mentalitetin e një shoqërie që ende gjen justifikime për dhunën. Nëse ndëshkimi penal mbetet mjeti i parë, ose i vetëm, i luftës kundër dhunës ndaj grave, atëherë kemi dështuar në adresimin e saj në rrënjë. Kultura patriarkale është një sistem i rrënjësor thellë që i përcakton marrëdhëniet gjinore në shoqëri, duke krijuar një hierarki ku pozita e gruas reduktohet në role shërbimi dhe nënshtrimi. Në Kosovë, dhe jo vetëm, ky sistem ka krijuar një realitet ku gratë shpesh shihen përmes një prizmi që ua mohon plotësisht subjektivitetin dhe autonominë e tyre, duke i reduktuar në role të përcaktuara nga pritshmëritë e burrave. Kur një grua dehumanizohet dhe nuk shihet si një qenie njerëzore me vullnet të lirë, dhuna ndaj saj normalizohet dhe tolerohet nga

shoqëria. Ngacmimet në rrugë, dhuna në familje dhe neglizhenca institucionale ndaj rasteve të abuzimit janë të gjitha produkte të një kulture që e pozicionon gruan si inferiore dhe të nënshtruar. Për më tepër, dhuna shpesh gjen justifikim përmes narrativave që fajësojnë viktimën, si “ajo e ka kërkuar vetë”, duke i mohuar asaj dinjitetin, ndërsa agresori lihet pa u mbajtur përgjegjës për veprimet e tij.

Rastet e dhunës ndaj grave shpesh bëhen tituj lajmesh vetëm kur ato marrin përmasa tragjike. Rastet tjera trajtohen si ngjarje të izoluar, jo si simptoma të një problemi të thellë shoqëror. Por, dhuna ndaj grave në Kosovë nuk është thjesht një akt individual; ajo është një refleksim i mentalitetit patriarkal, është një manifestim i shoqërisë sonë që i justifikon dhe madje i lejon këto veprime. Ky është një problem shoqëror për të cilin ka shumë dëshmi që tregojnë se po përkeqësohet në vend që të përmirësohet, megjithëse të dhënat numerike shpesh nuk pasqyrojnë plotësisht rastet e dhunës dhe në vetvete paraqesin një sfidë, duke e bërë të vështirë pasqyrimin e plotë dhe të saktë të shkallës së dhunës ndaj grave. Shumë viktimat nuk e raportojnë dhunën për shkak të frikës, mungesës së besimit të institucionet, ose varësisë ekonomike dhe emocionale nga dhunuesi. Shumë raste tjera nuk raportohen për shkak të turpit dhe stigmatizimit nga shoqëria. Viktimat shpesh hezitojnë të flasin për përjetimet e tyre nga frika e hakmarrjes, humbjes së mbështetjes familjare, ose për shkak të presioneve shoqërore. Në shumë komunitete, sidomos në ato më të izoluar, gratë kanë më pak mundësi për të raportuar dhe për të kërkuar ndihmë. Për këto arsye, është e rëndësishme që fenomeni i dhunës ndaj grave të mos vlerësohet vetëm përmes statistikave, por të analizohet në një kontekst më të gjerë që përfshin për-

vojat e grave, barrierat institucionale dhe normat shoqërore që vazhdojnë ta mbajnë këtë fenomen si një epidemi të patrajtuar. Vetëm një qasje gjithëpërfshirëse dhe një angazhim i vazhdueshëm mund të ofrojë pasqyrimin e plotë të realitetit dhe të na orientojë në gjetjen e zgjidhjeve më efektive për të luftuar dhunën ndaj grave.


Ajo që na duhet është një qasje e qëndrueshme dhe e koordinuar, e cila vë në qendër viktimat dhe të mbijetuarat e dhunës. Ne duhet të krijojmë një ambient ku viktimat dhe të mbijetuarat e dhunës të jenë në qendër të politikave dhe strategjive shtetërore. Këto gra përpiqen t’i rindërtojnë jetët e tyre, të gjejnë strehim dhe t’i ndihmojnë fëmijët të shërohen nga traumat e shkaktuara nga dhunuesit. Shpesh ato përballen me rrezikun e dhunës së përsëritur, një cikël i pafund që kërkon ndërhyrje urgjente. Parandalimi duhet të jetë themeli i çdo përpjekjeje. Nuk mund të presim tragjedi për të reaguar. Institucionet duhet të prioritojnë strategjitë afatgjata dhe inovative të cilat synojnë uljen e dhunës në periudha afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata. Madje, dështimi i institucioneve për të adresuar në mënyrë adekuate këtë problem është një nga sfidat më serioze të institucioneve në Kosovë. Megjithatë, lufta kundër dhunës ndaj grave nuk reduktohet vetëm si përgjegjësi e grave apo institucioneve; ajo është një obligim i përbashkët i të gjithë shoqërisë. Vetëm përmes përpjekjeve të përbashkëta dhe një ndryshimi rrënjësor në mënyrën si e trajtojmë këtë problem mund të krijojmë një të ardhme ku gratë dhe vajzat të jetojnë të sigura dhe të lira nga frika e dhunës.

Autorja është e angazhuar në programe për promovimin e dhe zbatimin e Rezolutës 1325 të Këshillit të Sigurisë së OKB për Gratë, Paqen dhe Sigurinë në Ballkanin Perëndimor.



Egzona Bokshi

Serbia në pikë kthese



Maja Bjeloš

Serbia aktualisht është në një pikë kthese përballë protestave që po vazhdojnë prej katër muajsh. Këto protesta, të cilat filluan pasi u shemb çatia e stacionit të trenit të rinovuar rishtazi në Novi Sad, duke vrarë 15 persona dhe duke plagosur rëndë dy, u shndërruan në një lëvizje sociale që bashkoi studentët dhe qytetarët në përpjekje për të krijuar një shtet dhe shoqëri më të drejtë dhe më demokratike.

Pavarësisht strategjive të ndryshme të qeverisë për t'i shtypur demonstratat, ato po bëhen gjithnjë e më masive, duke u zhvilluar në më shumë se 350 qytete dhe fshatra në Serbi, si dhe jashtë saj. Studentët pushtuan universitetet, qendrat kulturore dhe mobilizuan qytetarët në të gjithë vendin, duke kërkuar nxjerrjen e dokumenteve në lidhje me rindërtimin e stacionit të trenit, ndjekjen penale të atyre që sulmuan protestuesit, hedhjen poshtë të akuzave ndaj protestuesve dhe rritjen e buxhetit për arsimin e lartë. Ata nuk kërkojnë dorëheqje të qeverisë, zgjedhje të parakohshme, apo marrjen e pushtetit nga opozita, por që institucionet të bëjnë punën e tyre.

Presidenti i Serbisë u përpoq t'i joshte studentët duke u ofruar atyre kredi për banim, tekste shkollore dhe tarifa shkollimi falas, por ata e refuzuan dialogun me një institucion jokompetent dhe të paafit, duke besuar se nuk ishte e mundur të flitej në një atmosferë në të cilën qeveria përdor mediat për të nxitur dhunën ndaj studentëve, ndërsa policia dhe Shërbimi i Sigurisë (BIA) frikësojnë prindërit, nxënësit dhe studentët duke i marrë në pyetje gjatë bisedave informative. Krijimi i një atmosfere frike dhe jotolerance rezultoi në goditjen me makina dhe rrahjen brutale të studentëve në protesta, kurse mes të plagosurve rëndë kishte kryesisht vajza. Pavarësisht sulmeve të synuara, studentet nuk u dekurajuan dhe as nuk hoqën dorë nga pjesëmarrja e mëtejshme në protesta.

Presioni ndaj organizatave jo-qeveritare dhe mësimdhënësve që mbështesin studentët, si dhe kërcënimet për padi ndaj fakulteteve dhe shkollave, përfshirë edhe uljet e pagave për profesorët për shkak të ndërprerjes së punës, vetëm sa e kanë përkeqësuar edhe më shumë situatën. Duke qenë se shumica dërrmuese e punonjësve të arsimit janë gra (deri në 75%), këto masa hakmarrëse do të godasin më së shumti arsimtaret dhe profesoreshat.

Revolucioni i Ngjyrosur

Protestat fituan përfundimisht vëmendjen ndërkombëtare, duke u bërë lajm në të gjitha mediat kryesore botërore. Ndonëse disa akterë ndërkombëtarë, si Rusia dhe Kina, e mbështetën hapur presidentin serb, përfaqësuesit e Bashkimit Evropian (BE) dhe SHBA-ve nuk shprehën mbështetje për studentët, ose nuk e pranuan realitetin në terren. Përkundrazi, e vazhduan politikën e tyre të jashtme të orientuar drejt stabilitetit në rajon, duke mbështetur më tej regjimin e Aleksandër Vuçiqit, në kurriz të aspiratave të protestave demokratike studentore. Duke i injoruar protestat, apo duke e zgjedhur me vetëdije heshtjen, BE-ja ka sakrifikuar edhe një herë vlerat themelore evropiane, demokracinë dhe të drejtat e njeriut, për hir të interesave ekonomike dhe gjeopolitike.

Udhëheqësit e protestës iu nënshtuan arrestimeve arbitrare, ndërsa autoritetet i karakterizuan protestat si një thirrje për “luftë civile” dhe

një “revolucion të ngjyrosur”, të mbështetur nga akterë të huaj (nga Perëndimi) për ta destabilizuar Serbinë dhe për ta zëvendësuar me forcë rendin kushtetues (lexo: regjimin). Ambasadorët serbë në vendet e Evropës Perëndimore u udhëzuan t'i cilësonin protestat si ndërhyrje ruse dhe fotografitë që ata u treguan diplomatëve perëndimorë gjoja shfaqnin operativët e organizatës “Wagner” duke valëvitur flamurin rus në protesta. Gjithashtu, qeveria në largim i ka dërguar një letër ndërkombëtarëve, ku pretendon se janë plotësuar të gjitha kërkesat e studentëve.

Në Serbi ka shumë pak besim publik tek strukturat politike, por edhe ndaj opozitës, ndërsa studentët gëzojnë rreth 80% të mbështetjes së qytetarëve serbë. Solidariteti i jashtëzakonshëm i qytetarëve me studentët, duke përfshirë edhe solidaritetin e qytetarëve nga vendet e rajonit, si Sllovenia dhe Kroacia, është një nga karakteristikat e spikatura të protestave. Kjo mbështetje përfshinte donacione dhe ndihmë logjistike, si akomodimi, ushqimi, kujdesi mjekësor dhe transporti. Ajo tregoi se qytetarët serbë, veçanërisht në qytetet e vogla, e njohin legjitimitetin e kërkesave të studentëve dhe solidarizohen me qëllimet e tyre. Falë protestave të studentëve frika u transferua në anën tjetër dhe shumë qytetarë nëpër qytetet e të cilëve kaluan studentët i pritën me lot dhe gëzim, duke i parë si çlirimtarë. Prandaj, protestat janë bërë simbol i rezistencës ndaj autoritarizmit dhe pjesë e një lufte globale për drejtësi dhe të drejtat e njeriut, me potencialin për të frymëzuar popujt tjerë që luftojnë me probleme të ngjashme.

Demokracia nga lart deri lart

Protestat në Serbi kanë treguar se është e mundur të krijohen forma alternative të demokracisë dhe organizimit politik, të cilat nuk janë të lidhura me institucionet dhe partitë tradicionale politike, por me autonominë, solidaritetin dhe mobilizimin krijues të qytetarëve. Protestat e studentëve në Serbi japin disa mësim kryesore që mund të jenë të dobishme për një kuptim më të gjerë të demokracisë, angazhimit social dhe luftës politike.

Struktura e decentralizuar pa lider: Lëvizja funksionon pa udhëheqje të qartë dhe të centralizuar, duke e bërë të vështirë për qeverinë që të zgjedhë, ose të shënjestrojë liderë të veçantë. Ky model gjithashtu lejon pjesëmarrje më të gjerë dhe reduktion mundësinë e dominimit individual në organizimin e protestave, gjë që ndihmon në ruajtjen e unitetit. Në sajë të parimeve të rotacionit dhe gjithëpërfshirjes, një numër i madh vajzash dhanë deklarata për media dhe morën pjesë aktive në diskutime publike, duke paraqitur argumente në favor të kërkesave të lëvizjes. Të mbetur pa një drejtues, studentët kërkojnë t'i shmangin krizat e brendshme ose fragmentimin që mund t'i dëmtojë qëllimet e tyre.

Organizimi strategjik dhe taktikat: Organizatorët studentorë demonstruan aftësi të jashtëzakonshme logjistike, duke krijuar grupe pune ad-hoc për të adresuar një sërë çështjesh, nga siguria dhe logjistika deri te çështjet PR dhe ato ligjore, dhe duke i zgjedhur vendet e protestave bazuar në rëndësinë e tyre strategjike. Për shembull, bllokada e kryqëzimit të trafikut Autokomanda në Beograd prishi infrastrukturën kritike dhe tërhoqi vëmendjen për shkak të saj. Në mënyrë të ngjashme, bllokada e urave në Novi Sad dhe marshimet e studentëve drejt qyteteve dhe fshatrave që mbështesin në masë dërrmuese koalicionin qeverisës dërguan një mesazh të fortë të përkushtimit të studentëve ndaj qëllimeve të tyre, duke demonstruar se protesta efektive ka të bëjë më shumë sesa dukshmëria - ka të bëjë me ndikimin në sistemet kryesore.



Demokratizimi i institucioneve nga brenda: Studentët i pushtuan universitetet dhe qendrat kulturore, duke shprehur mospajtimin e tyre me normat e vendosura dhe fillimin e procesit të demokratizimit të institucioneve. Duke bërë thirrje për “ndryshim sistematik”, ata vënë në praktikë parimet feministe dhe krijuan një strukturë autonome brenda sistemit - por jashtë sistemeve tradicionale të pushtetit, që njeh dhe formulon nevojat e veta, përcakton rregullat e veta dhe ndjek vlerat dhe agjendat e veta. Në vend të qeverisjes hierarkike, protestat organizohen përmes plenumeve dhe kuvendesh studentore, ku çdo student ka të drejtë të shprehë një mendim dhe vendimet merren me shumicë votash, gjë që krijon një ndjenjë drejtësie dhe legjitimiteti, por edhe siguron që vendimet të pasqyrojnë vullnetin kolektiv dhe jo ndikimin e disa zërave dominues. Ky proces ka treguar se institucionet mund të transformohen dhe demokratizohen nga brenda, jo vetëm nëpërmjet ndryshimeve të jashtme. Kryetarja e Kuvendit, Ana Bernabiq, për shkak të “plenumeve të bërëmenaxhimit” i akuzoi studentët për anarko-komunizëm, duke paralajmëruar se shteti duhet të luftojë kundër këtyre ideologjive me të gjitha mjetet.

Demokratizimi themelor i shoqërisë: Studentët nuk kërkuar largimin e qeverisë, por përkundrazi kërkuar demokratizimin rrënjësor të shoqërisë dhe ndryshimet sistematike, duke u bërë thirrje punëtorëve nga sektorë të ndryshëm t'i bashkohen atyre në një bllokadë dhe grevë të përgjithshme. Prandaj, këto protesta nuk janë vetëm një përgjigje ndaj një krimi tragjik, por reflektojnë një pakënaqësi në rritje me sistemin aktual politik dhe dëshirë për një formë të re qeverisjeje dhe udhëheqjeje, e cila nuk është e lidhur me elitat politike ekzistuese.

Rivendosja e demokracisë përmes veprimeve krijuese: Studentët organizuan aktivitete të ndryshme gjatë bllokadave, si lojëra basketbolli e deri edhe shfaqje amatore. Këto aktivitete jo vetëm që e ruajnë energjinë e protestës, por gjithashtu nxisin një ndjenjë komuniteti dhe solidariteti. Për më tepër, grupet studentore, si ai i Fakultetit të Arteve Dramatike, krijojnë përmbajtje multimediale, një kanal alternativ lajmesh dhe dokumentojnë protesta, duke siguruar që historia e lëvizjes të ruhet për analiza të ardhshme. Nëpërmjet protestave dhe aksioneve kreative, studentët u angazhuan edhe në idejimin e formave të reja të organizimit dhe veprimit politik, duke i përfshirë qytetarët në vendimmarrje dhe duke e mundur pjesëmarrjen e drejtpërdrejtë në proceset politike. Gjatë një mitingu masiv në Novi Sad, për shembull, studentët organizuan plenumin e parë të qytetarëve, ku njerëzve iu kërkuar të votonin me ngritjen e dorës nëse dëshironin të zgjasnin bllokadën edhe për tre orë të tjera dhe ta pasttronin qytetin.


Toni politik neutral: Protestat mbajnë një ton neutral, jo-nacionalist, pavarësisht historisë së Serbisë me ndarjet e thella etnike dhe kombëtare. Studentët shmangin me vetëdije përfshirjen në politikën e jashtme, ose përdorimin e simboleve dhe retorikës që do ta polarizonin shoqërinë, duke u fokusuar ekskluzivisht në çështje të tilla si korrupsioni, liria e medias dhe qeverisja demokratike. Pjesëmarrësit morën simbolet shtetërore (p.sh., flamurin, himnin) dhe motivet etnofetare, duke u dhënë atyre kuptim dhe vlera të ndryshme, për t'u distancuar kështu nga grupet ekstremiste, nacionalizmi dhe urrejtja. Kjo qasje ishte vendimtare në ruajtjen e mbështetjes së gjerë, përfshirë edhe grupet e pakicave që mund të ndiheshin të tjetërsuara nga nacionalizmi.

Përdorimi efektiv i teknologjisë dhe mediave sociale: Ndryshe nga protestat e viteve 1990 dhe fillimit të viteve 2000, të cilat mbështeteshin në format tradicionale të komunikimit, si materialet e shtypura dhe metoda goja-gojës, protestuesit e sotëm po i përdorin platformat e mediave sociale për të organizuar dhe shpërndarë informacion tek audiencia vendase dhe ndërkombëtare. Kjo i lejoi ata të arrinin një audiencë më të gjerë dhe të nisnin protesta solidariteti në qytete të tjera evropiane. Përdorimi i teknologjisë nga ana e tyre reflektohet gjithashtu në krijimin e një websajti të dedikuar, i cili shërben si një qendër për përditësimet organizative dhe nxit një ndjenjë përgjegjësie kolektive.

Kritika e sistemit liberal dhe kapitalist: Studentët kritikuan realizmin kapitalist dhe rendin politik liberal ekzistues, i cili, sipas tyre, nuk i plotëson nevojat e qytetarëve të zakonshëm. Në sajë të autoritarizmit dhe tekno-fashizmit në rritje, studentët avokojnë për një model alternativ të qeverisjes bazë të themeluar në pjesëmarrjen nga poshtë dhe një shoqëri në të cilën vlerat e solidaritetit, drejtësisë dhe lirisë vihen në plan të parë, në vend të fitimit apo pushtetit politik. Kjo qasje tregoi se protestat e studentëve ishin më shumë se luftë kundër një regjimi të vetëm politik, por më tepër synonin të vinin në dyshim statusquo'në dhe të ndryshonin vlerat themelore sociale dhe politike.

Pavarësisht mungesës së një strategjie afatgjatë dhe një vizioni të qartë se çfarë do të ndodhë pas përmbytjes së kërkesave, guximi dhe vendosmëria e treguar nga studentët i motivoi qytetarët e Serbisë që të përpiqen t'i rimarrin institucionet e tyre, t'i demokratizojnë ato dhe të krijojnë një shoqëri më të drejtë, më të lirë dhe më solidare.

Autorja është hulumtuuese në Qendrën Beogradase për Politikë të Sigurisë.



Elena Morina & Rozafa Maliqi

“Revolucioni mundet edhe duhet me qenë kulturor dhe i përhershëm, se përsëritja strukturore nuk pushon kurrë edhe është e pandashme prej kulturës njerëzore”.

Ian Parker & David Pavón-Cuellar: “Psychoanalysis and Revolution: Critical Psychology for Liberation Movements”.

Nuk mundemi me fillu këtë shkrim pa e falënderu komunitetin e aktivisteve feministe në Kosovë, ekzistenca e rezistenca e të cilave na inspiron çdo ditë, na jep hapsinë me qenë vetja jonë, e tregon gatishmëri me ofru përkrahje në çfarëdo niveli. Ndiheми me fat që jetojmë në një shoqni ku ka hapsina që na mundësojnë me reflektu mbi dinamikat shoqnore, me u përballë me veten, e me u rritë në vazhdimësi. Ky kontekst na ka mundësu me u njoftu me njona-tjetrën e me hy në një bisedë të vazhdueshme, ku gjithmonë jemi t’u imagjinu rrugë të reja.

Vetëm me pak reflektim mbi dekadat e fundit mundemi me pa qysh organizimet politike të grave kanë qenë shtyllë e lëvizjes sonë për çlirim nga fashizmi serb, e kanë vazhdu me qenë thelbësore në emancipim dhe edukim shoqnor mbas luftës. Gjatë viteve të fundit, lëvizja feministe është

forcu tutje si platformë e mendimit kritik, frymës antikapitaliste dhe rezistencës politike ndaj shtypjes. Mbi të gjitha, është dëshmu si lëvizja ma e unifikume jo-partiake në Kosovë. Për vite me radhë ka qenë zani i të gjitha neve, e kjo na shtyn me mendu qysh mundemi me ndërtu tutje mbi themelet e vendosuna nga këto përpjekje.

Kur e mendojmë të tashmen e lëvizjes feministe, s’kemi qysh me e nda prej frymës politike që na rrethon, në Kosovë dhe globalisht. Kosova si shtet “në zhvillim e sipër” në mënyrë obseive tenton me iu “afru” Perëndim-it, shembull që shpesh t’len shumë për me dëshiru, me retorika fashiste e promovim të jetesës individualiste ku “secili mendon për veten e vet”. Kjo mendësi është gabim, se na nuk jemi ishuj. Në këtë formë nuk mundemi me ekzistu e as me vepru në përditshmëri, sepse individi krijohet prej kontaktit me tjetrën. Pikërisht për këtë arsye nuk mundemi me pritë që pa i njoftë e kuptu mënyrat qysh ekzistencat tona janë të ndërlidhuna, kemi me i rikonfiguruar dinamikat shoqërore. Krejt jemi të zhytun në kulturën e dominimit dhe shtypjes, e shpeshherë edhe pavetëdijshëm e riprod-

hojmë, se është mënyra e vetme që e kemi për me i mbijetu vullit çorientues të kapitalizmit të sotëm. Ky sistem na jep mesazhin që ballafaqimi me njona-tjetrën nuk është i nevojshëm, që duhemi me u pajtu patjetër, që nuk ka hapsinë ku mundemi me punu bashkë, e që problemet e dikujt tjetër “nuk janë puna jonë”. Na po argumentojmë se bash janë puna jonë, edhe mirë bile.

Tu u ndërgjegjësua për format e këtij alienimi, e përmes përpjekjeve kolektive për me kriju lidhje ma t’vërteta, mundemi me i sfidu modelet e dhunshme të pushtetit e me ndërtu një solidaritet të thellë që i pranon kompleksitetet e kontradiktat tona. Kjo na ndihmon me kriju një bazë të fortë për lëvizjen tonë, e cila jo veç që i qëndron kohës, po shërben edhe si një formë azili prej dinamikave kapitaliste. Në mënyrë horizontale e me punë kolektive, mundemi me kriju hapsina ku ndihemi të sigurta, të ndëgjume e të përkujdesuna. Krijimi i këtyne hapsinave kërkon jo veç punë me veten, po hapje ndaj tjetrës e angazhim të përbashkët. Përmes ngritjes së një kulture të llogaridhënies e balancimit të saj me vlera që i respektojnë dallimet mes

nesh, e krijojmë një rrugë tjetër.

Nuk ka shanca që gjatë punës tonë nuk kemi me gabu. Po në vend se me u përça për gabimet, mundemi me i pa ato si hapsinë për rritje. Duhemi me mësu me e falë veten kur gabojmë, e me mësu qysh me kërku falje. Duhemi me kuptu që najherë konfliktet janë të shnosha, e me besu që përplasja e mendimeve krijon kuptime të reja. Nuk duhemi me mshefë nervozën, apo çfarëdo emocioni tjetër, po me i zhvillu mekanizmat që me i shprehë ato në mënyrë konstruktive. Duhemi me i pa e pranu privilegjet tona edhe me kuptu qysh rahatia që na bijnë është në fakt ngulfatëse. Një mënyrë e mirë për me kultivu durimin për me pa veten dhe të tjerat në tanësinë tonë është përmes angazhimit praktik dhe të qëllimshëm me procese të komunitetit.

Puna në komunitet është angazhim me përditshmërinë. Përditshmëria është hapsina e parë ku dalin në pah vlerat tona kolektive, e ku edhe munden m’u sfidu ato. Ku mundemi me eksperimentu me modifikime të vogla, të cilat ma vonë munden me pasë jehonë kulturore. Lëvizja feministe në Kosovë e ka potencialin me kriju alternativa që drejtohen prej ko-

munitetit e që bazohen në njohuritë dhe përvojat tona të përditshme. Këto përpjekje ofrojnë mundësi për rinegocim të vazhdueshëm të vlerave edhe zhvillim të praktikave që stimulojnë ndryshime të thella kulturore. Tu kriju modele të jetesës që e sfidojnë dominimin e shtetit dhe kapitalit, na zhvillojnë struktura lokale përmes të cilave bashkë kontribojmë në mënyrë modeste në luftën kundër patriarkatit, kapitalizmit dhe formave të tjera të shtypjes.

Po jetojmë n’kohna të ndryshimeve të mëdhaja e të shpejta gjeopolitike, ku forcat koloniale nuk janë t’u i mshefë qëllimet e tyne dominuese mbrapa ideologjive të shtet-ndërtimit e demokracisë si ma herët. Tash nuk ka iluzione. Miliardrat nuk po mshefen mbrapa qeverive, po haptazi po e ushtrojnë forcën e tyne mbi ne. E pikërisht n’këto momente duhemi me qenë edhe ma të konsolidume, të gatshme me i parapri çfarëdo situatë, gjithmonë bashkë, me njëra-tjetrën.

Elena Morina është aktiviste feministe dhe Rozafa Maliqi është organizatore e komunitetit & menaxhere kulturore



Latra Demaçi

Më 12 korrik 2024, Sindikata e Punëtorëve të Sektorit Privat njoftoi se mirëmbajtëset përgjegjëse për shërbimet sanitare të Kuvendit të Kosovës do të hynin në grevë në shtator për shkak të pagave nën minimumin ligjor dhe kushteve të këqija të punës. Punëtorët sanitare, kryesisht gra të moshës së mesme, do të refuzonin të punonin derisa kompania e kontraktuar, Schafberger GmbH, të zbatonte një rritje të pagave. Nazife Krasniqi, përfaqësuesja 52-vjeçare e grevisteve, kishte deklaruar se kërkesat e tyre ishin përgjigjur me kërcënime nga administrata dhe Schafberger dhe se punëtorët do ta vazhdonin grevën derisa të arrinin një pagë dinjitoze prej 550 eurosh. Kuvendi nuk përcaktoi asnjë veprim korrigjues si autoriteti zyrtar kontraktues dhe ripërtëriu kontratën me kompaninë e pastrimit. Fatkeqësisht, pas tre muajve grevë, aktivistët u pushuan përfundimisht nga puna. Megjithatë, ky artikull analizon grevën përmes kornizave kritike mbi globalizimin neoliberal, regjimet e jo-formalitetit dhe feminizimin e punës. Duke nxjerrë në pah narrativat dhe historitë jetësore të grevisteve, unë shqyrtoj mënyrën se si ato organizohen kundër zhvlerësimit të punës së tyre. Studimi fillon me një eksplorim të historisë së privatizimit në Kosovë në një kontekst post-socialist dhe të pasluftës, i cili është duke e nxitur pasigurinë e klasës punëtore. Më pas, artikulli shqyrton zhvlerësimin sistematik të punës së gjinizuar dhe racializuar, duke theksuar refuzimin e hierarkive globale të punës nga grevistet. Së fundmi, identifikoj aleancat kyçe që forcan ndërhyrjen e punëtorëve duke bërë thirrje për solidaritet edhe më të shtrirë për grevistet dhe klasën punëtore në Kosovë më gjerësisht.

Prapavijë e shkurtër

Pas ndërhyrjes së NATO-s në Kosovë, UNMIK-u kishte për detyrë ruajtjen e paqes dhe rindërtimin e struktura socio-ekonomike dhe politike, duke imponuar krijimin e demokracisë dhe të tregut të lirë. Michael Pugh argumenton se agjencitë e jashtme zakonisht përcaktojnë natyrën e rindërtimit ekonomik në shoqëritë e shkatërruara nga lufta, duke u përputhur me

liberalizimin neoliberal. Ky “projekt i paqes liberale” shpesh injoron çështjet socio-ekonomike rajonale, duke përqesuar varfërinë dhe jo-formalizimin e ekonomisë. Në Kosovë, kjo paqe nxiti integrim në ekonominë botërore duke tkurrur hapësirat publike, intensifikuar privatizimin, eksportin dhe investimet e huaja. Si pasojë, promovimi i demokracisë liberale dhe pjesëmarrja në tregtinë globale u bënë thelbësore për të çuar Kosovën drejt një Evrope gjoja të lirë, demokratike dhe tolerante. Në vijim do të shqyrtoj sesi politikat neoliberale sollën regjime të pasigurisë në tregun e punës, duke përqesuar kushtet dhe duke nxitur punëtorët e Kuvendit të grevonin.

Privatizimi dhe Globalizimi Neoliberal

Pas pavarësisë në vitin 2008, Kosova u përpoq të përdorte Ligjin për Partneritete Publiko-Private (PPP) për të tërhequr investime të huaja dhe nga vendi për infrastrukturë dhe shërbime publike. Rrjedhimisht, Kuvendi e privatizoi mirëmbajtjen e objektivit, duke ia deleguar këto shërbime kompanisë Schafberger, e cila kishte si prioritet uljen e kostove. Inspektori i Përgjithshëm i Punës, Basri Ibrahim, theksonte se kompanitë e pastrimit janë ndër sektorët me pagat më të ulëta në Kosovë, ku pagat e pamjaftueshme kombinoohen me tipare të punësimit jo-formal, siç janë kushtet e këqija të punës dhe mungesa e kontratave për periudha të caktuara. Prandaj, grevistët, kryesisht gra me 10 deri në 20 vjet përvojë pune, raportuan orë shtesë të paguara dhe ulje të pagave. Përballë këtyre padrejtësive sistematike, grevistët theksuan se jetesa me 275 euro në muaj ishte thjesht e pamundur.

Kështu, përpjekjet e tyre buruan nga realitetet thellësisht të ndërlidhura me politikat e privatizimit të imponuar në pasluftë. Prandaj, greva e pastrueseve reflektoi një refuzim më të gjerë të neoliberalizmit, i cili synon të zbëjë ndërhyrjen e shtetit midis fuqisë punëtore dhe kapitalit, duke ulur koston e punës përmes zgjerimit të tregut. Në rastin tonë, shohim zgjerimin e tregut të punës duke pasuruar kompaninë Schafberger dhe degraduar kushtet e punës së grevisteve dhe më gjerë. Globalizimi neoliberal përputhet edhe

me logjikat e “feminizimit të punës”, i cili shqyrton rritjen e pjesëmarrjes së grave në treg dhe përhapjen e marrëdhënieve të pasigurta të punës, marrëdhënie këto që më parë përshkruheshin si tipike vetëm për gratë – tani për të dy gjinitë. Në vijim, analiza thekson rrëfimet e punëtorëve teksa ato konceptualizojnë jetët e tyre dhe kundërshtojnë regjimet neoliberale.

Teorizimi i punës dhe lufta kundër zhvlerësimit

Në Riprodhimi Shoqëror me Punë dhe Kafë, Liridona Sijarina argumenton se lufta i kishte detyruar shumë gra dhe familje t’i rikonceptualizonin pozicionet e tyre në shoqëri. Politikat neoliberale po ashtu paraqitën fuqizimin ekonomik si thelbësor për rindërtimin shoqëror, duke reduktuar gratë në aftësinë e tyre për t’i shërbyer prodhim-it kapitalist. Për shembull, Miradije Jakupi, greviste 57-vjeçare që kishte humbur bashkëshortin dhe pesë anëtarë të familjes gjatë luftës, ishte përkujdesur për fëmijët dhe vjehrën e saj me një pagë shumë të vogël. Komenti i saj: “Si është e mundur që për krejt këto vite askush nuk interesohet me pyet se si ia dal në fund [të muajit]?”, vë në pah dështimet e rindërtimit neoliberal, duke theksuar shfrytëzimin e punës së saj të përkujdesit po aq sa të asaj me pagesë në Kuvend. Kështu, rrëfimi dhe veprat e saj si greviste duhet të kuptohen përtej kërkesës për paga dhe kushte të punës më të mira - duhet të shihen nëpërmjet feminizimit të punës; pjesëmarrjes së shtuar të grave në ekonominë neoliberale përmes një pune gjithnjë e më joformale, ndërsa barra e vazhdueshme e përkujdesit për fëmijët dhe të moshuarit mbetet e pallogaritur nga shteti.

Dutta kritikon qëndrimin se gratë shpeshherë janë të pavetëdijshme për shtypjen që ato përjetojnë, ose se janë mirënjohëse për punë të paguar. Sid-diçi paralajmëron për rrezikun e injorimit të perspektivave të grave mbi jetët e tyre si punëtore. Rrjedhimisht, neglizhimi i rrëfimeve të grevisteve do të ishte një akt dhune ndaj kuptimeve të mëshiuara të tyre mbi pasigurinë në punë dhe rezistencës kundër globalizimit neoliberal. Për shembull, Melvide Aliu, një greviste 64-vjeçare, përshkroi dëshpërimin i qenë e kishte përjetuar nga zhvlerësimi i punës së saj për shumë

vite. Ajo kishte thënë: “Askush nuk mund të hyjë brenda pa këto shërbime”. Deklarata e saj pasqyron një vetëdije kritike për rëndësinë e punës së saj, pavarësisht marrëdhënieve kapitaliste që synojnë të minojnë këtë kontribut. Kjo ngre një pyetje thelbësore: Pse puna sanitare është vazhdimisht e nënvlerësuar pavarësisht rolit të saj thelbësor në ekonomi dhe shoqëri?

Hierarkitë globale dhe eksploatimi i punës në Kosovë

Raporti i ONP-së i vitit 2023, “Punësimi në Botë dhe Perspektiva Shoqërore”, ia atribuon pagat e ulëta në sektorët e mirëmbajtjes dhe pastrimit mungesës së perceptuar të prestigjit profesional, duke sugjeruar se produktiviteti kinse i ulët përcakton vlerën e kësaj pune thelbësore. Përkundrazi, Suwandi argumenton se korporatat shumëkombëshe shfrytëzojnë dallimet në koston e fuqisë punëtore të krijuara nga kapitalizmi global, duke çuar kështu në nivele të ndryshme të eksploatimit të punës midis Veriut dhe Jugut Global. Prandaj, korporatat shumëkombëshe kërkojnë sektorë me kosto të ulët të punës dhe shkallë të lartë të produktivitetit. Kështu, shfrytëzimi i punëtorëve sanitare duhet të shihet brenda këtyre marrëdhënieve të pabarabarta të prodhimit kapitalist që krijojnë punë të lirë kosovare, duke e bërë atë një treg fitimprurës për kompanitë si Schafberger dhe duke i mirëmbajtur po ato hierarki globale të punës.

Së fundmi, Stevano argumenton se hierarkitë globale të punës përforcohen nga shfrytëzimi i dallimeve gjeografike, gjinore, klasore dhe racore, duke përqendruar grupet e marginalizuara në sektorët me të ardhurat më të ulëta. Edhe pse riprodhimi shoqëror dhe puna sanitare nuk janë punë identike, të dyja këto zhvlerësohen si rezultat i kuptimit të racializuar dhe gjinizuar se çka quajmë punë (të kualifikuar) dhe të përqeqësimit të kushteve të punës. Si një profesion i feminizuar, pastrimi konsiderohet punë jo e kualifikuar, duke mos i njohur aftësitë manuale të fituara përmes arsimit joformal. Schafberger dhe Kuvendi i shfrytëzojnë këto koncepte të punës për t’i nënvlerësuar grevistet, kryesisht të moshës së mesme, ndonjëherë të veja dhe shpeshherë kujdestare kryesore me sfi-

da shëndetësore. Rrjedhimisht, grevat i kundërvihen shfrytëzimit të punës sanitare dhe asaj riprodhuese shoqërore të papaguar.


Shefkije Canolli, një greviste 59-vjeçare, ndau vështirësitë e saj me Kosovo 2.0, duke deklaruar: “Vuaj nga osteoporozë; vetëm trupi dhe duart e mia e dinë dhimbjen që përjetoj nga puna e përditshme”. Dëshmia e Shefkijes tregon se si klasifikimi i punës manuale si “e pakualifikuar” jo vetëm që minon stabilitetin e saj financiar, por gjithashtu ndikon negativisht në shëndetin e saj. Këtu, duart dhe trupi i saj e njohin dhimbjen e shfrytëzimit kapitalist. Në një hierarki pune që e zhvlerëson atë manuale, trupi i Shefkijes bëhet një burim i fuqishëm i dijes, i cili i shërben asaj si pikënisje për të teorizuar dhe kundërshtuar hierarkitë globale të punës.

Aktet e grevisteve si vetëdije kritike

Thelbësisht, greva nxiti diskutime urgjente mbi klasën punëtore dhe regjimet neoliberale në Kosovë. Po ashtu, aleanca të ndryshme luajtën rol kyç në fuqizimin e kësaj ndërhyrjeje të drejtpërdrejtë dhe diskursive. Të udhëhequr nga Kolektivi për Mendim dhe Veprim Feminist, sindikatat, OJQ-të, dhe aktivistë/ë të pavarur organizuan protesta, pikturuan muret publike me slogane si: “Greviset po ndëshkohen. Çohuni!”, bënë thirrje për bojkot të ditëve të punës dhe morën pjesë në debate televizive për ta rritur ndërgjegjësimin. Kështu, veprimet e tyre solidarizuese shpallën fuqishëm se të gjithë kanë përgjegjësi në luftën e grevisteve për drejtësi dhe në atë të klasës punëtore më gjerësisht. Siç dëshmojnë rrëfimet e diskutuara në këtë artikull, narrativat dhe aktet e grevisteve pasqyrojnë një vetëdije kritike për vlerën e tyre në punë dhe shoqëri, duke theksuar se puna sanitare me pagë dhe puna e përkujdesit duhet të vlerësohen dhe të llogariten në mënyrë të dinjitetshme. Megjithëse punëtorët u pushuan nga puna pas grevave, lufta e tyre shërben si rikujtim për nevojën për solidaritete më të shtruara dhe një rishikim se si puna, veçanërisht ajo e gjinizuar dhe e racializuar, duhet të perceptohet dhe kompensohet.

Autorja është aktiviste dhe studiuese feministe.

Disa pyetje që s’u bënë për edukimin seksual



Aulonë Kadriu

Mënyra se si u paketua diskutimi për edukimin seksual në vitin 2024 është pjesë e një kundërlëvizjeje më të gjerë ndaj drejtësisë gjinore.

Ma merr mendja, ka pak gjasë ta kryesh shkollën në Kosovë pa i dëgjuar kryesisht djemtë e rinj nëpër klasë e korridore, teksa orë e çast i thonë fjalët “k*r” [fjala në zhargon për penis] dhe “p*dh” [fjala në zhargon për vaginë]. Këto fjalë përgjithësisht përdoren me bujari kudo: në shkolla, në rrjete sociale, në muret e ndërtesave ku jetojmë.

Derisa herë-herë këto fjalë përdoren si mënyrë për t’u rebeluar, apo thjesht për t’u bërë pjesë e trendit, në të shpeshtat raste fjala “k*r” përdoret përbrenda konteksteve për ta treguar pushtetin, fuqinë e kontrollin, derisa fjala “p*dh” përdoret si sinonim i nënshtrimit e dobësisë.

Po çka ndodh nëse i pyesim të njëjtit të rinj: Çka është ai organ? Përgjigja, nëse nuk është ndonjë tallje a ikje nga diskutimi, besoj është heshtje. Marre. E mosqotfshme. Ashtu ishte para disa viteve, kur punoja në nisma të edukimit joformal rreth edukimit seksual dhe shëndetit e të drejtave riprodhuese. Nëpër të njëjtat klasa me banka gjithandëj grithur me fjalët “k*r” dhe “p*dh”, nxënësit nuk mund as t’i thoshin me zë fjalët “penis” e “vaginë”, në kuptimin krejt anatomik të fjalës e lëre më të flisnin për, të themi, ciklin menstrual, sëmundjet seksualisht të transmetueshme, apo metodat e mjetet kontraceptive.

Ky paradoks mbresëlënës, ku përmendja e organeve gjenitale në shërbim të përcaktimit të pushtetit apo fyerjes është normale, por përmendja e tyre në shërbim të dijes vazhdon të jetë e turpshme dhe tabu, flet për një ruajtje të status quo-së ku gjuha u shërben të fortëve. Dhe nxënësit, derisa nuk janë ata që po e mirëmbajnë këtë situatë, janë ata që po e pësojnë.

Por, teksa kjo status quo mund t’i shërbejë përkohësisht një pjesë të popullsisë - burrave - në afatgjatë po ua merr pjesës tjetër të popullsisë – grave – të drejtën për të jetuar të lira. Përfundimisht, në këtë situatë, që të dy, edhe burrat, e edhe gratë, po i privon prej të drejtës për t’i njohur trupat e tyre, për t’i përjetuar ato vetëm si vende ku zbatohet, ushtrohet, përjetohe pushteti, por si vende ku merr kuptim liria.

Si në shembullin më lart, shpesh, plot fije të nyjave shoqërore mund të gjenden në gjuhë - intonacioni me të cilin flitet, pyetjet që shtrohen, fjalët që zgjidhen, ato që nuk zgjidhen, kush i thotë fjalët, çka ka thënë ai njeri më parë dhe konteksti në të cilin po thuhet fjalë të caktuara.

Mbi të gjitha, plot nyje mund të shkurthurohen përmes pyetjeve, atyre që parashtrohen dhe atyre që përhumben nëpër kaosin e fjalëve.

Disa pyetje që kumbuan zëshëm në fund të vitit 2024 u parashtruan në Kuvend. “Pse angazhohen në gjithë këtë zell e gjithë këtë mund? Çka ju pengon familja? Çfarë familje duan?”, pyeti deputeti Eman Rrahmani, ish-anëtar i Lëvizjes Vetëvendosje dhe tash anëtar i Listës për Familjen, në një seancë të Kuvendit të Kosovës, më 11 nëntor të vitit 2024.

Rrahmani e nisi fjalimin e tij, të ngarkuar me pyetje, sikur për t’ia shtuar karakterin performativ, duke thënë se do të dijë “se si janë shpenzuar disa mjete të taksapaguesve qytetarë”.

Ai shfaqti brengat e tij për shpenzimet, për “kalimin e ligjit ku lejohen martesat ose bashkëjetesa e burrit me burrë”; ai kërkoi arsyetim se përse, sipas tij, Ministria e Rinisë, Kulturës dhe Sportit “secilin projekt të saj

deri sot prioritet i jepet mbrojtjes së komunitetit LGBT”; pyeti për shpenzimet “për t’u lejuar fëmija të mos ketë të drejtë ta njohë kë e ka babë e kë e ka nënë”. Pastaj foli për një përmbytje në kurrikulën për arsim, ku, sipas tij, “mësohen se si mësimdhënësit t’u tregojnë fëmijëve prej klasës së parë deri në klasën e 12-të se si i kryejnë marrëdhëniet e tyre seksuale në shtëpitë e tyre”. Pastaj shtoi se kurrikula thërret që një vajzë dhe djalë të vendosen para klasës, njëri t’i mbyll sytë për pesë minuta dhe tjetri ta prek nëpër trup, pastaj t’i ndërrojnë rolet dhe në fund “të tregojnë se çka kanë ndier, çfarë organi kanë prekur”.

Pyetja: “Çka ju pengon familja?” bëri jehonë në nanosekondë përtej mureve të Kuvendit. Rrjetet sociale u vërshuan me postime të turlifarshme rreth asaj që e tha Rrahmani - shpesh duke e marrë si të mirëqenë vërtetësinë e deklaratës së tij, pa çka shpejt u vërtetua se ai i shtrembëroi faktet.

Pse po na ndezin pyetjet e Rrahmanit?

Rrahmani fliste për disa doracakë rreth edukimit seksual, të cilët MASHTI i kishte përfshirë në një kurrikulë që ia kishte propozuar komunave në vitin 2023. Edukimi seksual nuk ishte dhe nuk është lëndë e obliguar në planprogramet shkollore në Kosovë.

Përkundër kësaj, në një veprim të pashoq e të shpejtë, u mobilizuan disa komuna dhe, me kryeqytetin në ballë, ndaluan përdorimin e doracakëve. Edhe MASHTI i tërhoqi doracakët. Kryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës, Lumir Abdixhiku, në atë kohë pak para fushatës zgjedhore, nuk hezitoi ta shfrytëzonte një retorikë të ngjashme me Rrahmanin për ta rritur entuziazmin elektoral e në fund, kryeministri Albin Kurti doli me një video-deklaratë, sikur për t’u thënë qytetarëve të “flinin dathtë”, sepse kryeministri nuk bën politika kundër, por pro familjes.

Por, derisa të gjithë tok së bashku u angazhuan për ta mbrojtur familjen, s’pyetën se për çfarë familje po flisnim. Ose, në stilin e pyetjeve të Rrahmanit, çfarë familje duam?

Fjalimi i Rrahmanit nuk foli thjesht për edukimin seksual. Në fakt, ai vetëm sa e përmendi edukimin seksual për ta ndihmuar retorikën thellësisht patriarkale dhe homofobike që ai e ka nisur tash e sa kohë si deputet i Kuvendit të Kosovës.

Ai është prej më të zëshmeve kundër draft-Kodit Civil, një dokument qenësor për mirëqenien e taksapaguesve, të cilët i përmendi në fjalimin e tij, por që falë retorikës së tij e deputetëve tjerë që mendojnë si ai, ka mbetur peng, pak i homofobisë e si duket, pak i lojërave politike të deputetëve, që për qytetarin brengosen pak dhe ngushtë. Prej 1.630 neneve u diskutua vetëm neni 1.138, paragrafi 2, që hapte udhë ligjore për njohjen e bashkësive civile ndërmjet personave me sekse të njëjta.

Pastaj, Rrahmani është po ashtu prej deputetëve më të zëshëm kundër Projektligjit për Shëndetin Riprodhues dhe Fertilizim të Asistuar Mjekësor (FAM). Kafshata që nuk e kapërdiu dot ai ishte neni 15 i projektligjit, i cili i njihte gratë beqare mbi 18-vjeçare si shfrytëzuese të së drejtës në FAM.

Prandaj një pyetje tjetër duhet bërë: përse njerëzit si Rrahmani, që vazhdimisht dhe haptas shpërfaqin qëndrime thellësisht patriarkale dhe homofobike, arrijnë të përcaktojnë brengat tona shoqërore dhe mbi të gjitha arrijnë të përcaktojnë kornizat dhe kushtet se si diskutohen këto çështje jetike?

Përse pyetjet e Rrahmanit marrin përgjigje të gjithëmbarshme, prej kryeministrit, opozitës, MASHTI-t, por pyetjet e qytetarëve të Kosovës shkruhen në akull e kthehen kah dielli? Përse ia doli Rrahmani që ta fshijë nga faqja e tokës secilin mundësi, sado të mangët e të pakët për nxënësit e shkollave fillore që të marrin edukim seksual? Përse ia



doli Rrahmani që, pos edukimit seksual, ta rrok me një gur edhe Kodin Civil, e edhe projektligjin për FAM? Prandaj, koha është që t’ia bëjmë disa pyetje Rrahmanit, ashtu që ta zhbëjmë ngadalë ndikimin që padrejtësisht i është vendosur në duar:

Disa ide për pyetje

Pyetjet e Rrahmanit nuk mund të merren si manifestime të singerta të kujdesit të tij për qytetarin, sepse nocioni i Rrahmanit për qytetarin është nocion i ngushtë: qytetari për të, siç na e ka dëshmuar, i ngjan Rrahmanit: me gjini, orientim seksual, status ekonomik dhe përfundimisht, ide e mendime.

Ai arriti të krijojë një tollovi informative, ku fije pas fije u ndërtua një narrative e paqenë dhe ndodhi ajo që ndodh shpesh: njerëzit e pushtetshëm kontrollojnë se si flitet dhe për çka flitet dhe ku, ata që e pësojnë janë patjetër të papushtetshmit dhe ata që qëndrojnë në skaje të kuptimit të fjalës “qytetar”.

Kështu, Rrahmani, bashkë me të tjerët që iu bashkuan, punuan shumë që të na e zvogëlojnë fjalorin me të cilin i diskutojmë gjërat. Pos që kanë arritur t’i kthejnë draft-Kodin Civil dhe projektligjin për FAM në sinonime të “po duan të na e shkatërrojnë familjen”, disi ia dolën të tabuizojnë, edhe më thellë sesa dikur, edukimin seksual dhe ta shtojnë atë në listën e shkatërrimtarëve të familjes. Pra, e bënë edukimin seksual pjesë të një kundërlëvizjeje ndaj drejtësisë e barazisë gjinore, që themelin e ka në një mbrojtje të supozuar të familjes e mbi të gjitha, fëmijës. Zgjedhja e fëmijës si strategji politike është e mençur vetëm kur ka kush të bie në prackën e instrumentalizimit të figurës së fëmijës si qenie e pambrojtur dhe e brishtë, për të çuar përpara agjenda që përfundimisht s’i kanë në qendër fëmijët.

Politikanët e këllillë për fëmijët kujdesen vetëm kur është fjala për seksin, seksualitetin - riprodhimin. Pra, në thelb të thelbit, mirëqenia e fëmijës nuk është brengë, sa është brengë se a po prodhohen fëmijë. Këtu, pastaj, del te brenga tjetër, që janë gratë - jo gratë si gra, subjekte në vetvete me jetë e agjenci, por gratë si riprodhuese. Ata duan që gratë të kenë fëmijë, por asgjë s’mbaron këtu.

Ata duan të vendosin edhe saktësisht cilat gra të kenë fëmijë, në ç’formë të sillen në jetë ata fëmijë. Gratë janë vetëm në shërbim të riprodhimit për shtetin, por shteti nuk është në shërbim të grave.

Kështu, kur krijohen kërrshe informative dhe pakësohet fjalori, Rrahmani dhe politikanët që sillen ngjashëm përpiqen ta pastrojnë veten nga përgjegjësitë faktike që i kanë si deputetë. Me retorikë e fjalime performative - edhe ato të dobëta - mundohen, dhe ia dalin shpesh, që të heqin vëmendjen prej faktit se ata në fakt duhet të punojnë për popullin.

E këtu luajmë rol ne, populli që duhet të çmësojmë të ndizemi sipas kushteve të njerëzve që ua paguajmë rrogat përditë, jo për performanca, por për të na shërbyer. Mbetet te ne që ta kthjellim mënyrën se si i nisim bisedat për drejtësinë, për barazinë, në këtë rast për edukimin seksual.

T’i gjurmojmë pyetjet e reja. Ta pyesim Rrahmanin se çfarë familje do ai.

Për shembull: Çfarë familje do ai nëse burrat nuk e kuptojnë që grua-ja ka të drejtë të thotë “jo” në secilin çast, ashtu siç ka të drejtë të kërkojë që marrëdhënia seksuale të jetë përvojë e kënaqësisë, jo e obligimit, forcës. Kënaqësia, apo qasja në të, është çështje politike, është çështje e pabarazisë. Shkrimtarja britanike Katherine Angels shkruan se kur gratë flasin për “seks të mirë”, ato kanë tendencën të flasin për mungesë të dhimbjes, ndërsa burrat flasin për seks ku kanë arritur orgazëm.

Angels po ashtu thotë se gratë bëjnë marrëdhënie seksuale për ta shman- gur, ose për ta vonuar dhunën nga burrat. A kështu duhet të nisen fëmijët? A në këto rrethana duhet të lindin ata? Përdhunimi martesor nuk është çështje e paditur në Kosovë; është vetëm çështje e shpërfillur. Në një hulumtim nga hulumtuesja dhe aktivistja Shqipe Gjocaj për revistën Kosovo 2.0, një grua në të njëzetat, e mbijetuar e dhunës gjinore, kur pyetet rreth përvojës së saj seksuale me bashkëshortin e saj, thotë: “Nëse i ke thonë ‘jo’, je rreh edhe një herë ma shumë”.

Ose, për shembull, pse s’pyet askush për familjen e Lumniye Rulanit, një gruaje me aftësi të kufizuar fizike, e cila në një artikull të gazetares Kaltërina Misini po ashtu në K2.0, tregon se pasi kishte mbetur shtatzënë, part-

neri i saj e kishte lënë, sepse familja nuk e kishte lejuar të martohej me një grua me aftësi të kufizuar. Edhe familja e Rulanit i kishte thënë: “Pa e hjekë fëmijën, s’ke çka lypë në shpi”. Pa mbështetje nga shteti, e përjashtuar nga familja, Rulani e rriti fëmijën e saj midis shtypjes sistematike ndaj saj. Kësaj shtypjeje, asaj dhe grave tjera me aftësi të kufizuara fizike u shtohet një tjetër: spitale përjashtuese gjinekologjike, që ose nuk i bëjnë hesap gratë me aftësi të kufizuara, ose kur i bëjnë hesap, ua bëjnë dyfish të vështirë jetën.

Të paktën këta deputetë që e mbështesin riprodhimin kaq shumë, përse nuk sigurohen që gratë të jenë të shëndosha? Të mund të bëjnë kontrolle gjinekologjike? Apo jo? Më lehtë është të performosh në Kuvend, sesa t’i bësh spitalet të qasshme.

Ose, për shembull, pse nuk pyesin për dhunën seksuale përbrenda dhe jashtë shkollave. T’i mendojnë deputetët, për shembull, shtatë orët gjatë të cilave pesë djem e burra e përdhunuan një vajzë 11-vjeçare në një park publik të Prishtinës, në vitin 2022. Ose t’i mendojnë vajzat, nxënëset që janë viktime të ngacmimeve, sulmeve seksuale, përbrenda shkollave të tyre. Ose t’i mendojnë përvojat e studenteve në Universitetin e Prishtinës (UP), të cilat janë të pambrojtura përballë ngacmimit seksual. Sipas një hulumtimi të gjerë e thukët të gazetares Dafina Halili për K2.0, ngacmimi seksual kalon i papenguar e i pandëshkuar në UP; se ngacmimi seksual është sekret publik e se prej 300 studenteve/ëve të anketuar/a, një në tre tha kishte përjetuar ngacmim seksual.

Raste ka pafund. E krejt këto kanë të bëjnë me edukimin seksual, kundër të cilit u ngutën të flasin e deklarohen plot. Krejt këto, po ashtu, me shumë gjasë do të reduktoheshin nëse do të flisnim ndryshe për edukimin seksual, për drejtësinë gjinore, për barazinë. Deputetët e kanë mundësinë të nisin biseda ndryshe; të bëjnë tjera pyetje. Mjafton që t’i dëgjojnë zërat e grave aktiviste, hulumtuese, gazetares, të cilat përditë tregojnë se cilat pyetje duhet bërë. Madje, u japin edhe përgjigjet. Mjafton të dëgjojnë para se të flasin.

Autorja është hulumtuese dhe gazetare.

Dimensioni gjinor i dhunës kibernetike

Blenda Asllani

Dhuna me bazë gjinore në Kosovë as nuk eliminohet e as nuk pakësohet, thjesht ndërron trajtë, krijon forma të reja dhe avancojnë ekzistueset. Derisa shteti po vazhdon të dështojë në mbrojtjen e grave dhe garantimin e sigurisë edhe nga format më të dukshme të dhunës, dhuna kibernetike po shfaqet si një front i ri lufte për gratë dhe vajzat e Kosovës.

Interneti dhe mjediset online, konceptuar si hapësira për informim, rrjetëzim e ndërveprim, po tëhuajsohen në një arenë ku dhuna gjinore po bëhet më e padukshme, por po aq e dëmshme dhe e përhapur. Nga ngacmimet seksuale, përndjekja dhe kërcënimet virtuale, e deri tek abuzimi seksual përmes pamjeve dhe shantazhi, dhuna kibernetike po minon hapësirën jetësore të grave, pjesëmarrjen e tyre publike dhe po cenon të drejtën themelore për të qenë të sigurt.

Gratë që marrin pjesë në sferën publike janë veçanërisht të cenueshme ndaj dhunës kibernetike, sipas Direktivës së Bashkimit Evropian për Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje. Politikanet, gazetarët, aktivistët dhe akademikët shpesh përballen me sulme të koordinuara që synojnë t'i frikësojnë dhe t'i largojnë nga diskursi publik. Megjithatë, secila grua dhe vajzë mund të jetë viktimë e dhunës kibernetike, pavarësisht statusit social apo angazhimit të saj publik.

UNDP në vitin 2021 pati gjetur se në nivel global, 38% e grave kanë përjetuar drejtpërdrejt abuzim në internet dhe 50% e vajzave përballen më shumë me ngacmime në internet sesa me ngacmime në rrugë, ndërsa në Kosovë 43.3% e grave kanë përjetuar të paktën një formë të dhunës të mundësuar nga teknologjia, gjeti një hulumtim i UN Women.

Sipas Prokurorisë Themelore në Prishtinë, kanosjet dhe ngacmimet janë format më të shpeshta të dhunës kibernetike ndaj grave në Kosovë.

Këto statistika alarmojnë këdo përveç institucioneve të cilat në vazhdimësi po dështojnë që të luftojnë dhunën me bazë gjinore, duke lehtësuar kështu mirëmbajtjen sistemike të saj dhe duke i mbrojtur abuzuesit nga ndëshkimi.

Dhuna kibernetike nuk është veç prurje e re e zhvillimeve teknologjike, ajo është vazhdimësi e dhunës sistemike e strukturore ndaj grave, e cila qëllimin e ka në cenimin e dinjitetit të grave dhe minimizimin e rolit të tyre në shoqëri dhe hapësira publike. Pra, më shumë sesa dhunë teknologjike është përshtatje e patriarkatit në një formë të re të mundësisë për të ushtruar dhunë e për t'i kufizuar dhe kontrolluar gratë dhe zgjedhjet e tyre.

Ku po dështojnë institucionet e drejtësisë dhe sigurisë?

Si çdo gjë e re, edhe dhuna kibernetike e ka zënë Kosovën pa pritë e pa përgatitë. Pavarësisht përpjekjeve të herëpashershme për të përmirësuar sigurinë kibernetike, institucionet e drejtësisë dhe sigurisë në Kosovë vazhdojnë të dështojnë në garantimin e mbrojtjes efektive për gratë dhe vajzat.

Sipas Analizës Gjinore të Digjitalizimit në Kosovë “Barazia Gjinore dhe TI”, publikuar nga Rrjeti i Grave të Kosovës (RRGK), i gjithë procesi i digjitalizimit në Kosovë është krejt i pandjeshëm ndaj gjinisë dhe Agjencia për Barazi Gjinore nuk është konsultuar gjatë procesit të politikëbërjes për sigurinë dhe zhvillimin teknologjik. Ndër tjerash, ky përjashtim përbën shkelje të Ligjit për Barazinë Gjinore, i cili obligon Qeverinë e Kosovës të aplikojë analizën gjinore drejt informimit të të gjitha politikave publike, duke përfshirë këtu edhe ato që lidhen me digjitalizimin dhe kibernetikën.

Një nga dështimet thelbësore është mungesa e një kuadri ligjor të për-

shtatshëm për të adresuar dhunën kibernetike. Kodi Penal i Kosovës, edhe pas disa ndryshimeve të rëndësishme, nuk e trajton dhunën kibernetike si një veprë penale të veçantë dhe nuk ka ndonjë përkufizim apo dënim të harmonizuar mbi të. Deri më tani, kjo formë e dhunës trajtohet vetëm përmes dispozitave të përgjithshme të cilat nuk e adresojnë këtë formë të dhunës veçanërisht as plotësisht, çka i lë viktimat e dhunës online të pambrojtura dhe pa mjete juridike për të kërkuar drejtësi.

Institucionet lokale dhe qendrore në Kosovë nuk kanë ndërmarrë masa të mjaftueshme për të parandaluar dhe luftuar dhunën kibernetike. Strategjia Kombëtare për Sigurinë Kibernetike 2023-2027, e miratuar nga Ministria e Punëve të Brendshme, fokusohet kryesisht në mbrojtjen e infrastrukturës digjitale dhe sistemeve të informacionit dhe synon të forcojë kapacitetet institucionale e teknologjike. Ndër qëllimet e saj përfshihet krijimi i mekanizmave për mbrojtjen e sigurisë digjitale dhe ngritjen e ndërgjegjësimit për sigurinë kibernetike. Megjithatë, kjo strategji injoron dimensionin gjinor të problemit dhe nuk merr në konsideratë përvojat, nevojat e as sfidat specifike të grave dhe vajzave.

As Ligji për Sigurinë Kibernetike, një tjetër dokument i rëndësishëm që synon të mbrojë sistemet dhe rrjetet nga kërcënimet digjitale, nuk e përfshin dimensionin gjinor. Në vend që të adresojë nevojën për masa mbrojtëse specifike për gratë dhe vajzat, ligji fokusohet vetëm në aspektet e përgjithshme dhe krejt teknike të sigurisë kibernetike, duke anashkalluar ndikimin joproporcional që kjo formë e abuzimit ka mbi grupet më të cenueshme.

Përpjekjet e bëra deri më tani, përfshirë hartimin e ligjeve dhe strategjive për sigurinë kibernetike, si dhe themelimin e Agjencisë për Siguri Kibernetike nga Qeveria e Kosovës përmes Projektligjit për Siguri Kibernetike në vitin 2022, janë fokusuar kryesisht në nevojat shtetërore dhe mbrojtjen e infrastrukturës kritike nga sulmet kibernetike që vijnë nga jashtë. Kjo ka bërë që siguria kibernetike të trajtohet ekskluzivisht si çështje e mbrojtjes shtetërore duke injoruar plotësisht përvojat individuale dhe cenueshmërinë e individëve ndaj dhunës kibernetike. Ky trajtim, rrjedhimisht, ka anashkalluar edhe nevojën që dhuna kibernetike të trajtohet edhe si kërcënim serioz e i vazhdueshëm ndaj individëve, veçanërisht grave.

Një dështim tjetër i shtetit është mungesa e mbledhjes dhe analizimit të të dhënave të ndara sipas gjinisë për rastet e dhunës kibernetike. Policia e Kosovës ka konfirmuar se nuk posedon të dhëna të strukturuarara për të identifikuar se sa nga rastet e raportuara për dhunë kibernetike prekin gratë dhe vajzat. Njash-tu, Këshilli Prokurorial i Kosovës (KPK) pohon se nuk ka të dhëna të ndara sipas gjinisë lidhur me numrin e rasteve të dhunës kibernetike të cilat janë ndjekur penalisht nga prokuroritë e Kosovës dhe sa nga këto raste kanë përfunduar me dënime për autorët.

Policia e Kosovës dhe KPK regjistrojnë vetëm statistika të përgjithshme mbi veprat penale që lidhen me krimet kibernetike, pa një kategorizim specifik mbi dhunën kibernetike me bazë gjinore. Këto të dhëna raportohen në përputhje me Ligjin nr. 03/L-166 për Parandalimin dhe Luftimin e Krimit Kibernetik, i cili tashmë është shfuqizuar. Regjistrimi i përgjithshëm i të dhënave të rasteve pamundëson vlerësimin e shkallës reale të problemit dhe zhvillimin e politikave efektive për ta adresuar atë.

Luftën ndaj dhunës kibernetike në Kosovë joserioze dhe joefektive e bën edhe qasja institucionale që ia ngarkon vazhdimisht barrën e provës viktimave. Në vend që të marrin masa proaktive për hetimin dhe ndjekjen e autorëve, institucionet kërko-

jnë prova konkrete, të dukshme dhe të prekshme për të vërtetuar dhunën. Siç thekson aktivistja dhe menaxherja e Programit për Adresimin e Dhunës me Bazë Gjinore në RRGK, Adelina Berisha, “institucionet tona mezi u besojnë edhe rasteve të dhunës me shenjat më të dukshme fizike”. Kjo qasje është veçanërisht problematike në rastet e dhunës kibernetike, ku dëmi është kryesisht psikologjik, social dhe emocional.

Për më tepër, shteti as nuk ka ndërmarrë e as nuk po ndërmerr hapa drejt përpjekjes për të promovuar dhe ndërgjegjësuar qytetarët/et me lidhshmërinë e përdorimit të (pa)sigurt të internetit, respektimit të privatësisë dhe marrjes e dhënies së pëlqimit. Mungesa e edukimit publik formal e joformal për këtë lidhshmëri krijon hapësirë për abuzim, sepse shumë njerëz në mungesë të informacioneve mund edhe të mos e kuptojnë me çka po përballen, rrezikët që u kanosen, apo edhe mundësinë për të raportuar, çka i lë ata/ato të pambrojtur përballë abuzimit kibernetik.

Në këtë kontekst, dështimi për të harmonizuar legjislacionin me Direktivën për Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje, të miratuar nga Bashkimi Evropian vitin e kaluar, përbën një tjetër sfidë për Kosovën. Këtu aktivistja Berisha thekson rëndësinë e harmonizimit të ligjeve të Kosovës, si shtet aspirues për integrim në BE, me legjislacionin evropian. Kjo direktivë e trajton dhunën kibernetike si një formë të dhunës me bazë gjinore dhe kërkon që shtetet anëtare të zhvillojnë strategji gjithëpërfshirëse për parandalimin dhe ndëshkimin e autorëve, si dhe mbështetjen e viktimave.

Lidhur me çështjet e ngritura janë dërguar pyetje në Ministrinë e Drejtësisë, zyrtarët e së cilës deri në publikimin e këtij artikulli nuk janë përgjigjur.

Për fund, dështimet e institucioneve të drejtësisë dhe sigurisë për të trajtuar dhunën kibernetike si një kërcënim real dhe gjinor janë një reflektim i mungesës së qasjes gjithëpërfshirëse ndaj barazisë gjinore dhe sigurisë digjitale. Pa një legjislacion të përditësuar, strategji gjithëpërfshirëse dhe edukim të vazhdueshëm, dhuna kibernetike do të vazhdojë të jetë një nga format më të padukshme, por më të dëmshme të dhunës ndaj grave në Kosovë.

“Albkings” - shembull i dështimit dhe/ose suksesit institucional

Rasti “Albkings” na është prezantuar shpesh si një sukses institucional, duke qenë se pas disa përpjekjeve ai është mbyllur përfundimisht. Megjithatë, ky rast është gjithashtu një shembull i qartë i dështimit të institucioneve për të ofruar një zgjidhje të qëndrueshme dhe për të parandaluar përsëritjen e dhunës kibernetike. Pavarësisht nisjes së hetimeve dhe procedurave ligjore, grupi “Albkings” është mbyllur dhe rihapur të paktën tre a katër herë, duke vazhduar të kryejë të njëjtën veprimtari të paligjshme dhe abuzive. Ky cikël i mbylljeve dhe hapjeve ekspozon mungesën e efektivitetit të institucioneve për të siguruar që autorët të ndëshkohen dhe që viktimat të mbrohen.

Prokuroria Themelore, në përgjigjen e saj, si sfida kryesore gjatë hetimeve të këtij rasti numëron “identifikimin e personave që kryenin veprën penale, mosraportimin nga viktimat dhe mungesën e bashkëpunimit me platformën “Telegram”.

Ky rast u bë i njohur për shkak të numrit të madh të anëtarëve dhe përmbajtjes së shpërndarë, që përfshinte materiale intime përfshirë fotografi, video e numra kontaktues pa pëlqimin e viktimave. Mediatizimi i rastit e vuri atë në qendër të vëmendjes publike, duke ushtruar presion mbi institucionet për të



vepruar. Megjithatë, duhet theksuar se “Albkings” ishte një rast specifik dhe i izoluar që mori kaq shumë vëmendje për shkak të përmasave të tij, ndërkohë që rastet më të vogla, ku një, dy apo tre persona abuzojnë kibernetikisht një grua apo vajzë, nuk trajtohen me të njëjtën urgjencë.

Për më tepër, fakti që një rast kaq i madh dhe publik, si “Albkings”, kaloi nëpër disa cikle të mbylljes dhe rihapjes, ngre pyetje serioze për efektivitetin e institucioneve dhe për kapacitetin e mekanizmave ekzistues për të luftuar dhunën kibernetike. Çka ndodh kur viktimat nga një individ, apo një grup i vogël? Fokus i në përmasat e rastit nuk duhet ta përcaktojë rëndësinë e tij. Numri i viktimave nuk është kriteri që mat seriozitetin e një rasti dhune. Secila grua dhe vajzë duhet të jetë e sigurt, ndërsa është përgjegjësi e institucioneve të sigurisë dhe drejtësisë që ta garantojnë këtë të drejtë, pavarësisht përmasave të rastit, numrit të abuzuesve e viktimave dhe vëmendjes mediatike që mund të marrë.

Dhuna kibernetike duhet të trajtohet si dhunë me bazë gjinore

Gratë dhe vajzat preken në mënyrë joproporcionale nga format e ndryshme të dhunës online, duke përfshirë ngacmimet seksuale, komentet seksiste, kërcënimet, kanosjet dhe publikimin e pamjeve intime pa pëlqim, të cilat ndikojnë në forma të ndryshme, por të ndërthura, në jetën e tyre sociale, personale dhe profesionale. Megjithatë, mungesa e perspektivës gjinore në politikëbërje dhe ligjvënien krijon boshllëqe të rrezikshme që jo vetëm i lënë viktimat pa mbrojtje, por gjithashtu mundësojnë që autorët të mos ndëshkohen dhe të ripërsërisin abuzimet pa pasoja.

Prandaj, është qenësore që dhuna kibernetike të integrohet si një formë e dhunës me bazë gjinore në strategjitë kombëtare dhe kuadrin ligjor të Kosovës. Rrjeti i Grave të Kosovës (RRGK) ka propozuar futjen e një neni specifik në Kodin Penal të Kosovës, që do të përkufizonte qartë dhunën kibernetike në bazë gjinore dhe do të siguronte ndëshkimin efektiv të autorëve. RRGK propozon që ky nen të vendoset në Kapitullin

XXI të Kodit Penal, i cili trajton veprat penale kundër lirisë dhe të drejtave të njeriut, dhe të shtohet si nen i ri: Neni 249 - Dhuna Kibernetike në Baza Gjinore. Këtë nevojë e konfirmon edhe Prokuroria Themelore në Prishtinë, sipas së cilës, “duke pasur parasysh trendin e rritjes së dhunës kibernetike përmes rrjeteve sociale dhe rrjeteve kompjuterike në përgjithësi është e nevojshme që dhuna kibernetike të përkufizohet me një nen të veçantë ashtu që ndjekja penale të jetë më e qasshme dhe më e lehtë”.

Përtej përmirësimeve ligjore është po aq e rëndësishme të rriten kapacitetet teknologjike dhe njerëzore të institucioneve të drejtësisë dhe sigurisë, sidomos policisë, prokurorisë e gjyqësorit. Hetimi dhe trajtimi i rasteve të dhunës kibernetike kërkon ekspertizë të specializuar dhe teknologji të avancuar për të gjurmuar autorët dhe për t'i fshirë përmbajtjet abuzive. Bashkëpunimi ndër-mjet institucioneve të drejtësisë dhe sigurisë është i domosdoshëm për të garantuar një qasje të koordinuar dhe efektive ndaj kësaj forme të dhunës. Po ashtu, bashkëpunimi me kompanitë e mëdha teknologjike, si Meta, Google dhe TikTok, është thelbësor për të siguruar fshirjen e materialeve abuzive pa pëlqim, si dhe për të parandaluar përhapjen e metut-jeshme të tyre.

Gjithashtu, politikat efektive duhet të përfshijnë masa mbrojtëse dhe mbështetje të gjithanshme për viktimat. Ofrimi i qasjes në strehimore, ndihmës ligjore, këshillimit psikologjik dhe mekanizmave të sigurt për raportimin e rasteve, do të mundësonte që viktimat të ndiheshin të mbrojtura dhe të mbështetura për të raportuar dhe ndjekur rastet.

Dhuna kibernetike duhet të trajtohet si dhunë me bazë gjinore në mënyrë që të luftohet dhe parandalohet. Në Kosovë, ku rreth 99% e familjeve kanë qasje në internet, është jetike që të hartohen politika të drejta dhe të ndjeshme ndaj gjinisë për të garantuar sigurinë dhe mirëqenien digjitale, mbrojtjen e të dhënave personale dhe privatësinë kibernetike. Vetëm përmes kësaj qasjeje të integruar mund të sigurojmë një mjedis digjital të shëndetshëm dhe të sigurt, i cili ofron hapësira ku gratë dhe vajzat mund të marrin pjesë pa frikë nga dhuna, abuzimi apo përndjekja.

Votimi i diasporës dhe nënpërfaqësimi i grave: Yrnek i pandryshuar brenda dhe jashtë kufijve



Fortesa Hajdini

Në një epokë globale, ku e djatha ekstreme për çdo zgjedhje më shumë votohet e normalizohet, racizmi dhe nacionalizmi po rriten dhe të drejtat e grave po sulmohen gjithnjë e më shumë, Kosova nuk ka qenë dhe nuk mbetet e imunizuar.

Epidemia e dhunës ndaj grave, femicidit dhe kërcënimeve ndaj autonomisë trupore, vazhdon të jetë plagë e hapur dhe duhet të trajtohen si urgjencë shtetërore. Ndërkohë, organizatat e shoqërisë civile që mbrojnë të drejtat e grave po përballen me rënie të mbështetjes.

Duke marrë parasysh regresin dhe zgjedhjet e shkurtit si një mekanizëm bazik të llogaridhënies dhe reflektimit të dëshirës së popullit, cilat janë tendencat e partive politike dhe elektoratit sa i përket pozicionimit të grave në listat zgjedhore dhe në rezultatet përfundimtare? Në këtë kontekst zgjedhor, diaspora kosovare shpesh shihet si një faktor politik ndikues, por a ndikon në avancimin e përfaqësimit të grave, apo i riprodhon të njëjtat struktura patriarkale që ekzistojnë brenda vendit?

Zgjedhjet si sfida për barazinë gjinore

Nga këndvështrimi ndërthurës, “Grupi Gra” nuk është homogjen: ekzistojnë dallime të pushtetit brenda grupit, si ato etnike, socio-ekonomike dhe ideologjike. Megjithatë, struktura e shtetit dhe pushtetit është formuar nga faktorët politikë, ekonomikë dhe shoqërorë, të cilët krijojnë përvoja të ndryshme për gratë dhe burrat. Këto struktura të ndërtuara mbi kufizime gjinore jo vetëm që ndikojnë jetën dhe mundësitë e grave ndryshe nga ato të burrave, por gjithashtu veprojnë si pikënisje në formimin e interesave të përbashkëta për shumë gra në kontekste të ndryshme.

Në zgjedhjet e fundit parlamentare në Kosovë, më 9 shkurt, tri partitë më të votuara: Lëvizja Vetëvendosje, Partia Demokratike e Kosovës dhe Lidhja Demokratike e Kosovës, prezantuan listat e tyre me nga 110 candidate/ë, me këtë përfaqësimi të grave:

Lëvizja Vetëvendosje 41 gra candidate, duke përbërë 37.2% të listës, ndërsa Partia Demokratike e Kosovës dhe Lidhja Demokratike e Kosovës secila nga 38 gra candidate, përkatësisht 34.5% të listës.

Sa u përket rezultateve brenda Kosovës, në mesin e dhjetë candidateve/ëve më të votuar/a brenda tri partive më të mëdha, u renditën nga tri gra: Lëvizja Vetëvendosje: Albulena Haxhiu (e pesta), Donika Gërvalla-Schwarz (e shtata) dhe Mi-moza Kusari Lila (e nënta).

Partia Demokratike e Kosovës: Vlora Çitaku (e katërta), Sala Jashari (e pesta) dhe Ganimete Musliu (e teta).

Lidhja Demokratike e Kosovës: Doarsa Kica Xhelili (e dyta), Hykmete Bajrami (e treta) dhe Jehona Lushaku Sadriu (e teta).

Votimi me kusht po ashtu pasqyron të njëjtin hierarkizim, ku vetëm tri gra arrijnë të pozicionohen në top dhjetëshet e këtyre partive. Ky nënpërfaqësim reflekton vazhdimësinë e një mendësisë patriarkale brenda politikës.

Zgjedhja e grave në poste politike nuk varet, siç mendohet, nga gatishmëria e tyre për të kandiduar, por nga roli aktiv i partive politike në inkuadrimin ose përjashtimin e tyre nga vendimarrja. Dahlerup shpjegon se pavarësisht që votuesit përcaktojnë rezultatet elektorale në zgjedhje, përgjegjësia mbi inkuadrimin dhe përfaqësimin e grave ne listat elektorale u takon partive politike në nominimin e candidateve/ëve. Faktorët vendimtarë për rritjen e numrit të grave të zgjedhura janë veprimet e qëllimshme dhe të vetëdijshme të udhëheqësive të partive, si implementimi i kuotave gjinore. Partitë që implementojnë kuota vullnetare 50% kanë një mesatare më të lartë të grave të zgjedhura sesa ato që nuk e bëjnë këtë.

Studimet tregojnë se përfaqësimi i shtuar i grave në politikë nuk është vetëm një çështje e barazisë formale, por ndikon në cilësinë e politikave publike. Prania e grave është e lidhur me përparimin e çështjeve që kanë rëndësi të veçantë për shëndetin dhe mirëqenien, përfshirë të drejtat riprodhuese, parandalimin e dhunës ndaj grave dhe përmirësimin e shërbimeve sociale. Këto përparësi, të cilat shpesh marginalizohen në struktura patriarkale, janë më të pranishme dhe më fuqishëm të përfaqësuara kur gratë janë më të përfshira në vendimarrje. Femicidi, dhuna ndaj grave dhe diskriminimi sistematik duhet të luftohen në mënyrë të përgjeshme nga subjektet që synojnë ta përfaqësojnë popullin.

Diaspora voton

Pa i hyrë diskutimit rreth zgjerimit, apo kufizimit të së drejtës së votimit jashtë vendit, ose rreth të drejtës për të ndikuar pa u ndikuar: si fakt neutral, diaspora është duke votuar e ndikuar.

Diaspora nuk mund të konsiderohet si statike, ose e pa-influencuar nga vendet pritëse. Edhe pse sfera politike në Kosovë ka ndryshuar që nga 2018, Maria Koinova, në *Sending States and Diaspora Positionality in International Relations dhe Endorsers, challengers or builders? Political parties’ diaspora outreach in a post-conflict state*, sqaron që kontributi i diasporës në Kosovë ndryshon në varësi të vendit pritës dhe kontekstit socio-politik. Po ashtu, ndikojnë arsyet dhe etablimi kohor në vendet pritëse. Sqarohet, mes tjerash, që diaspora në Zvicër ka pasur ndikim në aspektin financiar, duke marrë parasysh investimet ekonomike. Diaspora në SHBA ka qenë e angazhuar në lobim diplomatik dhe politik. Ndërkohë, diaspora në Suedi ka qenë më e përqendruar në edukimin në gjuhën shqipe duke zhvilluar iniciativa për mësimdhënie në shqip.

Gjithashtu, angazhimi i diasporës përcaktohet edhe nga strategjitë e ndjekura nga partitë politike në Kosovë. Sipas Koinovës, partitë kosovare ndjekin tri qasje kryesore në lidhje me komunikim me diasporë: shtet-mbështetëse, ku diaspora mobilizohet për të forcuar shtetin dhe institucionet e tij; shtet-sfiduese, ku diaspora aktivizohet për të sfiduar

strukturat dhe për të kërkuar ndryshime rrënjësore, si dhe ndërtimi partiak, ku diaspora aktivizohet si mbështetëse për subjektet politike.

Angazhimi i diasporës nuk është i njëtrajtshëm, por përcaktohet nga faktorët politikë dhe ekonomikë të vendit pritës, si dhe nga mënyra se si akterët politikë në Kosovë kërkojnë ta përfshijnë atë në zhvillimet e vendit. Duke marrë parasysh këtë, si reflektohet dëshira politike e diasporës në zgjedhje? A reflektohet përvoja e diasporës me organizimin e shoqërisë në shtetet pritëse me prishmëritë dhe qasjen e saj ndaj përfaqësimit gjinor politik në Kosovë?

Zgjedhjet 2025

Votat nga diaspora i referohen votimit në përfaqësitë diplomatike dhe atyre përmes postës. Ndërkaq, votat e diasporës në vendvotimet fizike në Kosovë nuk dallohen në statistika të veçanta, por trajtohen si vota të brendshme.

Nga rezultatet e votimit nga përfaqësitë diplomatike, tri subjektet më të votuara kishin gjithsej 14.545 votues (numri total i votuesve nga përfaqësitë diplomatike ishte 15.191). Nga këto, Lëvizja Vetëvendosje mori 12.261 vota (80.71%), Partia Demokratike e Kosovës fitoi 1.175 vota (7.73%) dhe Lidhja Demokratike e Kosovës kishte 1.109 vota (7.30%). Në votimin nga përfaqësitë diplomatike, ashtu si në Kosovë, në secilën nga këto parti, nga dhjetë kandidatet/ët më të votuar/a, vetëm tri ishin gra. Megjithëse nuk mund të nxjerrim përfundime të plota nga këto shifra marginale, vlen të theksohet se votimi nga përfaqësitë diplomatike ndjek të njëjtën tendencë gjinore si ai brenda Kosovës.

Sa i përket votimit përmes postës, nga gjithsej 61.979 vota, Lëvizja Vetëvendosje mori 31.963 (51.57%), Lidhja Demokratike e Kosovës 18.933 (30.55%) dhe Partia Demokratike e Kosovës 5.878 (9.48%). Edhe këtu pasqyrohet i njëjti model i pozicionimit: nga dhjetë kandidatet/ët më të votuar/a, tri ishin gra në Lëvizjen Vetëvendosje, tri në Partinë Demokratike të Kosovës, ndërsa në Lidhjen Demokratike të Kosovës kishte një ndryshim, pasi u renditën katër gra.

Këto rezultate konfirmojnë një prirje të ngjashme me atë brenda Kosovës: forcimin e Tavanit të Qelqtë, si pjesë e një tendence më të gjerë në sferën politike të vendit.

Riprodhimi i diasporës, gjinia dhe hierarkia

Historikisht, diaspora kosovare ka qenë faktor i rëndësishëm në politikën e vendit, por kjo nuk është përkthyer në një mbështetje të qartë për barazinë gjinore. Camilla Orjuela, në *Mobilising diasporas for justice. Opportunity structures and the presence of a violent past*, shpjegon se diasporat e dala nga kontekste të dhunshme dhe me konflikte, atë histori shpesh e mbajnë në qendër të riprodhimit të identitetit të përbashkët, gjë që është evidente edhe në kontekstin tonë.

Definicioni formal i një pjesëtares/it të diasporës, si çdo person që ka vendqëndrim jashtë Republikës së Kosovës dhe që ka lindur apo ka prejardhje familjare nga Kosova, është pasiv. Në fakt, për t’u konsideruar si diasporë, janë disa kriterë që duhet të përmbushen. Brubaker në The ‘diaspora’ diaspora prezanton tri kriterë të cilat nevojiten që një grup të konsiderohet si diasporë: shpërndarje gjeografike; orientim drejt atdheut dhe ruajtje e kufijve nga popullsia vendase. Do të thotë, një zgjedhje aktive për t’u mos asimiluar dhe për të riprodhuar identitet të përbashkët.

Çka mbetet në qendër të këtij riprodhimi identitar konstant?

Studime feministe mbi diasporën tregojnë se diaspora nuk është një entitet homogjen, por një hapësirë e hierarkizuar në brendinë e saj. Ka shumë për t’u bërë akoma në studimin e diasporës kosovare nga një këndvështrim feminist. Sidoqoftë, përvoja e migracionit, zhvillimit dhe riprodhimit të identitetit të diasporës nuk mund të kuptohet si neutrale edhe e pa-gjinorëzuar. Përvoja e grave të diasporës s’mund të anashkalohej në diskursin e gjerë. Diasporat janë komplekse dhe të strukturuar brenda nga hierarkitë gjinore, prandaj nuk mund të shihen si një trup i vetëm me interesa të përbashkëta. Edhe në diasporë ndërthuren klasa, gjinia dhe identitetet politike.

E ardhmja dhe nevoja për ndryshime strukturore

Shteti dhe shoqëria nuk organizohen në mënyrë neutrale, por janë të ndërtuara mbi baza patriarkale. Tavanet e Qelqta përfaqësojnë barrierat e padukshme që pengojnë gratë të avancojnë në pozita të larta vendim-marrëse, në sektorin publik dhe në atë privat. Këto barrierat janë produkt i strukturave patriarkale. Partitë politike në Kosovë duhet t’i sfidojnë këto struktura, duke shkuar përtej minimumit të kuotës ligjore prej 30% drejt kuotës vullnetare prej 50%, për ta promovuar përfaqësimin e barabartë gjinor në parlament. Kjo duhet të shihet si minimumi, duke parë që politika dhe hapësira publike vazhdojnë të konsiderohen prona të burrave. Kuota 50% është thelbësore në kërkesën për përfaqësim të barabartë, sepse interesat e grave – sigurimi i shërbimeve shëndetësore, të drejtat riprodhuese dhe të mbrojtjes kundër dhunës në familje, femicidit dhe ngacmimit – shpesh injorohen, ose nënvlerësohen, në struktura politike ku përfaqësimi gjinor është i pabarabartë.

Një model frymëzues për përfaqësuesit politikë në Kosovë mund të jetë ai i Suedisë. Termi i krijuar para zgjedhjeve të vitit 1994, “Varannan damernas” (“Çdo e dyta grua”), i referohet kuotës vullnetare, ku çdo i/e dyti/a kandidat/e në fletëvotimet e partive duhet të jetë grua. Në zgjedhjet e fundit suedeze të vitit 2022, fletëvotimet për parlamentin në nivel qendror përfshin mesatarisht 42.4% gra. Partitë me përqindjen më të lartë të grave candidate ishin Partia e Majtë (Vänsterpartiet) me 53.6%, Partia e Gjelbër (Miljöpartiet de gröna) me 52.1% dhe Socialdemokratët (Socialdemokraterna) me 49.1%. Ky fenomen i përfshirjes së barabartë të grave në fletëvotime është një ndër arsyet kryesore të përfaqësimit të lartë të grave në politikë.

Pozicionimi dhe renditja elektorale e grave në top dhjetëshet e reflekton më së miri ekzistencën e Tavanit të Qelqtë, duke treguar se pengesat strukturore dhe shoqërore vazhdojnë ta kufizojnë avancimin e grave në hierarkinë politike. Siç duket, Kosova akoma vazhdon të jetë peng i kufirit rreth 30%, sa nga ana e partive, sa nga elektorati. Po ashtu, diaspora pasqyron të njëjtën tendencë të zgjedhjeve të grave si brenda Kosovës. Duke marrë parasysh faktin neutral që diaspora dhe Kosova janë të ndërlidhura, shpresoj që ky relacion të zhvillohet edhe në një shkëmbim reciprok solidar, ku të drejtat e grave të trajtohen si çështje urgjente.

Autorja është aktiviste feministe dhe pjesëtare e diasporës.



Zëri i Diversitetit: Gratë queer dhe sfida e punësimit në Kosovë

CEL Kosova

Tashmë dihet që pjesëmarrja në tregun e punës dhe shkalla e punësimit, veçanërisht tek gratë dhe të rinjtë në Kosovë, mbetet shumë e ulët. Pavarësisht disa përparimeve, tregu i punës vazhdon të vuajë nga pjesëmarrja shumë e ulët, papunësia e lartë dhe hendeqet e mëdha gjinore. Kësisoj thuhet në një prej raporteve të publikuara nga Komisioni Evropian në vitin 2024.

Kosova ka një kornizë të avancuar ligjore që synon të garantojë të drejtat e njeriut dhe të adresojë diskriminimin në fusha të ndryshme, përfshirë punësimin. Megjithatë, këto ligje nuk përmbajnë nene specifike që trajtojnë pozitën dhe përfshirjen e personave LGBTI+ në këto fusha, ku lirisht mund të përmendim, krahas edukimit, edhe strehimin, shëndetësinë, sigurinë, por edhe pjesëmarrjen në jetën shoqërore.

Qendra për Barazi dhe Liri e Komuniteteve LGBTI+, CEL Kosova, si një prej organizatave që punon aktivisht tash e një dekadë për të drejtat e komuniteteve LGBTI+ në Kosovë, përmes tri programeve të saj dhe qindra aktiviteteve mundohet vazhdimisht ta navigojë edhe tregun e punës dhe problemet me të cilat përballen individët LGBTI+ në këtë aspekt.

Në sektorin e arsimit, Kushtetuta e Kosovës dhe ligjet përkatëse garantojnë katërcipërisht qasje të barabartë në arsim dhe ndalojnë diskriminimin. Mirëpo, Ligji për Arsimin Parauniversitar dhe Ligji për Arsimin e Lartë nuk ofrojnë masa specifike për të mbështetur personat LGBTI+, ose për të adresuar barrierat dhe diskriminimet e mundshme me të cilat përballen. Për më tepër, mungojnë politika dhe udhëzime administrative të cilat fokusohen në krijimin e një mjedisi të sigurt dhe gjithëpërfshirës për personat LGBTI+ në institucionet arsimore.

Këto të dhëna i gjeni edhe në raportin e publikuar nga CEL Kosova, në janar 2025: “Barriera të dyfishta: Edukimi, Punësimi dhe Diskriminimi ndaj Personave LGBTI+ në Kosovë”,

hulumtuar dhe shkruar nga Jeta Bakija, me ndihmën e komuniteteve tona. Qëllimi kryesor i këtij raporti ishte analizimi i kontekstit se si edukimi formal dhe joformal ndikojnë në mundësitë e punësimit të personave LGBTI+ në Kosovë në sektorin publik dhe privat. Raporti synon njashtu edhe t’i identifikojë sfidat dhe format e diskriminimit me të cilat dosido përballen personat LGBTI+ në aspektin e arsimit dhe në tregun e punës.

Në sektorin e punësimit, Ligji i Punës ndalon diskriminimin, duke përfshirë orientimin seksual si bazë mbrojtjeje. Megjithatë, nuk ka dispozita specifike për të mbrojtur personat LGBTI+ në vendin e punës, ose për të siguruar qasje të barabartë në rekrutim dhe avancim profesional. Ligji Kundër Diskriminimit përfshin orientimin seksual dhe identitetin gjinor si kategori të mbrojtura, por zbatimit i tij është i dobët, dhe rastet e diskriminimit shpesh mbesin të pazgjidhura. CEL Kosova, por edhe organizatat tjera të cilat punojnë me komunitetet LGBTI+, mund të dëshmojnë për raste të ndryshme kur individët janë dëmtuar e shpesh edhe larguar prej vendeve të tyre të punës vetëm sepse: a) kanë zbuluar orientimin e tyre seksual, apo b) është aluduar prej të tjerëve për një orientim seksual jo heteronormativ.

Mungojnë politikat dhe masat për nxitjen e përfshirjes së personave LGBTI+ në tregun e punës. Nga analizimi i literaturës mund të themi që nuk ekzistojnë programe të cilat synojnë integrimin e personave LGBTI+ në tregun e punës përmes mundësive të trajnimit, mentorimit, ose subvencionimit. Edhe pse legjislacioni në fuqi ndalon diskriminimin edhe në bazë të orientimit seksual, nuk ka politika proaktive që adresojnë barrierat strukturore me të cilat përballen personat LGBTI+ gjatë procesit të punësimit dhe avancimit profesional. Nga procesi i hulumtimit për publikimin e raportit të sipërpërmendur nga CEL Kosova, shihet se nuk janë zhvilluar partnerite me sektorin privat apo publik për të promovuar punësimin gjithëpërfshirës, ndërsa fushatat për

ndërgjegjësimin e punëdhënësve mbi diversitetin dhe përfshirjen janë shumë të pakta.

Një aspekt tjetër shqetësues është mungesa e mbështetjes institucionale për personat LGBTI+ në vendin e punës. Shumë pak organizata ofrojnë trajnime ose politika të brendshme që promovojnë diversitetin dhe përfshirjen. Kjo mungesë ndërgjegjësimi dhe mbështetjeje rrit rrezikun e diskriminimit dhe krijon një mjedis pune armiqësor për personat LGBTI+.

Për t’i adresuar këto sfida është e domosdoshme që institucionet publike dhe private të ndërmarrin hapa konkretë për të zbatuar ligjet ekzistuese kundër diskriminimit dhe të zhvillojnë politika që promovojnë përfshirjen e personave LGBTI+ në vendin e punës. Kjo përfshin ofrimin e trajnimeve për ndërgjegjësimin e punëdhënësve dhe punonjësve, krijimin e mekanizmave të raportimit të diskriminimit dhe sigurimin e mbështetjes për viktimat e diskriminimit.

Megjithatë, në 8 Marsin e radhës, ditë që gjithmonë duhet të shërbejë si reflektim për pozitën shoqërore të grave në Kosovë, le të flasim për gratë lesbike dhe ato queer (term ombrellë për identitetet seksuale dhe gjinore që nuk janë heteroseksuale ose cisgjini. Mund të përfshijë një gamë të gjerë identitetesh, duke përfshirë lezbike, biseksuale, panseksuale dhe të tjera). Për ta përmirësuar situatën e punësimit për gratë queer në Kosovë, duhet të forcohet zbatimi i ligjeve ekzistuese kundër diskriminimit. Duhet të krijohet mekanizma që të sigurojnë zbatimin efektiv të Ligjit të Punës dhe Ligjit Kundër Diskriminimit, veçanërisht për gratë queer. Një sistem anonim raportimi për diskriminimin në vendin e punës mund të ndihmojë në trajtimin e rasteve të marginalizimit dhe keqtrajtim.

Gjithashtu, në vendet e punës duhet të inkurajohet adopsionit i politikave të diversitetit dhe përfshirjes, duke organizuar trajnime të detyrueshme për punëdhënësit dhe punonjësit mbi të drejtat e LGBTI+, me një fokus të veçantë te gratë queer. Këto trajnime do të ndihmonin në krijimin e ambi-

enteve më të sigurta dhe gjithëpërfshirëse. Është po ashtu e rëndësishme të zhvillohen programe trajnimi profesionale për gratë queer, sidomos në sektorët ku ato janë të pakta. Duhet të ofrohen gjithashtu stimuj financiarë, si grante ose subvencione, për të mbështetur gratë queer në nisjen e bizneseve të vogla dhe të mesme. Ngritja e rrjeteve profesionale për gratë queer do të ndihmojë gjithashtu në mentorimin dhe ndarjen e përvojave.

Në fund, fushatat e ndërgjegjësim-it mund të luajnë një rol të rëndësishëm në ndriçimin e sfidave me të cilat gratë queer përballen në tregun e punës. Duke promovuar rëndësinë e politikave gjithëpërfshirëse, këto fushata do të ndihmojnë në reduktimin e diskriminimit të vazhdueshëm dhe do të krijojnë një treg pune më të barabartë për gratë queer në Kosovë. Iniciativat synojnë krijimin e një mjedisi pune më të drejtë dhe më të sigurt për gratë queer, duke adresuar sfidat e veçanta me të cilat ato përballen dhe duke siguruar mundësi të

barabarta për punësim dhe avancim profesional.

Si përfundim, përfshirja e personave LGBTI+ në tregun e punës në Kosovë është thelbësore për ndërtimin e një shoqërie të drejtë dhe gjithëpërfshirëse. Me adresimin e barrierave ekzistuese dhe promovimin e një kulture të respektit dhe barazisë në vendin e punës, mund të sigurojmë që të gjithë individët, pavarësisht orientimit seksual ose identitetit gjinor, të kenë mundësi të barabarta për të kontribuar dhe për të përfituar nga zhvillimi ekonomik dhe social i vendit.

Për të kontribuar në këtë ndryshim, CEL Kosova vazhdon të jetë e angazhuar në mbështetjen e personave LGBTI+ në tregun e punës, duke ofruar asistencë, këshillim dhe trajnime. Ne inkurajojmë të gjithë individët që përballen me diskriminim ose kërkojnë mbështetje në punësim, të na kontaktojnë dhe të përfitojnë nga shërbimet tona, sepse vetëm duke punuar së bashku mund të ndërtojmë një shoqëri ku të gjithë kanë mundësi të barabarta.



Kosova në udhëkryq: Përplasja mes reformave progresive dhe narrativave konservatore



Marigona Shabiu

Në procesin e zhvillimit socio-politik të Kosovës, ngjarjet e fundit kanë nxjerrë në pah një tension të ndjeshëm midis reformave progresive dhe kundërpërgjigjes konservatore. Kjo dinamikë është bërë e dukshme në ndryshimet në skenën politike, gjuhën e urrjetjes ndaj personave LGBTIQ+, debatet mbi të drejtat e grave dhe të drejtat riprodhuese e deri të diskutimet rreth komuniteteve jo-shumicë, duke pasqyruar kështu diskurset globale mbi gjininë, identitetin dhe vlerat familjare.

Zgjedhjet parlamentare të shkurtit të këtij viti shënuan një ndryshim të dukshëm në prirjet politike të vendit. Ndërsa Lëvizja Vetëvendosje (VV) mbeti forca politike dominuese, rënia e saj shfaq një pakënaqësi në rritje dhe një elektorat më të fragmentuar. Ndër akterët e rinj politikë në këto zgjedhje ishte Koalicioni për Familjen, një grup që avokon për mbrojtjen e vlerave të ashtuquajtura tradicionale. Pavarësisht se fitoi vetëm 2.27% të votave sipas rezultateve preliminare, ky koalicion arriti të pozicionohet mjaft fuqishëm në diskursin publik.

Retorika e tyre, e përqendruar në kundërshtimin e reformave progresive mbi gjininë, identitetin gjinor e orientimin seksual, rezonon me një pjesë të popullsisë që i sheh këto ndryshime si kërcënim për strukturën sociale e kulturore të Kosovës. Kjo prirje përputhet me lëvizjet e ngjashme në mbarë Evropën dhe më gjerë, ku grupet e djathta ekstreme dhe ato fetare kërkojnë të riformulojnë diskursin mbi të drejtat e njeriut duke u paraqitur si mbrojtës të “rendit natyror”.

Në qendër të këtij hendeku kulturor dhe politik janë të rinjtë e Kosovës, të cilët kanë pikëpamje të larmishme mbi këto çështje. Raporti i vitit 2024 i Friedrich-Ebert-Stiftung (FES) tregon për një brez të ndarë mes dëshirës për modernizim, integrim evropian dhe barazi gjinore, dhe një lidhjeje të fortë me normat tradicionale shoqërore. Ndërsa shumë të rinj i mbështesin politikat progresive, një pjesë e konsiderueshme mbetet skeptike ndaj ndryshimeve të shpejta shoqërore, duke reflektuar ndikimin e strukturave familjare dhe institucioneve fetare. Kjo dilemë brezash paraqet sfida për politikëbërësit që synojnë të zbatojnë reforma në përputhje me standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, por që kërkojnë edhe mbështetje të gjerë shoqërore.

Një nga debatet më të nxehta të vitit të fundit ka qenë ai mbi Ligjin për Fertilizimin In Vitro (IVF). Fillimisht i propozuar në fund të vitit 2023, ky ligj synonte të rregullonte riprodhimin e asistuar, duke garantuar qas-

je si për çiftet ashtu edhe për gratë beqare. Megjithatë, projektligji u bë shpejt një fushëbetejë mes atyre që mbrojnë të drejtat riprodhuese dhe fraksioneve konservatore që kërkojnë ta kufizojnë atë vetëm për çiftet e martuara heteroseksuale. Kur Kuvendi i Kosovës ishte gati të votonte për këtë ligj, në shkurt të vitit 2024, seanca u anulua për mungesë kuorumi - një tregues i qartë i ndasive të thella mbi këtë çështje. Kundërshtarët e ligjit e justifikuan qëndrimin e tyre me mbrojtjen e familjes tradicionale, ndërsa mbështetësit theksuan të drejtën e grave për të vendosur mbi trupin dhe shëndetin e tyre riprodhues. Moskalimi i ligjit ka lënë shumë njerëz në një boshllëk ligjor, veçanërisht gratë që varen nga IVF si opsioni i vetëm për të pasur fëmijë.

Një tjetër çështje që ka ndezur debate të ashpra është përdorimi i manualit të Fondit të Kombeve të Bashkuara për Popullsinë (UNFPA) mbi edukimin seksual në shkollë. Këto materiale, të dizajnuara për të ofruar informacione mbi kontracesionin dhe pëlqimin, u bënë objekt polemikash të forta. Disa komuna, përfshirë Prishtinën, Fushë Kosovën dhe Skenderajin, ndaluan përdorimin e tij pas kundërshtimeve nga grupet konservatore dhe organizatat e prindërve. Kritikë të fokusuan në pretendimin se manuali promovon vlera që nuk përputhen me traditën kulturore dhe fetare të Kosovës. Përballë presionit të madh, Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit vendosi ta tërhiqte manualin për rishikim. Diskutimet mbi ar-

simin po formësohen gjithnjë e më shumë nga betejat ideologjike, sesa nga konsideratat pedagogjike dhe shkencore.

Përdorimi i një gjuhe më gjithëpërfshirëse në institucione arsimore u bë gjithashtu objekt debati, siç u pa në rastin e shkollës fillore “Elena Gjika” në Prishtinë. Për të njohur strukturat të ndryshme familjare, shkolla prezantoi formularë administrativë që zëvendësonin termat tradicionale “nënë” dhe “baba” me “Prindi 1” dhe “Prindi 2”. Ky ndryshim, në përputhje me praktikën e adoptuar në disa vende evropiane, shkaktoi reagime të ashpra. Kritikët e panë këtë si një sulm ndaj vlerave tradicionale familjare. Debati u zgjerua në nivel kombëtar, me përfshirjen e politikanëve dhe mediave, duke reflektuar se si një ndryshim i thjeshtë administrativ mund të shndërrohet në një simbol të betejave më të mëdha mbi identitetin dhe vlerat në Kosovë.

Roli i arsimit në formësimin e qëndrimeve shoqërore të gjeneratave të reja u vu më tej në pah në dhjetor të vitit 2024, kur Nisma e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut (YIHR) publikoi një raport mbi gjuhën diskriminuese në tekstet shkollore. Raporti zbuloi mbi 100 raste të gjuhës përjashtuese dhe paragjyquese, kryesisht në lidhje me etninë, gjininë, orientimin seksual dhe përjashtimin social. Ai theksoi se tekstet shpesh forcojnë stereotipa të dëmshëm gjinorë dhe nuk përfaqësojnë identitetet LGBTIQ+, ose strukturat të ndryshme familjare. Për shembull, në disa tekste të historisë u gjetën paragjykime etnike që mund

të nxisnin ndasi, ndërsa në tekstet e biologjisë u identifikuan terma të vjetruar dhe ofendues për personat me aftësi të kufizuara. Publikimi i raportit ngjalli reagime të forta, me aktivistë dhe organizata të shoqërisë civile që kërkuar reforma urgjente në tekstet shkollore.

Këto zhvillime janë pjesë e një vale më të gjerë globale të lëvizjeve anti-të drejta dhe anti-gjinore, që po sfidojnë progresin e arritur në dekadat e fundit. Kosova ndodhet në një udhëkryq: a do të vazhdojë rrugën drejt integritimit evropian dhe respektimit të të drejtave të njeriut, apo do të dorëzohet përballë forcave që synojnë të ruajnë hierarkitë e vjetra shoqërore? Përgjigjia do të përcaktojë jo vetëm të ardhmen e politikave të saj, por edhe vetë karakterin demokratik të Kosovës.

Rritja e lëvizjeve anti-gjinore nuk është thjesht një çështje feministe; është një kërcënim ndaj demokracisë, kohezionit shoqëror dhe të drejtave themelore të të gjithë individëve. Si shoqëri, duhet të kuptojmë se mbrojtja e të drejtave të grave, personave LGBTIQ+, komuniteteve jo-shumicë dhe grupeve të tjera të marginalizuara është thelbësore për demokracinë tonë. Duhet të qëndrojmë së bashku për të kundërshtuar përhapjen e narrativave anti-gjinore dhe për të ndërtuar një shoqëri ku çdo individ ndihet i lirë dhe i barabartë. Solidariteti dhe rezistenca janë urgjente.

Autorja është Drejtore Ekzekutive e YIHR KS.

Të krijosh në errësi

Mbi narrativat e grave dhe vajzave në kinematografinë kosovare



Doruntina Basha

Vitet e fundit, bota e ka shikuar Kosovën duke u shpalosur përmes rrëfimeve të grave në kinematografi. Fascinuese për botën - e më pak për Kosovën, gjithmonë me vonesë të interesuar për skenën e vet kulturore - kjo shpalosje, krejt natyrshëm, ka nxitur kureshtje. Si është e mundur që ky mjedis kaq dekurajues kultur- alisht, e i pafavorshëm ekonomikisht, me buxhete të varfra për prodhimin e filmave, e pa një industri të mirë- filltë filmike, të nxjerr një rrufe zërash të padëgjuar më parë, rrëfime që, secila në mënyrën e vet, shtjello-jnë se çfarë do të thotë të jesh vajzë e grua në një sistem të cilit nuk i inter-teson një gjë e tillë?

Arsyet mund të jenë të shumta. Dikush mund të thotë se kanë të bëjnë me qasjen më të lehtë në edukim jashtë vendit. E dikush tjetër mund ta ndërlidh me tranzicionin in-stitucional të mbështetjes së film-berjes nga një sistem i mbyllur e cen- tralizues në një të hapur ndaj bashkëpunimeve ndërkombëtare, e më pranues ndaj diversitetit të per- spektivave. Përderisa këto shpjegime janë valide dhe përbëjnë kushte të domosdoshme për ndërtimin e një ambienti të mirëfilltë krijues për të gjithë, megjithatë nuk janë mjaftueshëm bindëse për të shp- jeguar specifikisht valën dinamike të narrativave të grave. Për më shumë, shpërfillin atë që i bën të gjithë ata zëra të llojllojshëm, bashkë: vështrimin e kthjelltë të gjinorizuar. Në historinë e kinematografisë

kosovare (që nga fillimet e Koso- vafilmit në të ‘70-at e hershme), gratë nuk kanë qenë jashtë ekranit. Ato i shohim kryesisht në periferi të heroizmave, përpjekjeve e dilemave madhore mashkullore që zënë qen- drën e rrëfimit. Ato janë krejtësisht pasive dhe të ngulitura brenda roleve shtëpiake dhe në relacione vartëse me personazhet kryesore burra. Ato rëndom janë “nëna, motra, bashkëshortja apo vajza” e dikujt më me rëndësi se ato vetë, më të denjë që ta bartë në supe të veta rrëfimin si protagonist. I vërejmë por, të tilla, nuk na ftojnë t’i shikojmë e t’i shqyr- tojmë. Të tilla, thjesht, nuk na in- teresojnë. Këto pamje, të sjella nga vështrimi mashkullor, sado këm- bëngulëse e të kudondodhura në fiksion, shpërfaqin një të vërtetë të madhe nga realiteti: shoqërisë, në përgjithësi, aq i interesonte jeta e grave.


Mungesa e regjisoreve gra në tra- ditën modeste të filmit kosovar (të gjithë filmat e krijuar gjatë funk- sionimit të Kosovafilmit ishin bërë nga regjisorë, skenaristë e drejtorë fo- tografie burra) ka paraqitur një bosh- llëk të madh për një mori krijuesesh të reja që pas luftës iu rreken profe- sionit të tregimtarisë, plot ambicie e rrëfime, e pak mbështetje e besim nga institucionet e komuniteti. Në një shoqëri të sapodalë nga lufta, me in- stitucione të sapoformuara që mezi rrinin në këmbë, një grimcë tradite do të ishte ngushëllim e motiv i mjaftueshëm për to që të mos hiqnin dorë nga ëndrrat e tyre ambicioze. Por, as kjo grimcë nuk ishte. Të mos kesh traditë krijuese do të thotë, në njëfarë forme, të jesh në një lloj ter- ri. Me fjalë të tjera, për të nxjerrë diç- ka në dritë, ato u desh të kërkonin - apo thënë më mirë, të gërmonin - në errësi.

Duke iu referuar përshkrimit që Virginia Woolf e bën në ditarin e saj lidhur me gjendjen e botës pas sh- përthimit të Luftës së Parë Botërore

(“The future is dark, which is on the whole, the best thing the future can be” – “E ardhmja është e errët, gjë që, në përgjithësi, është më e mira që e ardhmja mund të jetë”), shkrimtarja dhe aktivistja amerikane, Rebecca Solnit, në librin e saj “Hope in the Dark” (2003) e ofron një tjetër inter- pretim të errësirës. Duke u mbështe- tur në komentin e Woolf, ajo thotë se errësira nuk është domosdoshmë- risht e tmerrshme; më parë, ajo është e pazbërthyeshme, e paqartë, duke e shndërruar atë në një terren për mundësi të reja. Më tutje, ajo shton: “Kur e pranon paqartësinë (pazbërthyeshmërinë?), e pranon se mund të kesh ndikim në rezultatet e saj”.

Në vitin 1971, poetja e teoricienja feministe amerikane, Adrienne Rich, ishte ftuar për një ligjëratë në kon- ferencën që kishte për fokus gratë shkrimtare. E inspiruar nga drama e Ibsenit “When We Dead Awaken” (“Kur ne të vdekurit zgjohemi”), dramë që e trajton ndërgjegjësimin e grave për rolin që burrat krijuen ua kishin mveshur në fiksionet e re- alitetet e tyre, edhe ligjërata e saj (e titulluar “When We Dead Awaken: Writing as Re-Vision”, më vonë e pub- likuar në College English, 1972) fokusohet pikërisht në “zgjimin” kolektiv, apo ndërgjegjësimin e grave krijuese në Amerikën e të ‘70-ve, nevojën për të reaguar kundër mi- tizimit të figurës së gruas së nën- shtruar në kanonin letrar të domin- uar nga burrat. Aty ajo sugjeron që tradita letrare ka nevojë për një “ri- shikim” (re-vision), “(...) jo për të për- cjellë traditën, por për t’u shkëputur nga pushteti i saj mbi ne”. Në këtë for- më, Rich besonte: krijueset gra do ta gjenin zërin e tyre të vërtetë.


40 vjet pas ligjëratës së Rich, në Kosovë gratë filmberëse e gjetën veten ende duke gjurmuar në errësi- ri si mënyrë për t’u shkëputur nga pushteti i traditës dominuese. Por - siç u dëshmuar me daljen në dritë të



veprave të tyre - të krijosh në errësi- ri nuk është rrethanë shtypëse e deku- rajuese. Është mundësi të krijosh pa udhërrëfyes, pa busull, pa hartë. Imagjiloni sa çliruese mund të jetë kjo. Të mos kesh udhërrëfyes do të thotë t’i hedhësh hapat nga të teket. Të mos kesh busull, apo hartë, do të thotë që po gjurmon atë që nuk ia ka zgjuar askujt më herët interesimin për ta gjurmuar. Pikërisht nga këtu dolën vështrimet e grave në kine- matografi (në shumë, po, sepse kurrë nuk mund të jetë vetëm një vështrim), jo si reagim kundër vështrimit mashkullor, por si mënyrë

e pavarur për të rrëfyer përvojat e të jetuarit si vajzë e grua në plotëni dhe me të gjitha kompleksitetet që ndërthuren me këtë. Këto vështrime nuk kërkojnë validim nga kultura dominuese dhe as nuk pretendojnë se po ndriçojnë shteg për gjeneratat e ardhshme të vajzave e grave. Ato thjesht po dëshmojnë se ka shumë mënyra për të qenë vajzë apo grua në rrëfimtari, dhe cilado qoftë ajo mënyrë, nuk është më në sfondin e jetëve të tjera.

Autorja është dramaturge dhe skenariste.



Alba Jakupi

Rruga drejt barazisë gjinore në Kosovë mbetet një sfidë - jo vetëm në tregun e punës, por edhe në sigurimin që vajzat e reja të kenë aftësitë, vetëbesimin dhe mundësitë për të marrë një rol aktiv në vendimarrje dhe për t’i udhëhequr ndryshimet shoqërore. Pengesa të shumta socio- ekonomike dhe strukturore vijojnë të mbajnë në margjina shumë gra, veçanërisht ato nga komunitetet joshumicë, vajzat e reja me aftësi të kufizuara dhe ato nga shtresat e pafavorizuara socio-ekonomike. Sipas të dhënave të fundit të Agjen- cisë së Statistikave të Kosovës, pjesë- marrja e grave në fuqinë punëtore mbetet dukshëm më e ulët se ajo e burrave - vetëm 19.8% e grave janë të punësuar, krahasuar me 53.4% të burrave. Diskriminimi në vendin e punës, duke përfshirë pabarazinë në paga, ngacmimet seksuale dhe mungesën e mundësive për avancim në karrierë, mbeten sfida të vazh- dueshme. Për më tepër, kushtet e punës që nuk janë fleksibile për t’i përputhur angazhimet personale dhe shoqërore vazhdojnë ta pengojnë progresin.

Diskutimet mbi punësimin e grave shpesh përqendrohen në diskrimin- imin në vendin e punës, por sfida e vërtetë fillon shumë më herët. Si mund t’i përgatisim vajzat e reja për të hyrë në një treg pune konkurrues dhe shpesh të pabarabartë, me rezis- tencën dhe aftësitë e duhura? Përgjig- ja qëndron në investimin e hershëm në lidhshp, mendim kritik dhe sis- teme mbështetëse mes moshatareve

- rrjete që i fuqizojnë vajzat e reja të mbështesin njëra-tjetrën, të kapërce-jnë pengesat dhe të krijojnë ndryshime të qëndrueshme së bashku. Megjithatë, fuqizimi i vërtetë kërkon një ndryshim kolektiv, ku institucionet, vendet e punës dhe ko- munitetet krijojnë mjedise gjithëpër- shirëse që i mbështesin dhe i pro- movojnë vajzat e reja krahas bashkë- moshatarëve të tyre.

Në këtë kontekst, Rrjeti i Alumneve të Akademisë së Dialogut (DANA) - një rrjet dinamik i vajzave të reja që udhëheqin iniciativat në zhvillimin e lidhshp, mentorimin dhe anga- zhimin shoqëror - është një shembull i fuqizimit individual dhe kolektiv. DANA rrjedh nga Akademia e Dia- logut për Vajza të Reja, një program transformues që Misioni i OSBE-së në Kosovë organizon çdo vit në bashkëpunim të ngushtë me Mi- sionin e OSBE-së në Serbi. Pas për- fundimit të Akademisë së Dialogut, pjesëmarrëset bëhen pjesë e DANA- s, i cili deri më sot numëron 230 anëtare.

Anëtarët e DANA-s, vajza të reja nga Prishtina dhe Beogradi, bashko- hen për të reflektuar mbi sfidat kryesore shoqërore që prekin shoqëritë e tyre dhe më gjerë. Ato i analizojnë këto sfida, zhvillojnë strategji për t’i kapërcyer dhe kupo- tojnë se transformimi i shoqërisë është i domosdoshëm dhe i mund- shëm. DANA u ofron anëtareve një platformë për të kuptuar se sfidat e përbashkëta mund të shndërrohen në mundësi për veprim dhe bashkëpunim kolektiv.

Ndërtimi i bazave për fuqizimin e grave

Arritja e fuqizimit ekonomik kërkon çmontimin e barrierave sistemike, transformimin e normave diskrim- inuese gjinore dhe krijimin e mjedi- seve ku vajzat e reja mund të lulëzo-jnë si lidere, inovatore dhe nxitëse të ndryshimeve. Sot, shumë vajza të reja përballen me pabarazi strukturore që e kufizojnë qasjen e tyre në arsim cilë- sor, mundësi profesionale dhe zhvil- lim të karrierës. Ndryshimi i qën- drueshëm dhe domethënës varet nga politika gjithëpërfshirëse dhe refor- mat institucionale që adresojnë këto pengesa, duke hapur rrugën për li- dership dhe rritje profesionale.

Kur vajzat e reja trajnohen, mbështeten dhe inkurajohen për të udhëhequr, ato nuk hyjnë thjesht në tregun e punës - ato transformojnë diskursin publik, angazhimin në poli- tikëbërje dhe lidhshp komunitar. Forcimi i strukturës së brendshme të DANA-s siguron një ndikim kolektiv afatgjatë, duke rritur qëndruesh- mërinë dhe efektivitetin e rrjetit në avancimin e barazisë gjinore.

Një element kyç i këtij rrugëtimi është ekspozimi ndaj modeleve të suksesshme, qoftë ato nga alumne më të vjetra, apo nga gra të shquara që kanë thyer barrierat në fushat e tyre. Duke mësuar nga ato që kanë kthyer pengesat në mundësi, anëtarët e DANA-s shohin nga afër se ajo që sh- pesh konsiderohet “e pamundur” mund të bëhet “e mundur”.

Thyerja e barrierave për gratë e komuniteteve joshumicë

Për vajzat e reja nga komunitetet joshumicë, rruga drejt fuqizimit pro- fesional është shpesh e bllokuar nga barrierat të shumta ndërsektori- ale. Qasja e kufizuar në arsim cilë- sor, stigma kulturore rreth punësim- it të grave dhe diskriminimi sis- temik në punësim, i kufizojnë mundësitë e tyre për zhvillim. Gjithashtu, barrierat gjuhësore, sido- mos në institucionet ku gjuha shqipe ose serbe është dominuese, i izolo-jnë edhe më tej nga rrjetet dhe per- spektivat profesionale.

DANA krijon një hapësirë gjithëpër- shirëse ku vajzat ndajnë përvojat e tyre, duke rritur ndërgjegjësimin mbi diskriminimin e shumëfishtë me të cilin përballen. Përmes bashkëpunim- it ndërkomunitar dhe shkëmbimit të njohurive, DANA siguron që të gjitha vajzat e reja, pavarësisht prejardhjes, të kenë mbështetjen e nevojshme për të pasur sukses.

Përgatitja e vajzave të reja për një treg pune në ndryshim

Fuqizimi i vërtetë ekonomik fillon shumë para se një grua të hyjë në tre- gun e punës. Ai nis në hapësira ku ajo ndërton vetëbesimin, fiton aftësi dhe mëson të avokojë për veten e saj.

Në këtë drejtim, DANA shkon përtej zhvillimit të aftësive - ajo kri- jon platforma për vajzat e reja që të

angazhohen dhe të formësojnë diskursin publik. Një shembull konkret është Magda, revista e DANA-s, e cila jo vetëm amplifikon zërat e vajzave të reja mbi çështjet shoqërore, por gjithashtu u ofron atyre një hapësirë të sigurt për të sh- prehur opinionet e tyre.

Nisma të tilla sigurojnë që vajzat e reja jo vetëm të kenë ambicie, por të jenë të pozicionuara në hapësira ku mund të avokojnë për ndryshim dhe të ndikojnë në politikat që prekin jetën e tyre.

Duke shikuar përpara, fuqizimi i vajzave të reja dhe krijimi i hapësir- ave ku ato mund të zhvillojnë po- tencialin e tyre nuk është vetëm një çështje e barazisë gjinore, por një in- vestim në një shoqëri më të drejtë dhe më të përparuar. Rrjeti i DANA-s dëshmon se ndryshimi i vërtetë ndodh kur vajzat mbështesin njëra- tjetrën, sfidojnë normat ekzistuese dhe krijojnë mundësi të reja për veten dhe për komunitetet e tyre. Çdo hap drejt barazisë gjinore nuk është vetëm një fitore për gratë, por një pro- gres për të gjithë shoqërinë. Prandaj, vazhdimi i mbështetjes për platforma si DANA, të cilat nxisin lidhshp, mentorimin dhe solidaritetin ndër- mjet gjeneratave, mbetet thelbësor për ndërtimin e një të ardhmeje ku gratë dhe vajzat jo vetëm që marrin pjesë, por udhëheqin ndryshimin.

Autorja është zyrtare e programit Akademia e Dialogut, në Misionin e OSBE-së në Kosovë.



PËRKRAHUR NGA: